

VËRTETËSIA

BOTIM I XHEMATIT MUSLIMAN AHMEDIA TË SHQIPËRISË

PRANVERË 2021

WWW.ALISLAM.AL

NR. 11

Pse një komb mbetet i varfër?

Analizë nga një nobelist





Mesih i Premtuar

~ IMAM MEHDI

I Dërguari i Allahut ^{s.a.w.a} kishte paralajmëruar se Mesihu i Premtuar do të zbrësë pranë një minareje të bardhë, në lindje të Damaskut. Kjo profeci u përbush me ardhjen e Hazret Mirza Ghulam Ahmedit ^{a.s.} në Kadijan të Indisë, një qytezë që ndodhet pikërisht në lindje të Damaskut.



Hazret Mirza Ghulam Ahmedi ^{a.s.}, Mesih i Premtuar dhe Imam Mehdi lindi në vitin 1835 në një familje fisnike në Kadijan të Indisë. Që në moshën e re, ai shfaqti interes të veçantë në fe dhe ushquesh dashurinë për Profetin Muhammed ^{s.a.w.a}. Ai dallohej për fisnikërinë, dashamirësinë dhe vendosmërinë e tij. Me kalimin e kohës, njohuria dhe botëkuptimi i tij i besimit dhe zbatimit të tij në shoqëri u thelluan. Duke qenë një musliman i devotshëm, ai besonte fuqimisht se të gjitha fetë janë të vërteta për sa i përket origjinës së tyre, megjithatë në rrjedhën kohore ato u janë shmangur mësimëve burimore. Ai mbrojti dinjitetin e besimit dhe vërtetoi se ai është bashkëkohor dhe u përgjigjet sfidave të kohës.

Përpjekjet e tij në përkrahje të besimit u shpërblyen prej Allahut, i cili e dalloj atë si shërbëtor të përkryer të Islamit, të Kuranit dhe të Profetit Muhammed ^{s.a.w.a}, duke i dhuruar bekimin e shpalljes nën shërbim të Profetit ^{s.a.w.a}.

Misioni i tij ishte të shquante të vërtetat që përmban çdo fe, si dhe të rigjallëronte mësimet e Islamit. Përmes këtij misioni, ai hodhi themelet për t'i bashkuar njerëzit dhe për të vendosur paqe e harmoni të përhershme.

Më 1889, sipas urdhrat hyjnor, Hazret Mirza Ghulam Ahmedi ^{a.s.} themeloi Xhematin Musliman Ahmedia. Kjo bashkësi që tashmë është shumëfishuar në numër e në shtrirje, është angazhuar fuqimisht për të përçar mesazhin e Islamit deri në skajet e botës.

Gjatë periudhës në të cilën jetoi ai, Islami ishte nën shënjestër të sulmeve armiqësore nga të gjitha anët dhe

muslimanët në përgjithësi ishin në rënie të skajshme shpirtërore, duke pasur një besim të dyshimtë dhe krejtësisht sipërfaqësor. Ai ndërmori një fushatë të jashtëzakonshme për t'i treguar botës fytyrën e bukur dhe të vërtetë të fesë islame. Ndër përpjekjet e tij të çmuara e madhore, mund të përmendim: mbi tetëdhjetë libra, të cilët janë përkthyer në më shumë se 60 gjuhë të botës si “*Filozofia e mësimëve të Islamit*”, “*Brahin-e-Ahmedia*” etj., qindra ligjërata me njohuri të thella të mistikës e debate të shumta fetare, të cilat argumentojnë më së miri se feja islame është një fe e gjallë, nëpërmjet së cilës njeriu mund të lidhë kontakt me Krijuesin dhe arrin të komunikojë me Të.

Shumica nga veprat e tij janë shkruar në gjuhën urdu, disa janë në gjuhën arabe e disa të tjerë edhe në gjuhën perse. Ai gjithashtu provoi se mësimet e Kuranit Famëlartë dhe ligji i fesë islame kanë fuqinë të ngrënë e të përsosin nivelin moral, intelektual dhe shpirtëror të njeriut. Ai deklaroi se Zoti i Madhërishtëm e ka caktuar atë si Mesih dhe Imam Mehdi, siç ishte përmendur në profecitë e Biblës, të Kuranit Famëlartë dhe të haditheve të Hazret Profetit Muhammed ^{s.a.w.a}.

Nga 1889 deri 1908 kur ai ndërroi jetë, mijëra njerëz iu bindën atij dhe lidhën besëlidhje me të. Ky bekim vazhdon të përhapet përmes Kalifëve (zëvendësve) të tij.

Aktualisht, Hazret Mirza Masrur Ahmedi (Allahu e ndihmoftë fuqimisht) është udhëheqësi botëror i Xhematit Musliman Ahmedia dhe Kalifi i Pestë i Mesihut të Premtuar ^{a.s.} Ky Xhemat sot është përhapur në më shumë se 205 vende të botës dhe përbëhet nga miliona anëtarë.

Mposhte zemërimin!



(Të druajturit janë ata) ... që shpenzojnë edhe në kamje, edhe në skamje, që gëlltitin zemërimin dhe falin njerëzit. Dhe Allahu i do mirëbërësit. Dhe që kur bëjnë ndonjë paturpësi a shkelin veten e tyre, e kujtojnë Allahun dhe i kërkojnë falje për mëkatet e tyre - e kush mund t'i falë mëkatet, përveç Allahut! - dhe ata nuk këmbëngulin duke ditur për ato që kanë bërë.

ISLAMI, *KURANI FAMILARTË*, 3:135-136.



Ebu Hurejra ^{r.a.} transmeton se i Dërguari i Allahut ^{s.a.v.s.} ka thënë: “Nuk është trim ai që fiton në mundje, por trim është ai që e përmban zemërimin”.

ISLAMI,
PROFETI MUHAMMED S.A.V.S.
SAHIHU I BUHARIUT, KITAB “EL-EDEB”,
BAB: “EL-HADHERU MINEL GHADABI”,
HADITHI NR. 6114.



Nëse doni të fitoni dijen e shenjtë, mos flisni duke qenë i mposhtur nga vetvetja, sepse fjala juaj do të jetë e zbrazët nga urtësia dhe njohja ndaj Zotit.

ISLAMI,
MESIHU I PREMTUAR A.S., NESIME DA'VET,
RUHANI KHAZA'IN, V. 19, F. 365-366.



Kush nuk zemërohet shpejt vlen më tepër se një luftëtar i fortë, dhe ai që e urdhëron frymën e tij vlen më tepër se ai që mposht një qytet.

KRISHTËRIMI,
DHIJATA E VJETËR,
FJALËT E URTA, 16:32.



Zemërimi privon të mençurin nga mençuria e tij, dhe profetin nga frymëzimi i tij.

JUDAIZMI,
“TRACTATE PESACHIM.” TALMUD. 66B.



Kur një i lig mëson çka është e mira, dhe ju vjen për të shkaktuar çrregullim, duhet të ruani qetësinë. Ju nuk duhet ta qortoni atë me zemërim. Atëherë, i ligu që ka ardhur për t'ju mallkuar, vetëm vetveten do ta dëmtojë.

BUDIZMI,
SUTRA DYZETEDY PJESA 7.



Njeriu më i fortë është ai, i cili ka fuqi të mposhtë dëshirat e tij të liga dhe që arrin të shpëtojë veten nga këto pesë vese: Kopranci, Zemërim, Eps, Paturpësi dhe Babëzi.

ZOROASTRIANIZMI,
MINO-F-KHERAD, XLI. 8-11.



Zemërimi nxit më shumë zemërim, kurse falja e dashuria të çojnë në më shumë falje e dashuri.

XHAINIZMI,
MAHAVIRA
SUTRA 42, PJESA 7



9 Ajetul Kursij dhe komentim i tij
Vërtetësia vijon t’ju sjellë shqipërimin e *Et-Tefsir-ul-Kebir*: (komentim i gjerë i Kuranit), të shkruar nga Hazret Mirza Bashiruddin Mahmud Ahmed ^{r.a.}, Kalifi i Dytë i Mesihut të Premtuar. *Et-Tefsir-ul-Kebir* është një prej komentimeve më të thella e të argumentuara, të Kuranit Famëlartë
HAZRET MIRZA BASHIRUDDIN MAHMUD AHMED ^{R.A.},
KALIFI I DYTË I MESIHUT TË PREMTUAR

24 Ky Zot është kushti i Xhematit tonë
HAZRET MIRZA GHULAM AHMED ^{A.S.},
MESIH I PREMTUAR DHE IMAM MEHDI

**26 Paqja e paarritshme?!
Pse duhet të kthehemi te Zoti?**
Nëse ekziston një farë shprese për civilizim, që një bashkësi njerëzish frymëzues, fisnikë dhe të dobishëm të dalin nga kakofonia aktuale e grindjeve, shkatërrimit, nihilizmit dhe fanatizmit, të gjithë ne duhet të kthehemi te Zoti dhe të ndryshojmë.
DR. NASIM REHMATULLAH

30 Depresion | Shenjat dhe trajtimi
Depresioni është më shumë se thjesht trishtim; është quajtur si problemi shëndetësor mendor numër një aktualisht në botë.
SAMAR HAFEEZ

36 Pse një komb mbetet i varfër?
Analizë nga një nobelist
PROF. DR. ABDUS SALAM

48 Mbështetja te Zoti i Lartësuar
Fragment nga libri “Jeta e Muhammedit ^{s.a.v.s.}”
HAZRET MIRZA BASHIRUDDIN MAHMUD AHMED ^{R.A.},
KALIFI I DYTË I MESIHUT TË PREMTUAR

52 Pikëpamja e Islamit mbi jetën pas vdekjes
Një shkrim që synon të zbërthejë enigmën e vdekjes dhe të analizojë jetën pas vdekjes nga këndvështrimi i Islamit
MALIK JAMIL R. RAFIQ

68 Pozita e lartë e Ehli Bejtit dhe e Hazret Imam Husejnit ^{r.a.}
HAZRET MIRZA GHULAM AHMED ^{A.S.},
MESIH I PREMTUAR DHE IMAM MEHDI

72 Emrat e Allahut


Vërtetësia ju sjell kuptime të thella që përmbajnë atributet e Allahut.

80 Një vit me Covid-19

Një përmbledhje aktivitetesh gjatë kohës së pandemisë nga Xhemati Musliman Ahmedia dhe organizata e tij humanitare “Humanity First” në Shqipëri, Kosovë dhe Gjermani.

94 A duhet të agjërojmë nëse jemi në udhëtim ose të sëmure?

Një përgjigje e argumentuar në bazë të Kuranit, hadithit dhe thënieve të Mesihut të Premtuar ^{a.s.}



48



9



36



Eseja e titulluar “*Filozofia e mësimeve të Islamit*” është shkruar në gjuhën urdu nga Hazret Mirza Ghulam Ahmed ^{a.s.}, Mesihu i Premtuar dhe Imam Mehdiu, si përgjigje ndaj ftesës së Z. Svami Sad’hu Shogan Çander, i cili organizoi Mbledhjen e Madhe të Feve, në Town Hall të qytetit Lahor në datat 26 – 29 dhjetor të vitit 1896. Dijetarët muslimanë, të krishterë, arjë dhe të feve të tjera ishin ftuar për të përfaqësuar fenë e tyre përkatëse. Atyre u ishte caktuar të ligjëronin rreth pesë pyetjeve të kërkuara në bazë të Librit që ata besonin si Hyjnor:

1. Gjendjet trupore, morale dhe shpirtërore të njeriut
2. Cila është gjendja e njeriut pas kësaj jete, pra në botën vijuese?
3. Cili është qëllimi i vërtetë i qenies së njeriut në këtë botë dhe si mund të përmbushet ai qëllim?
4. Si ndikojnë veprat te njeriu në këtë botë dhe në botën vijuese?
5. Cilat janë mjetet për të arritur dijen dhe njohjen Hyjnore?

Lexoni online:

<https://www.ahmadiyya-islam.org/al/librat/>

ose blini këtu:

<https://www.ahmadiyya-islam.org/al/kontaktoni/>

VËRTETËSIA

KRYEREDAKTOR

Samad Ahmed Ghorri

BORDI EDITORIAL

Jinahuddin Saif, Bujar Ramaj,
Shahid Butt, Rexhep Hasani

REDAKTOR GJUHËSOR

Besmir Yvejsi

FAQOSJA

Shahid Butt

MENAXHER

Idriz Ramadani

Email: idriz.xhamajl@gmail.com

PËR ABONIM KONTAKTONI:

SHQIPËRI

Sali Beja

Email: salibeja@gmail.com

KOSOVË

Shkëlqim Bytyçi

Email: shkëlqimbytyci@gmail.com

SHTYPUR NË SHTYPSHKRONJËN

RanaPoster.de Druckerei

Robert-Perthel-Str. 15

50739 Köln-Bilderstöckchen, Deutschland

Email: masood313@aol.com

ADRESA POSTARE

NË SHQIPËRI:

Xhemati Musliman Ahmedia i

Shqipërisë, pranë Vodafonit,

Rr. "Pavarësia" Km. 1, Mëzez,

Kutia Postare 8176, Tiranë, Shqipëri

Email: amj.albania@gmail.com

NË KOSOVË:

Xhemati Musliman Ahmedia i Kosovës

Rr. "Elbasani", nr. 9,

Lagjia e Spitalit,

Kutia Postare 43,

Prishtinë 10000, Kosovë

Email: amj.kosovo@gmail.com

NË GJERMANI:

Albanian Desk

Barendorfer Bruch 15,

58640, Iserlohn, Deutschland

Email: albanian.desk@gmail.com

KONTAKT REDAKSI

M +355 67 216 8054, (0) 694644888

M +383 44 817 813

T +355 42 391 080

WEBSITE

www.alislam.al

Foto në kopertinë

Titull: disa grataçela,

Vendi: Seuli, kryeqyteti i Koresë së Jugut

Foto nga **Ethan Brooke** nga **Pexels.com**

KORRIGJIME

për numrin e kaluar (nr. 10)

Faqja	Paragrafi	Fjalja e saktë
50	3	Ai që lexon Kuranin dhe e nuk praktikon atë, Kurani i Shenjtë e mallkon atë.

Ajetul Kursij dhe komentim i tij

Vërtetësia vijon t'ju sjellë shqipërimin e *Et-Tefsîr-ul-Kebîr*: (komentim i gjerë i Kuranit), të shkruar nga Hazret Mirza Bashiruddin Mahmud Ahmed ^{r.a.}, Kalifi i Dytë i Mesihut të Premtuar. *Et-Tefsîr-ul-Kebîr* është një prej komentimeve më të thella e të argumentuara të Kuranit Famëlartë.



اللَّهُ لَا إِلَهَ إِلَّا هُوَ الْحَيُّ الْقَيُّومُ لَا تَأْخُذُهُ سِنَّةٌ وَلَا نَوْمٌ لَهُ مَا فِي السَّمَاوَاتِ وَمَا فِي الْأَرْضِ مَنْ ذَا الَّذِي يَشْفَعُ عِنْدَهُ إِلَّا بِإِذْنِهِ يَعْلَمُ مَا بَيْنَ أَيْدِيهِمْ وَمَا خَلْفَهُمْ وَلَا يُحِيطُونَ بِشَيْءٍ إِلَّا بِمَا شَاءَ وَسِعَ كُرْسِيُّهُ السَّمَاوَاتِ وَالْأَرْضَ وَلَا يَئُودُهُ حِفْظُهُمَا وَهُوَ الْعَلِيُّ الْعَظِيمُ

Shqiptimi i Ajetul-Kursij

All-llāhu lā ilāhe il-lā huwel-Hajjul-Kajjūm, lā te'khudhubū sinetun we lā newm, lebhū mā fis-semāwāti we mā fil-erd, men dhel-ledhī jeshfē'ū 'indehū il-lā bi-idhnik, ja'lemu mā bejne ejdihim we mā khalfehum, we lā juhitūne bi shej-in min 'ilmihī il-lā bimā shāe, wesi'a kursijjehus-semāwāti wel-erd, we lā jeūduhū hifdhuhumā we huwel 'alijjul-'adhīm.

Përkthim i Ajetul-Kursij

Allahu! Nuk ka të adhureshëm tjetër përveç Tij. I Gjalli, i Qëndrueshmi. Atë nuk e zë as dremitja e as gjumi. E Atij është gjithçka që gjendet në qiej dhe gjithçka që gjendet në tokë. Kush mund të ndërmjetësojë pranë Tij, pa lejen e Tij?! Ai e di atë që është para tyre dhe atë që është pas tyre. Ata nuk mund të zotërojnë asgjë nga dija e Tij, përveç asaj që Ai do. Sundimi i Tij shtrihet mbi qiejt e mbi tokën. Ruajtja e të dyjave nuk e lodh Atë dhe Ai është i Larti, i Madhërishmi.¹

KUPTIMET LEKSIKORE

الحَيُّ *El-Haj-j* (i Gjalli)

Emrat e Zotit janë të shquar dhe kur thuhet el-Haj-j (i gjalli), shquarsia i referohet përsosmërisë së Zotit në këtë cilësi. Andaj, kur thuhet se Zoti është El-Haj-j, do të thotë se Ai është i Gjalli në atë mënyrë, saqë Ai nuk varet nga askush në këtë cilësi. Pra, Atij nuk i është dhuruar jeta nga askush, por Ai është i Gjalli absolut dhe i Përhershmi.²

الْقَيُّومُ *El-Kaj-jum* (i Qëndrueshmi)

Rrjedh nga “kame”, e cila do të thotë “qëndroi”. Nga kjo rrjedh edhe kaj-jim, që do të thotë mbikëqyrës dhe kujdestar. Kaj-jim gjithashtu do të thotë “mustekīm”

dhe “*emrun kaj-jimun*” do të thotë një çështje që nuk ka asnjë shtrebbërim dhe që është plotësisht e drejtë.

El-kaj-jum dhe *el-kaj-jam* do të thotë ai që është i mëvetësishëm, pra vetë i qëndrueshëm dhe që nuk ka ndonjë fillim.³

El-Kaj-jum nuk thuhet vetëm për atë që vetë është i qëndrueshëm, por nënkupton që ai mban të qëndrueshëm dhe e ruan edhe të tjerët. Në “*Mufredat*” thuhet: الْقَائِمُ الْخَاطِطُ لِكُلِّ شَيْءٍ وَالْمُعْطَى لَهُ مَا بِهِ قَوَامُهُ “Ai që vetë është i qëndrueshëm dhe që është mbikëqyrës i çdo gjëje, duke i dhënë fuqinë e duhur për qëndrueshmërinë e saj”.

Andaj, puna e *kaj-jumit* është që ai u mundëson të gjitha gjërave fuqitë e duhura që ato të qëndrojnë në këmbë dhe të kryejnë funksionet e tyre. Zoti i Madhërishtë është *el-Kaj-jum*, jo vetëm sepse Ai Vetë është i Qëndrueshëm, por edhe sepse gjithçka qëndron për shkak të fuqisë së dhuruar prej Tij. Cilësia e Zotit “*el-Kaj-jum*” shumë bukur hedh dritë edhe mbi gravitetin e pranishëm në trupat qiellore, bashkimin dhe ndarjen e grimcave, rrotullimin e tyre rreth njëra-tjetrës dhe lëvizjet e tjera si këto.

سِنَةٌ *sinetun*


السِّنَّةُ مِنَ الْوَسْنِ Fjala “*sinetun*” rrjedh nga fjala “*vesnun*”. “*Vesenerr-rrexhul*” do të thotë: أَخَذَهُ قَطْلُ النَّوْمِ “*akhadbehu thiklen-neum*”, “atë e kapi gjumi i rëndë”. Shenja e këtij gjumi është “*sinetun*” që do të thotë “dremitja që të shkaktohet kur je i pushtuar nga gjumi”.⁴

النَّوْمُ *en-neum*

Gjumi i zakonshëm që nuk e nxjerr njeriun jashtë kontrollit [pra, jo si “*sinetun*”].

الْكُرْسِيُّ *el-kursij-ju*

Rrjedh nga fjala “*kirsij*” që do të thotë bashkimi i sendeve të ndryshme. Thuhet: كَرَسَتْ بِنَاءً (*kerestu bina'en*) do të thotë: “Bëra ndërtesë”, sepse ndërtesa bëhet me



vendosjen e tullave mbi njëra-tjetrën. “Kursij-ju” gjithashtu do të thotë dije dhe sundim.⁵

KOMENTIM I AJETUL-KURSIJIT

Gjëja e parë për të cilën ky ajet na tërheq vëmendjen, është: اللَّهُ لَا إِلَهَ إِلَّا هُوَ Allahu! Nuk ka të adhurueshëm tjetër përveç Tij.


Pra, thotë: Lidhuni me Zotin, sepse vetëm Ai është i Adhuruari juaj dhe nuk keni asnjë zot tjetër përveç Atij.


Çdo gjë në botë vlerësohet sipas sasisë së tij. Për shembull, uji është një gjë jetike, por njerëzit nuk e ruajnë atë, sepse e dinë që sa herë që u duhet, e gjejnë. Ajri është i pazëvendësueshëm për jetën, por asnjë njeri nuk e ruan atë, sepse di që kur i duhet, ajri vetë hyn e del nëpërmjet rrugëve të frymëmarrjes.

Por, po ky ujë, për të cilin thamë se njerëzit zakonisht nuk e ruajnë, në një pyll a në shkretëtirë ku nuk ka ujë, bëhet një gjë jashtëzakonisht e çmueshme. Në një vend të tillë, njeriu nuk i jep as një gotë uji tjetrit, edhe sikur ky i fundit t’i ofrojë një çmim të madh. Pra, çdo gjë vlerësohet në bazë të nevojës. Siç drithërat, kur ka shumë shiten të lira, e kur nuk ka, shtrenjtohen.

Në të njëjtën mënyrë, nëse bota do të kishte shumë zota, dikush mund të thoshte: po nuk e gjej këtë, do të gjej një tjetër. Por, ky ajet thotë se Allahu është vetëm një. Prandaj, nuk mundet që ndokush ta lërë Atë dhe të kërkojë ndonjë tjetër. Pra, derisa Allahu nuk janë dy ose tre ose katër ose një mijë ose njëqind mijë dhe është vetëm një, ku do të shkoni duke e lënë Atë?! Është Ai që ju duhet në çdo çast, dhe të Atij jeni nevojtarë në çdo kohë.

Disa njerëz nuk vrasin mendjen as për pëlqimin e mbretërve, sepse ata e dinë se nëse ky mbret do ngelet i pakënaqur, do të shkojnë te një tjetër, në një vend tjetër. Nëse mbreti i Kinës është mizor, njeriu strehohet në Persi, për shembull. Nëse mbreti i Persisë është mizor, ai mund të shkojë gjer në Angli për t’u strehuar. Por ku do të shkojë duke e lënë Allahun, përderisa nuk ka tokë që nuk i përket Atij dhe nuk ka sundim që nuk e përfshin Ai?! Pra, nuk ka një zot të dytë, që njeriu





t'i drejtohet për ndihmë.


Hindutë besojnë se ka shumë zota. Madje, zotat e tyre edhe grinden. Në një histori të famshme të mitologjisë së tyre, thuhet se zoti Shiva vrau një njeri sepse ishte zemëruar ndaj tij, por ai njeri ishte i biri i përkëdhelur i zotit Brahma. Brahma tha: ngaqë jam unë që jap jetë, do ta ringjall edhe këtë. Kështu, Brahma e ringjalli. Por Shiva e vrau përsëri. Dhe Brahma e ringjalli përsëri. Kështu, Shiva e vriste dhe Brahma e ringjallte. E tillë ka qenë grindja e tyre. Këto janë mendime të hinduve.


Por ne nuk kemi zota të tillë, që njëri vret e tjetri ringjall; njëri gëzohet e tjetri hidhërohet. Një punëtor mund t'i thotë shefit: 'nuk dua të punoj te ti', sepse ai gjen punë diku tjetër. Por ne nuk mund t'i themi një gjë të tillë Zotit të Madhërishëm, sepse Ai është i Vetëm dhe nuk ka asnjë zot tjetër përveç Atij.

I Gjalli

Pastaj thotë se Zoti ynë është Zoti i Gjallë dhe i Përhjetshëm. Ai ishte i Gjallë edhe në kohën e Ademit ^{a.s.}, edhe në kohën e Nuhut ^{a.s.}, edhe në kohën e Ibrahimit ^{a.s.}, edhe në kohën e Musait ^{a.s.}, edhe në kohën e Isait ^{a.s.}, edhe në kohën e Profetit Muhammed ^{s.a.v.s.} dhe Ai është i Gjallë edhe sot. Nëse bota do të rrojë edhe për një mijë vjet ose edhe për një milion vjet, Ai do të vijojë t'i tregojë botës shenjat e të qenit gjallë të Tij. Sepse Ai është i Gjalli (El-Haj-j) dhe i Qëndrueshmi (El-Kaj-jum). Dhe derisa Atë nuk e kap as dremitja e as gjumi, si mund të ndalen shenjat që tregojnë gjallërinë e Tij? Kur dikush krijon lidhje me Zotin e tillë, Zoti bëhet kujdestari i tij dhe gjithmonë shfaq shenja të jashtëzakonshme për mbështetjen e Tij.

Ne kemi parë Hazret Kalifin e Parë të Mesihut të Premtuar, Allahu e mëshiroftë. Atij i vinin shumë njerëz për të lënë amanetet e tyre dhe ai, kur i nevojitej, shpenzonte nga ato. Ai thoshte: Zoti i Madhërishëm me bekimin e Tij më furnizon në këtë mënyrë. Disa herë kemi parë që i vinte njëri për t'ia kërkuar amanetin e vet dhe thoshte: 'm'i ktheni paratë e mia' ose 'ma ktheni amanetin






që ju pata lënë'. Hazret Kalifi i Parë ^{r.a.} ishte shumë i thjeshtë nga natyra. Në këto raste, merrte ndonjë letër të grisur dhe u shkruante anëtarëve të shtëpisë së tij: 'Më dërgoni kaq rupi nga amanetet'. Nga shtëpia nganjëherë vinte përgjigje: 'Paratë janë harxhuar' ose 'Po ju dërgoj aq sa kemi', pra, kur nuk kishin para të mjaftueshme. Në këto raste, Hazret Kalifi i Parë ^{r.a.} i thoshte të zotit të amanetit: 'Prisni pak ju lutem, tani do të vijnë paratë'. Kemi parë që ndërkohë mbërrinte ndonjë njeri nga Xhunagar ose nga Bombej ose ngado qoftë dhe i jepte po aq para që i duheshin.


Një ditë ndodhi akoma më bukur. Dikush i kërkoi Hazret Kalifit të Parë ^{r.a.} paratë e tij. Atë ditë ai nuk kishte para fare. Në të njëjtën kohë erdhi një njeri për t'u mjekuar. Pas mjekimit, i dha disa rupi, të mbështjellë në një zarf. Hafiz Roshan Ali sahibi e dinte se sa para kërkonte i zoti i amanetit. Kalifi i Parë ^{r.a.} i kërkoi: 'Shikoni se sa rupi ka në këtë zarf?' Ai i numëroi dhe ishin vetëm aq sa i duheshin për t'ia kthyer të zotit të amanetit. 'Jepjani', i tha Hafiz sahibit.

Vetë Hazret Kalifi i Parë ^{r.a.} na tregonte një ngjarje të tillë të një njeriu tjetër të Zotit, të cilit njëherë i erdhi një huadhënës për t'ia kërkuar paratë e tij, duke i treguar edhe sasinë e tyre, edhe kohën kur ia kishte dhënë. Por ai iu përgjigj: "Nuk kam para për momentin, do t'juja kthej kur do të kem".

"Po hiqesh si njeri fisnik para të tjerëve, por si nuk ua kthen huan që u merr?! Çfarë fisnikërie qenka kjo?!"

Ndërkohë aty kaloi një djalë që shiste ëmbëlsira. Ai i tha: "Më jep hallvë për pesëdhjetë qindarka". Ëmbëltori ia dha hallvën dhe ai e mori dhe i dha huadhënësit për të ngrënë. Kur ëmbëltori ia kërkoi pagesën e hallvës, ai tha: "Nuk kam as dhjetë qindarka e ti më kërkon pesëdhjetë!" Djali filloi të bërtiste. Huadhënësi i befasuar mendoi: Çfarë njeriu qenka ky që jo vetëm gëlltiti huan time, por i shkaktoi humbje të pesëdhjetë qindarkave edhe këtij djali të gjorë! Tani, të dy bërtisnin dhe i ankoheshin për paratë e tyre, por njeriu në fjalë rrinte i qetë. Ndërkohë erdhi një i katërti dhe i dha atij një qese, duke thënë: "Këtë





jua ka dhënë si dhuratë filani”. Ai e mori qesen dhe kur e hapi, pa që ajo kishte po aq para që huadhënësi i kërkonte, por nuk kishte pesëdhjetë qindarka të ëmbëltorit. “Nuk më takon kjo qese”, i tha njeriu i Zotit korrierit, duke ia kthyer edhe qesen. Korrieri u habit dhe menjëherë filloi të kërkonte diçka në xhep. Ai nxori një qese tjetër dhe tha: “Më falni! Kam gabuar. Kjo është juaja”.

Njeriu i Zotit e mori, e hapi dhe pa që ajo kishte po aq para që kërkonte huadhënësi dhe gjithashtu kishte edhe pesëdhjetë qindarka shtesë. Ai i thirri të dy që ankoheshin dhe ia dorëzoi paratë secilit. Kështu që, në mbështetje të robërve të Tij, Zoti i Gjallë gjithmonë shfaq shenja.

Ai është i Qëndrueshmi (El-Kaj-jum)


Pastaj ajeti thotë: هُوَ الْحَيُّ الْقَيُّومُ “Ai është i Qëndrueshmi” (El-Kaj-jum).


Dikush mund të thotë: Sot ky është padroni im, por më përpara kam qenë shërbëtor te filani, andaj unë i kam borxh edhe atij dhe kam për detyrë ta vlerësoj atë. Zoti i Madhërishëm u thotë njerëzve: Unë jam Zoti juaj jo vetëm sot, por që nga fillimi dhe ju nuk keni mirësi nga asnjë zot tjetër përveç Meje, sepse jam Unë i Qëndrueshmi dhe ju jap qëndrueshmërinë edhe juve.

Nuk e kap as dremitja e as gjumi (Ajetul-Kursij)

Më pas ajeti thotë: لَا تَأْخُذُهُ سِنَةٌ وَلَا نَوْمٌ “Atë nuk e kap as dremitja e as gjumi”

Dikush mund të pohojë: E pranoj se Zoti është vetëm Një dhe nuk ka zot tjetër përveç Atij, Ai është i Gjallë që nga fillimi dhe Ai ishte Sunduesi ynë edhe më përpara, dhe është edhe tani, por a nuk mundet që Atë ta kapë gjumi ose dremitja dhe në atë kohë, në vend të Tij, të punojë dikush tjetër nga paria e Tij? Dhe për këtë arsye, ai mund të thotë: Mua më duhet të kënaq edhe parinë e Zotit. Mirëpo Allahu i Madhërishëm thotë se Zoti juaj është Allahu, të cilin asnjëherë nuk e zë as dremitja e as gjumi. Pra, këtu pohohet që Zoti nuk është si mbretërit e kësaj bote, të cilët shpesh edhe mungojnë për shkak të gjumit, dhe njerëzit detyrohen t’u servilen edhe oborrtarëve të mbretit. Zoti ynë është Ai që





gjithmonë është vigjilent dhe që mbikëqyr çdo gjë gjatë gjithë kohës.

Kjo pjesë e ajetit tregon edhe një gjë të bukur. Thotë: لَا تَأْخُذْ سِينَةً وَلَا تَوْمَ “Atë nuk e kap as dremitja e as gjumi”. Në një strukturë të tillë fjalie, së pari përmendet ajo që është e vogël dhe pastaj e madhja. Nëse nuk zbatohet ky rregull, fjalia do të mbetet e pakuptimtë. Për shembull, themi “filani nuk ishte shumë i sëmurë, madje ai nuk kishte asnjë sëmundje”. Por nëse do të themi: “filani nuk kishte asnjë sëmundje, madje ai nuk ishte shumë i sëmurë”, nuk do të ketë kuptim fjalia jonë, sepse së pari përmendet shkalla e lartë e pastaj shkalla e vogël.

Por në këtë ajet thotë se “Atë nuk e kap as dremitja e as gjumi” dhe lind pyetja: Kur u mohua dremitja, është e nënkuptuar që edhe gjumi nuk e zë, atëherë, përse kishte nevojë të mohohej gjumi?


Në fakt, struktura e kësaj fjalie ka një urtësi. Fjala “sinetun” (dremitje) është ajo që e zë njeriun në momentin kur ai pushtohet nga gjumi dhe ai nuk ka mundësi t’i mbajë sytë hapur. Pra, kjo lloj dremitjeje nuk e zë dikë, derisa gjumi ta pushtojë atë. Andaj, në këtë ajet thuhet: Zotin e Madhërishëm asnjëherë nuk e zë dremitja që shkaktohet nga punë për një kohë të gjatë dhe pa bërë një copë gjumi, gjithashtu, Atë nuk e zë as gjumi i zakonshëm. Andaj, renditja është shumë e rregullt dhe se pikërisht fjala “sinetun” duhet të përmendej e para dhe pastaj fjala “neum” (gjumi).


Kush mund të ndërmjetësojë pranë Tij, pa lejen e Tij?!

Pastaj ajeti thotë: لَهُ مَا فِي السَّمَاوَاتِ وَمَا فِي الْأَرْضِ “E Atij është gjithçka që gjendet në qiej dhe gjithçka që gjendet në tokë”.

Pra, derisa Zoti juaj posedon gjithçka që ekziston në qiej dhe në tokë, si mund të merrni ndonjë zot tjetër përveç Atij?

Disa njerëz thonë: ‘ne nuk adhurojmë dikë tjetër përveç Zotit, por ka disa, të cilëve u blatojmë dhe u kërkojmë të na përmbushin kërkesat, sepse ata janë të






afërt me Zotin e Madhërishëm dhe ata do të ndërmjetësojnë për ne pranë Tij'. Por Zoti i Madhërishëm thotë: مَنْ ذَا الَّذِي يَشْفَعُ عِنْدَهُ إِلَّا بِإِذْنِهِ "Kush mund të ndërmjetësojë pranë Tij, pa lejen e Tij?!" Pra, edhe kjo shpresë për t'u lidhur me dikë tjetër përveç Allahut, është e gabuar.

Në këtë kohë, kush mund të jetë më i madh në pozitë sesa Hazret Mesihu i Premtuar ^{a.s.}! Njëherë Navab Muhamed Ali Khanit iu sëmur shumë djali, i quajtur Abdurrahim Khan. Hazret Mesihu i Premtuar ^{a.s.} bëri lutje për të dhe i erdhi shpallje "Caktimi është i patjetërsueshëm dhe vdekja është e sigurt". Ai mendoi që Navab Muhamed Aliu erdhi në Kadijan pasi la çdo gjë që kishte dhe në këtë situatë, po t'i vdiste djali, do të ishte një sprovë e madhe për të. Për këtë arsye, ai u lut: "O Zoti im! Dua të bëj ndërmjetësim për shëndetin e këtij djali". Sakaq, i erdhi një shpallje shumë e fuqishme duke thënë:

"Kush mund të ndërmjetësojë pranë Tij, pa lejen e Tij?!"

Shikoni pra, Hazret Mesihu i Premtuar ^{a.s.} ishte një njeri i madh, të cilin njerëzit e prisnin që trembëdhjetë shekuj, por kur ai përpiqet të bëjë ndërmjetësim pranë Zotit, Zoti i thotë: "Kush je ti që ndërmjetëson pa lejen Time?" Hazret Mesihu i Premtuar ^{a.s.} thoshte: 'Kur më erdhi kjo shpallje, unë rashë përtokë, më dridhej i gjithë trupi dhe gati do të vdisja, por në këtë gjendje Zoti i Madhërishëm më tha: إِنَّكَ أَنْتَ الْحَاجُّ "Ty të jepet leje!"

Kështu që, ai e bëri ndërmjetësimin dhe Abdurrahim Khani u shërua. Pra, nëse edhe një njeriu si Hazret Mesihut të Premtuar ^{a.s.} Zoti i thotë 'kush je ti që bën ndërmjetësimin pa leje', çfarë pozite mund të kenë të tjerët që të bëjnë ndërmjetësimin?! Në hadithe përmendet që në ditën e gjykimit, Profetit Muhammed ^{s.a.v.s.} do t'i jepet leje, vetëm atëherë ai do të bëjë ndërmjetësim. Atëherë, sa naiv mund të jetë ai musliman që mendon se filani do të bëjë ndërmjetësim për të para Zotit!



Ai e di atë që është para tyre dhe atë që është pas tyre

Mbetet edhe një gjë tjetër pa u zgjidhur. Dikush mund të thotë: ‘Mirë, e pranoj se nuk bëhet ndërmjetësimi pa leje, por ashtu siç mbreti ka oborrtarë, nëpërmjet të cilëve njeriu mund të përfitojë, në të njëjtën mënyrë, edhe Zoti i Madhërishëm duhet të ketë oborrtarë të Vet’. Për këtë Zoti thotë në këtë ajet: Njerëzit naivë nuk e kuptojnë se mbretit i duhen oborrtarë, që ata ta informojnë mbretin për çdo gjë që ndodh në vend, sepse mbreti i vetëm nuk mund të dijë gjithçka. Por, Allahu i Madhërishëm është Ai që di edhe atë që ndodhi përpara njerëzve dhe di edhe atë që do të ndodhë pas tyre. Pra, thotë: يَغْلَمُ مَا بَيْنَ أَيْدِيهِمْ وَمَا خَلْفَهُمْ Ai e di atë që është para tyre dhe atë që është pas tyre.


Kjo fjali ka dy kuptime: 1) Zoti i Madhërishëm di edhe ato gjëra që do të ndodhin në të ardhmen dhe di edhe ato që njerëzit kanë bërë në të kaluarën, dhe 2) Zoti i Madhërishëm di edhe ato që njerëzit bëjnë dhe di edhe ato që duhet t’i bënin, por nuk i kanë bërë. Për çfarë i duhen oborrtarë një Zoti të tillë?!

Ata nuk mund të zotërojnë asgjë nga dija e Tij, përveç asaj që Ai do

وَلَا يُحِيطُونَ بِشَيْءٍ مِّنْ عِلْمِهِ إِلَّا بِمَا شَاءَ “Ata nuk mund të zotërojnë asgjë nga dija e Tij, përveç asaj që Ai do”.

Në këtë pjesë, Zoti i Madhërishëm thotë shumë qartë që askush nuk mund ta përfshijë dijen e Zotit, as Profeti Muhammed ^{s.a.v.s.} e as ndokush tjetër. Pa dyshim, Profeti Muhammed ^{s.a.v.s.} është prijësi i të gjithë Profetëve dhe i dashuri i Allahut të Madhërishëm, madje ai që e ndjek atë, bëhet i dashur i Zotit, megjithatë, ai ishte krijesë e Zotit dhe prej Tij varej. Andaj, ai kishte vetëm cilësitë njerëzore dhe asnjëherë nuk mund të kishte cilësitë, të cilat Zoti i ka veçuar vetëm për Vete.

“Ata nuk mund të zotërojnë asgjë nga dija e Tij, përveç asaj që Ai do” tregon gjithashtu që rrugët për të gjetur afrimin me Zotin janë të pakufishme, aq saqë asnjë njeri nuk mund t’i zbulojë të gjitha. Kur një rob përparon duke iu afruar Zotit dhe arrin t’i mbledhë bekimet dhe dritën sipas pozitës së tij, Zoti



i Madhërishëm, me bekimin e Tij, i bën manifestim të dytë më të lartë të Tij. Kur robi e përthith edhe manifestimin e dytë dhe Zoti sheh se ai është gati për një manifestim të tretë, Ai ia bën të tretin. Në këtë mënyrë, robi vazhdon të përparojë drejt Zotit.


Profeti Muhammed ^{s.a.v.s.} e sqaron këtë raport me një shembull shumë të bukur. Ai thotë se Zoti do të pyesë njeriun që qëndron në fund të xhehenemit: Më kërko ndonjë gjë që të ta plotësoj. “Dua të më nxjerrësh nga xhehenemi”, ai do t’i kërkojë Zotit. Zoti do t’ia pranojë kërkesën dhe do ta nxjerrë atë nga xhehenemi. Njeriu do të gëzohet shumë. Pas pak ditësh, ai do të shohë një pemë të gjelbëruar e të lulëzuar. Do t’i lindë dëshira për t’iu afruar asaj pemë e për t’u ulur nën hijen e saj, por do ta mbajë të fshehtë këtë dëshirë për disa ditë. Më në fund, do t’i kërkojë Zotit që më mëshirën e Tij t’ia plotësojë dëshirën. Zoti i Madhërishëm do t’ia pranojë kërkesën dhe do ta çojë atë nën hijen e asaj pemë.


E kur do të kalojnë disa ditë edhe atje, Zoti do ta sprovtojë atë, duke i treguar një pemë tjetër akoma më të bukur, por që do të jetë në distancë nga ajo e para. Ai do ta lakmojë edhe atë por do të durojë, duke mos ia shprehur dëshirën Zotit të Madhërishëm, sepse do t’i vijë turp që t’i kërkojë përmbushjen e dëshirës së tij. Por ai nuk do të mund të përmbahet gjatë dhe më në fund, do të lutet: “O Zot! Më ço tek ajo pemë dhe pas kësaj nuk do të të kërkoj gjë”.

Atëherë, Zoti i Madhërishëm do ta çojë atë tek ajo pemë. Nga ky vend, edhe pse nga larg, ai do të fillojë të shikojë portën e xhenetit. Duke mos duruar as këtu, ai do të lutet: “O Zot! Më ço të paktën te porta e xhenetit! Nuk po të kërkoj të më fusësh në të”. Zoti i Madhërishëm do ta pyesë atë: “Mos do të Më kërkoish të të plotësoj ndonjë dëshirë tjetër pastaj?” “Jo”, do t’i përgjigjet ai.

Atëherë Zoti i Madhërishëm do ta sjellë atë te porta e xhenetit. Por si mund të durojë robi mu te dera e xhenetit? Ai sërish do t’i kërkojë Zotit: “O Zot, të lutem, më fut në xhenet. Mos më jep bekimet e tij, por dua vetëm të rri brenda!”

Zoti do të qeshë dhe do të shprehet: “Dëshirat e robit Tim nuk kanë të sosur!”





dhe do t'i përgjigjet: “Hyr në xhenetin Tim, qëndro ku të duash duke përfutur nga bekimet e tij!”

Kështu që, Zoti i Madhërishëm së pari i tregon një shfaqje të vogël robit. Njeriu i dëlirë si engjëll, hutohet nga madhështia e shfaqjes më të vogël të Zotit dhe ai i kërkon që t'i tregojë shfaqjen e një niveli më të lartë. Kështu do të vijojë. Por Zoti i Madhërishëm është i Pakufishëm dhe për këtë arsye, robi do ta përfshijë Atë vetëm sipas kapacitetit të vet.


Sundimi i Tij shtrihet mbi qiejt e mbi tokën


Pastaj Zoti thotë: وَسِعَ كُرْسِيُّهُ السَّمَاوَاتِ وَالْأَرْضَ “Sundimi i Tij shtrihet mbi qiejt e mbi tokën”.

Pra, Ai ka dijeni të plotë për çdo gjë të tokës e të qiejve. Asgjë nuk është jashtë dijes së Tij. Kurse dija e njeriut është shumë e kufizuar. Shumë herë njeriu mendon për diçka që ajo është e mirë, por më pas i rezulton e kundërt. Për shembull, Hazret Mesihu i Premtuar ^{a.s.} për Mir Abas Aliun të Ludijanës kishte dijeni që ishte i dëlirë dhe për këtë arsye edhe e lëvdoi. Por deri atëherë, Zoti i Madhërishëm nuk ia kishte treguar fundin e tij, andaj në atë kohë, ai nuk mund të dinte se po ky njeri një ditë do të hiqte dorë nga besimi. Më vonë, Zoti ia mësoi edhe këtë gjë. Shkurt, dija e njeriut është e kufizuar dhe vetëm Zoti i Madhërishëm ka dijen e përsosur dhe absolute, që e përfshin çdo gjë. Gjithashtu, asnjë njeri nuk mund ta përfshijë dijen e Zotit.

Kurani është i pari që foli për matjen e universit përmes dritës

Fjalët “Sundimi i Tij shtrihet mbi qiejt e mbi tokën” tregon edhe një kuptim tjetër shkencor dhe që është madhështor. Ato tregojnë se gjerësinë e gjithësisë nuk e di askush përveç Allahut të Madhërishëm. Astronomia siç është e zhvilluar sot, asnjëherë nuk ka qenë e tillë. Sot, gjerësia e gjithësisë nuk matet me milje, por me shpejtësinë e dritës. Drita shkon 180 mijë milje në një sekondë dhe gjerësinë e gjithësisë e matin me këtë shpejtësi të dritës. Edhe kjo vërtetoi fjalët e Kuranit, ku thuhet: اللَّهُ نُورُ السَّمَوَاتِ وَالْأَرْضِ “Allahu është drita e qiejve dhe e tokës”.⁶





Sepse ky ajet na paratregoi që nuk mund ta përfytyronim gjerësinë e universit, përveç se me anë të dritës dhe të shpejtësisë së saj. Për një sekondë drita shkon 180 mijë milje larg. Në një minutë, ajo shkon 10 milionë e 800 mijë milje. Këtë nëse e shumëzojmë me një orë, bëhen 248 milionë milje. Në 24 orë, pra në një ditë, drita kalon 15 miliardë e 552 milionë milje. Këtë shifër nëse e shumëzojmë me 360 ditë, pra me një vit, dalin 5 triliardë, 576 miliardë e 720 milionë milje. Ky quhet një vit drite. Por sipas astronomëve, gjerësia e universit është tre mijë vite drite. Kështu që, shifrën e fundit duhet ta shumëzojmë me tre mijë vjet. Shuma që do të dalë, në bazë të llogaritjeve bëhet i pallogaritshëm. Por edhe këto llogaritje nuk përfundojnë me kaq. Me shpikjen e mjeteve të reja, po ndryshojnë llogaritjet e shkencëtarëve. Pas Luftës së Parë Botërore ishte shpallur që gjerësia e universit është gjashtë mijë vjet drite. Më pas zbuluan se ajo nuk ishte e saktë, madje thanë se njerëzit nuk mund ta rrokin gjerësinë e universit, sepse ajo po rritet porsì fëmija. Kështu që, aktualisht, gjerësia e tij mendohet të jetë 12 mijë vite drite.


Ajeti i mëposhtëm i Kuranit Famëlartë e tregon edhe këtë sekret: وَالْأَرْضُ جَمِيعًا قَبْضَتُهُ يَوْمَ الْقِيَامَةِ وَالسَّمَاوَاتُ مَطْوِيَّاتٌ بِيَمِينِهِ “E gjithë toka do të jetë në pushtetin e Tij ditën e kiametit, dhe qiejt do të jenë të të palosura në Dorën e Tij të djathtë”.⁷


Diçka që është e mbështjellë në dorën e Zotit, si mund ta rrokë njeriu?! Për këtë arsye, kur dija e njeriut arrin të bëjë një kalkulum të caktuar rreth universit, Zoti i Madhërishtëm e zmadhon universin edhe më shumë. Kështu që, me këtë zbulim të ri [rreth madhësisë së universit], shkenca e ka pranuar të vërtetën e ajetit: “Sundimi (Kursiji) i Tij shtrihet mbi qiejt e mbi tokën” dhe se madhësinë e gjithësisë askush nuk mund ta tregojë, përveç Zotit të Madhërishtëm.

Ruajtja e të dyjave nuk e lodhë Atë

وَلَا يَئُودُهُ حِفْظُهُمَا “Ruajtja e të dyjave nuk e lodhë Atë”.

Sërish, dikush mund të pohonte: E pranoj se Zoti i Madhërishtëm nuk ka nevojë për oborrtarë që të marrë dijen [dhe lajmet] e botës, por Ai duhet të ketë disa ndihmës, që ta përkrahin në punën e Tij. Për këtë, Zoti thotë se Ai nuk ka






nevojë as për ndihmës dhe se të gjitha punët Ai i bën Vetë. Madje, asgjë nuk qëndron jashtë sundimit të Tij dhe Ai nuk lodhet nga organizimi i asnjë gjëje.

Ai është i Larti, Madhështori

وَهُوَ الْعَلِيُّ الْعَظِيمُ “Ai është i Larti, Madhështori”. Mbetet vetëm një pyetje pa iu përgjigjur. Dikush prapë mund të pohonte: E pranoj që Zoti nuk ka nevojë për askënd, as për të fituar dijen e as për të pasur ndihmë në punën e Tij, por Ai mund të ketë lënë pari, të paktën për të treguar madhështinë e Vet. Fjalët e fundit të këtij ajeti e hedhin poshtë edhe këtë ide, sepse thonë: “Ai është i Larti, Madhështori”. Pra, Ai është kaq i Lartë dhe kaq Madhështor, saqë askush dhe asgjë nuk ka mundësi të kontribuojë për t’ia shtuar madhështinë Atij. Përkundrazi, çdokush e çdo gjë që lidhet me Zotin, madhështohet. Andaj, mendimi se Zoti të ketë lënë oborrtares për madhështi, është i gabuar. Ai Vetë është i Larti dhe Madhështori.

Fjala el-Alij-ju tregon lartësinë e Tij, kurse fjala el-‘Adhīm tregon madhështinë e fuqive të Tij. Ky është Zoti që paraqet Islami. Sa keqardhje për atë që shkon diku tjetër, duke pasur një Zot të tillë! A mundet, vallë, që ai i cili konsumon gjëra të papastra, duke lënë ushqime shumë të mira dhe që vesh rroba të leckosura, duke lënë veshje të bukura, të quhet i zgjuar dhe i mençur?! Patjetër që jo. I mençur është ai që zgjedh më të mirën dhe s’ka kush të jetë më i mirë se Allahu i Madhërishtëm.

Ky komentim i Ajetul-Kursij është marrë nga: “*Tefsir-e-Kebir*”, vëll. 2, f. 576-585.



SHËNIME

1. *Kurani Famëlartë* 2:256

2. Er-Rāḡib el-Isfahānī, “*Mufredāt Elfādhul-Kurān*”, redaktor: Safvān Adnān Dāvūdī, botimi i katërt, boton: “Dārul-Kalem”, zëri: hā-jā-jā (حجى), Damask, 1430 h./ 2009, fq. 269; Edward William Lane, “*An Arabic - English Lexicon*”, vëllimi II, boton: “Librairie du Liban”, Beirut 1968, fq. 689.

3. Saʿīd el-Khūrī esh-Shertūnī, “*Akrebul-Mevārid fī Fusahil-ʿArabijjeti vesh-Shevārid*”, vëllimi i dytë, zëri: Kāf-wāw-mīm (فوم), Kum 1403 h./ 1983, fq. 1054.


3. Er-Rāḡib el-Isfahānī, “*Mufredāt Elfādhul-Kurān*”, redaktor: Safvān Adnān Dāvūdī, botimi i katërt, boton: “Dārul-Kalem”, zëri: Kāf-wāw-mīm (فوم), Damask, 1430 h./ 2009, fq. 691.

4. Saʿīd el-Khūrī esh-Shertūnī, “*Akrebul-Mevārid fī Fusahil-ʿArabijjeti vesh-Shevārid*”, vëllimi i dytë, zëri: wāw-sīn-nūn (وسن), Kum 1403 h./ 1983, fq. 1453.

5. Er-Rāḡib el-Isfahānī, “*Mufredāt Elfādhul-Kurān*”, redaktor: Safvān Adnān Dāvūdī, botimi i katërt, boton: “Dārul-Kalem”, zëri: kef-rā-sīn (كفس), Damask, 1430 h./ 2009, fq. 706; Edward William Lane, “*An Arabic - English Lexicon*”, vëllimi VII, boton: “Librairie du Liban”, Beirut 1968, fq. 2615.

6. *Kurani Famëlartë* 24:36

7. *Kurani Famëlartë* 39:68





Hazret Mirza Ghulam Ahmed ^{a.s.}

Mesih i Premtuar dhe Imam Mehdi



Ky Zot është kushti i Xhematit tonë

Që të më ndiqni mua, është e nevojshme të besoni me bindje se keni një Zot të Plotfuqishëm, të Qëndrueshëm, Krijues të gjithçkaje, dhe Ai është i Përherëshëm, i Përjetshëm dhe i Pandryshueshëm në atributet e Tij. Ai nuk është biri i dikujt dhe askush nuk është biri i Tij. Ai është i pastër nga vuajtjet, nga kryqëzimi e nga vdekja. Është i tillë që pavarësisht se është larg, gjendet afër dhe pavarësisht se është afër, gjendet larg dhe pavarësisht se është Një, ka manifestime të ndryshme.

Kur njeriu sjell në vete një ndryshim të ri, Ai për të bëhet një Zot i ri dhe me të fillon të ketë marrëdhënie me një manifestim të ri. Kështu, njeriu në bazë të ndryshimit që bën në veten e tij, shikon ndryshim edhe në Zot. Por në të vërtetë, Zoti nuk pëson ndonjë ndryshim, përkundrazi, Ai është i Pandryshueshëm përgjithmonë dhe zotëron përsosmërinë absolute, por njeriu gjatë ndryshimeve të gjendjes shpirtërore, kur anon nga mirësia, Zoti i shfaqet me një manifestim të ri. Në çdo kohë sa herë njeriu bën një përparim të qenësishëm, edhe fuqia e Zotit të Madhërishëm i shfaqet me një përparim të tillë. Ai tregon fuqinë e Tij të jashtëzakonshme, vetëm atje ku shfaqet ndryshimi i jashtëzakonshëm. Kjo është pikërisht baza e mrekullive dhe e ndodhive të jashtëzakonshme.

Ky Zot është kushti i Xhematit tonë. Atë besojeni dhe Atij jepini përparësi mbi veten tuaj, mbi rehatinë tuaj dhe mbi të gjitha lidhjet tuaja. Provoni me vepra e me guxim vërtetësinë dhe besnikërinë në rrugën e Tij. Njerëzit e botës nuk i japin Atij përparësi mbi të dashurit e tyre, por ju jepini përparësi, në mënyrë që të shënoheni në qiell në Xhematin e Tij.

(“Arka e Nuhut”, f. 33,34 Islam International Publications Ltd., Tiranë, 2020)



Pagja e paarrizhme?!
Pse duhet të kthehemi te Zoti?

Dr. Nasim Rehmatullah

Jemi përpjekur sipas mënyrës sonë. I kemi arsyetuar veprimet tona. Megjithatë paqja na mungon akoma. Paqe nuk do të thotë të mos kesh probleme, por që Zoti të jetë prezent në jetët tona. Ligësia në shpirt ka shkaktuar shkatërrimin e moralit dhe humbje të etikës, ku ne si shoqëri që kemi pranuar edhe sjelljen më të keqe si normë, nuk arrijmë të kuptojmë se në çfarë mase na ka mposhtur e keqja. Ne krijojmë ligje që janë në kundërshtim me ligjet Hyjnore. Ne po luftojmë me Perëndinë dhe po përballemi me pasojat.

Njerëzit e mirë e reflektojnë këtë mirësi të Zotit. Nëse ulet forca pozitive e së mirës te njeriu, fillon të zërë vend e keqja. E keqja nuk largohet vetëm me fjalë. Në fakt vetëm se dekompozohet. E keqja mund të tejkalohet vetëm me mirësi dhe besim. Nderi dhe fisnikëria mund të tregohen vetëm duke jetuar dhe vepruar me drejtësi dhe pastërti. Prandaj, sido që të jenë rrethanat, ne duhet të qëndrojmë drejt së vërtetës, ndershmërisë dhe të vepruojmë me drejtësi.

Gjatë një fjalimi në vitin 1863, Abraham Linkoln u shpreh:

“...E kemi harruar Zotin. Kemi harruar dorën e mëshirshme që na ruajti në paqe... dhe kemi imagjinuar më kot, të tradhtuar nga zemra, se të gjitha bekimet

na vinin nga mençuria dhe virtyti i lartë yni. Të dehur nga sukcesi i vazhdueshëm, jemi bërë shumë të vetëmjaftueshëm sa për të ndier domosdoshmërinë e shëlbimit dhe ruajtjes së hirit, shumë krenarë sa për t’iu lutur Zotit që na solli në jetë.”

Fjalë të ndiera që vlejné edhe sot.

Hipokrizia, intoleranca dhe ekstremizmi që vërejmë këtu dhe në mbarë botën mund të ndëshkohen lehtësisht. Por, për t’i parandaluar ato që në rrënjë duhet të bëhen shumë përpjekje me vetë-reformim dhe revolucione të shumta. Kjo tragjedi mund të rezultojë për mirë. Ajo mund të çojë në një katarsis të mënyrave tona të dyshimta dhe të liga. Mund të jetë një katarsis dhe pastrim i shpirtit tanë. Me kalimin e kohës, mund të lindë një popull që jeton jetën me lutje, dashuri dhe dhembshuri.

Sipas një tradite të lashtë, Zoti e mbron njerëzimin pavarësisht nga shkeljet e shumta, sepse në çdo kohë ekzistojnë dhjetë njerëz të drejtë, të cilët shpengojnë njerëzimin me veprat e tyre të mira. Ky shëlbim mund të mos jetë i përhershëm.

E kemi të gjithë për detyrë, muslimanë dhe jo-muslimanë, arabë dhe jo-arabë, që të lëmë pas ndjenjat dhe të mos

luajmë lojëra të dyfishta. Bota është shumë e vogël, urtësia jonë e kufizuar, koha shumë e shkurtër sa për ta harxhuar edhe më shumë duke u përpjekur të fitojmë në kurriz të njerëzve të tjerë. Lufta nuk vendos kush ka të drejtë, por vetëm kush mbetet. Derisa të pranojmë se të gjithë njerëzit kanë të drejta të njëjta dhe se ka drejtësi, dinjitet, barazi dhe respekt për të gjithë, nuk do të ketë paqe.

Udhëheqja ka rëndësi. Ne kemi nevojë për udhëheqës për t'u marrë shembull dhe të cilët me ndershmëri, integritet dhe moral të lartë kontrollojnë ngjarjen dhe sfidojnë tendencën vetë-shkatërruese dhe dehumanizuese të shoqërisë sonë globale, duke folur me zë të lartë, duke rritur ndërgjegjësimin dhe duke theksuar që të jemi të vetëdijshëm për pasojat e veprimeve tona; dhe se dashuria dhe frika ndaj Zotit përbëjnë gjithë urtësinë.

Kjo duhet të jetë baza e vërtetë e të gjitha veprimeve tona. E keqja do të kapërcehet vetëm me lutje të vazhdueshme, kthim pas, drejtësi, dhembshuri dhe dashuri. Profeti i Islamit e ringjalli botën përmes lutjeve dhe faljes në errësirën e natës.

Nëse ekziston një farë shprese për civilizim, që një bashkësi njerëzish frymëzues, fisnikë dhe të dobishëm të

dalin nga kakofonia aktuale e grindjeve, shkatërrimit, nihilizmit dhe fanatizmit, të gjithë ne duhet të kthehemi te Zoti dhe të ndryshojmë. Kalifi dhe Udhëheqësi botëror i Xhematit Musliman Ahmedia, një njeri i Zotit në tokë, na bën thirrje të gjithëve të jemi pranë Zotit, të lutemi, të duam dhe të tregojmë dhembshuri. Le të ndjekim zërin që na thërret në emër të Zotit. Le të kthehemi te Zoti.

Lutje për të kërkuar riskun dhe paqen

Gjatë ndërtimit të Shtëpisë së Allahut, Hazret Ibrahim ^{a.s.} i ishte lutur Zotit që t'i siguronte paqe qytetit të Mekës dhe risk banorëve të tij dhe, gjithashtu, fëmijët e tij t'i mbante larg idhujtarisë. Zoti ia pranoi të gjitha këto lutje.¹

رَبِّ اجْعَلْ هَذَا بَلَدًا آمِنًا وَارْزُقْ أَهْلَهُ مِنَ الثَّمَرَاتِ
مَنْ آمَنَ مِنْهُمْ بِاللَّهِ وَالْيَوْمِ الْآخِرِ

O Zoti im! Bëje këtë qytet të paqes dhe ushqej banorët e tij, që besojnë në Allah dhe në ditën e fundit, me fruta të çdolloji.²

SHËNIME

1. Xhelalud-din es-Sujuti, "Ed-Durrul-Menthur", vëll. 4, f. 86.

2. Kurani Famëlartë 2:127.

Mjeti për t'u pastruar është namazi që kryehet me përgjërim

Çfarë është namazi? Ai është lutje që parashtrohet me përgjërim, duke lartësuar, lavdëruar dhe madhëruar Zotin, duke i kërkuar falje Atij (istigfari) dhe duke i dërguar salavate të Dërguarit të Tij. Andaj, kur të falni namazin, mos u mjaftoni vetëm me fjalët arabe, si njerëzit e pavëmendshëm, sepse namazi dhe istigfari i tyre të gjitha janë thjesht zakone, që nuk kanë asnjë lidhje me realitetin.

Prandaj, kur ju të falni namazin, përveç pjesës së Kuranit, sepse ajo është fjala e Zotit dhe përveç pjesës së lutjeve të Profetit, sepse ajo është fjala e Profetit, të gjitha lutjet e tjera bëjini me përgjërim në gjuhën tuaj, në mënyrë që kjo përlësi e ky sinqeritet të kenë ndikim në zemrat tuaja. ...

Namazi ju sjell zgjidhje për fatkeqësitë e ardhshme. Ju nuk e dini se çfarë fati do t'ju sjellë e nesërmja. Andaj, përpara se t'ju vijë dita e re, përgjërohuni pranë Mikut tuaj, që juve t'ju vijë e mbarë dhe e bekuar.¹

1. Hazret Mirza Ghulam Ahmed ^{ra}, "Mësimi ynë", Islam International Publications Ltd., Tiranë, 2020, f. 40,41



Depresioni shenjat dhe trajtimi

Samar Hafeez

Psikologe Klinike dhe e Këshillimit

Të gjithë ne ndihemi të trishtuar herë pas here; për shkak të një note të keqe të marrë në provim, një debati që mund të kemi pasur me njeriun tonë të dashur, vlerësimeve jo të mira në punë, mosmarrëveshjeve me motrat a vëllezërit, dhe shumë probleme të tjera në jetë që ushtrojnë një lloj presioni dhe na bëjnë të ndihemi keq.

Në shumicën e rasteve, këto mendime dhe ndjesi negative zgjasin për pak ditë dhe fillojnë të veniten. Zakonisht ato nuk ndërhyjnë apo pengojnë aktivitetet tona të përditshme, dhe shumica prej nesh fillojnë të ndihen mirë pas një bisede konstruktive ose moment gazmor me një anëtar familjeje, koleg ose mik.

Por, nëse vuani nga depresioni, do t'ju duket sikur i keni gjithmonë këto mendime dhe ndjesi negative, që jua bëjnë jetën të zymtë. Duket sikur kjo gjendje e keqe nuk përmirësohet apo largohet, por mund të vazhdojë për muaj me radhë, ndoshta edhe vite, duke ju shkaktuar ankth ose probleme në marrëdhëniet shoqërore, profesionale ose fusha të tjera të veprimit.

Depresioni është më shumë se thjesht trishtim; është quajtur si problem shëndetësor mendor, aktualisht, numër një në botë.

Disa njerëz përjetojnë pak simptoma e të tjerë më shumë, ndërkohë që mund të përkeqësohen apo të përmirësohen me kalimin e kohës. Disa nga këto shenja dhe simptoma përfshijnë ndjesinë e mungesës së interesit apo dëshirës për t'u përfshirë në aktivitete të ndryshme, ndjesinë e mërzisë, fajit,

melankolisë, ndihesh i pavlerë ose i pashpresë shumicën e kohës, gati çdo ditë; duke menduar negativisht, pëson rënie të konsiderueshme në peshë edhe pa mbajtur dietë, ose shtim në peshë (ndryshim të më shumë se 5% të peshës trupore brenda një muaji), rënie apo shtim të oreksit, pagjumësi ose hipersomnia (përgjumje e tepërt) gati çdo ditë, agjitacion ose vonesa psikomotore (dromethënë nervozizëm dhe dembeli), pamundësi për t'u përqendruar, mendime të përsëritura të vdekjes ose të ideve vetëvrasëse, ose edhe përpjekje për vetëvrasje.

Prezenca e këtyre 5 apo më shumë simptomave të përmendura më sipër përgjatë një periudhe prej 2 javësh dhe mosshfaqja e asnjë shenje për përmirësim mund të paralajmërojnë zhvillimin e këtij problemi mendor.

Depresioni është një problem heterogjen që ka një sërë faktorësh rrezikues, duke përfshirë faktorët gjenetikë, mjedisorë dhe psikologjikë. Mund të shfaqet në çdo moshë, ndërkohë që predispozitat janë më të larta që të shfaqet në adoleshencë.

Ngjarjet e këqija në jetë, trauma, abuzimi seksual, stresi kronik, abuzimi me substancat e jashtëligjshme, shtatzënia, sëmundjet fizike kronike, si kanceri, goditja në tru dhe diabeti mund të jenë disa nga shkaqet e depresionit. Për disa individë, influenza të ndryshme në jetë dhe mënyra si i interpretojnë ato duket të jetë shkak kryesor. Në këtë artikull do të shohim reagime të ndryshme ndaj depresionit.

Ju ndiheni ashtu siç mendoni

Depresioni është një sëmundje që kryesisht rezulton nga mendime negative dhe ndjesi të këqija. Qëndrimet pesimiste të palogjikshme luajnë një rol kryesor në shfaqjen dhe përkeqësimin e të gjitha simptomave të depresionit.

Një studim mbi 30-vjeçar konfirmon që njerëzit me depresion priren drejt mendimeve negative që i bëjnë të ndihen të stresuar. Këto mendime janë edhe simptomat më shpesh të anashkaluara të depresionit. Ato përmbajnë çelësin për lehtësimin e depresionit, prandaj këto simptoma nuk duhen anashkaluar.

Gjendja emocionale dhe mënyra e të vepruarit varen tërësisht nga mënyra si i interpretoni gjërat. Një fakt i njohur neurologjik është se para se të përjetoni ndonjë ngjarje, filloni e përpunoni në mendje dhe i jepni një lloj kuptimi, para se ta ndjeni apo reagoni ndaj saj.

Shenjat e depresionit

Më poshtë janë të listuara disa çrregullime njohëse (mënyrat si mendja na bind për diçka që realisht nuk është e vërtetë) që janë fillesat e depresionit.

Të menduarit gjithçka ose asgjë: Kjo ndodh kur i sheh gjërat vetëm bardhë e zi. Për shembull, nëse nuk keni qenë plotësisht perfekt gjatë një performance, e shihni këtë si dështim total. Pra,

mendësia e tillë nuk ka një pikëpamje të mesme.

Përgjithësim i gjithçkaje: Në këtë rast, një përvojë negative të kaluar më parë ju e përgjithësoni me të gjitha ndodhitë e tjera duke e parë si model humbjeje.

Filtër mendor: Ju kapeni pas një detaji të vetëm negativ rreth një çështjeje ose situatë.

Pesimizëm: Ju nuk besoni në përvojat pozitive dhe insistoni që nuk kanë rëndësi për një arsye a tjetër.

Arrini në përfundime të menjëhershme: Ju arrini në përfundime negative pa pasur asnjë fakt që i vërteton.

Zmadhim (ekzagjerim) dhe minimizim: Quajtur ndryshe “mashttrim binokular”, sepse ju ose i ekzagjeroni gjërat ose i anashkaloni ato. Kjo ndodh kur vëreni defektet apo gabimet tuaja dhe i ekzagjeroni edhe më shumë, ndërkohë që minimizoni pikat tuaja të forta.

Arsyetim emocional: Nëse i shihni gjërat përreth jush si negative, ju mendoni që ato ashtu janë. “Është e vërtetë sepse kështu e ndjej”. Një efekt anësor i zakonshtëm i arsyetimit emocional është zvarritja e gjërave.

Deklaratat “dubet”: Ju përpiqeni të motivoni veten duke thënë që duhet të bëni diçka, por me kalimin e kohës këto

deklarata mund t'ju vënë nën presion ose të ndiheni të pamotivuar.

Etiketimi të gabuara: Kjo është një formë edhe më e rëndë se përgjithësimi i gjithçkaje. Kur bëni një gabim, i vini vetes një emërtim të gabuar, si ndjesia e një “humbësi”. Po kështu, kur dikush tjetër ju mërzit apo ju nxeh, e piketon për keq.

I personalizoni gjërat: Kjo ndodh kur filloni të fajësoni veten për gjithçka dhe të merrni përgjegjësi edhe për gabimet apo dështimet e të tjerëve, kur nuk është aspak e nevojshme.

Trajtimet e depresionit

Për format e lehta të depresionit, do të rekomandoja që të identifikoni me kujdes të gjitha mendimet negative dhe ndjesitë apo reagimet përkatëse. Shkruajini këto mendime diku në fletore, duke përdorur “teknikën me tri kolona”. Në kolonën e majtë shkruani mendimet negative që ju vijnë ndër mend, në kolonën e mesme shkruani problemet, ndërsa në kolonën e djathtë bëni një interpretim më realist ose racional të problemeve të caktuara.

Ky aktivitet i të shkruarit çdo ditë do t'ju ndihmojë në rritjen e vetëbesimit dhe shpresoj të qetësoheni emocionalisht.

Provoni të praktikoni gjithashtu

meditimin, që është forma më e mirë për të qenë më afër Zotit të Madhërishëm me lutje të përditshme, me singëritet dhe shpresë. Njerëzit që besojnë ose që anojnë nga spiritualiteti, falin dhe harrojnë shpejt çdo ndodhi të keqe, duke parandaluar kështu stresin kronik që mund të jetë një nga shkaqet e depresionit.

Është shumë e rëndësishme që të mendoni me optimizëm dhe të rrethoheni nga njerëz që ju inkurajojnë dhe motivojnë.

Regjistrimi dhe rikujtimi i të gjitha eksperiencave pozitive dhe të çmuara në jetë, mund t'ju ndihmojë të ndiheni më mirë, më të gëzuar dhe më falënderues.

Aktiviteti i moderuar fizik të paktën gjashtë ditë në javë ka gjithashtu një ndikim shumë pozitiv në shëndetin mendor. Duke eksploruar natyrën dhe duke marrë ajër të pastër sa më shpesh, mund të ndiheni më mirë. Bëni atë çka doni dhe merrni sa më shumë rreze dielli, duke qenë se prodhimi i vitaminës D në trup ndihmon në lehtësimin e simptomave të depresionit.

Mos qëndroni të vetmuar dhe kryeni aktivitete që ju bëjnë të ndiheni mirë.

Depresioni kur kalon në një shkallë të moderuar ose të rëndë, mund të shkaktojë probleme edhe më të

mëdha, dhe mund t'ju marrë aftësinë e të menduarit dhe të arsyetuarit. Në këto raste do të rekomandoja që të konsultoheni me një profesionist të shëndetit mendor për të bërë sa më shpejt të jetë e mundur një ekzaminim të plotë të shëndetit mendor.

Nuk keni përse të jetoni me depresion, sepse për fat të mirë gjithmonë keni një rrugëdalje. Edhe rastet më të rënda të depresionit mund të trajtohen me ndihmën e ilaçeve dhe psikoterapisë.

Nëse njihni dikë që vuan nga depresioni, ju lutem, ofrojin mbështetje emocionale me durim, mirëkuptim, dashuri, ndjeshmëri dhe inkurajim. Përfshijeni atë në biseda dhe dëgjojeni me kujdes. Ftojini për një shëtitje ose udhëtim. Mos i injoroni shenjat e depresionit; nëse një person shfaq ndonjë tentativë për vetëvrasje, kërkoni menjëherë ndihmë për të.

E rëndësishme është t'i ofroni shpresë, që zhduk thuhetse çdo problem ekzistues.

(Ju lutemi, konsultohuni gjithmonë me doktorin ose një mjek specialist për të diagnostikuar problemet shëndetësore dhe ndiqni rekomandimet e një mjeku të kualifikuar).

Burimi: <http://www.alhakam.org/living-with-depression/>



MENDIMI JUAJ ËSHTË I RËNDËSISHËM PËR NE

Na shkruani komentet, mendimet
dhe sugjerimet tuaja në WhatsApp,
Viber ose Telegram në numrin

+355 69 4644 888

ose në email

amj.albania@gmail.com

VËRTETËSIA

Çfarë është Ramazani?

Allahu i Madhërishëm në Kuranin Famëlartë thotë:

يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا كُتِبَ عَلَيْكُمُ الصِّيَامُ كَمَا كُتِبَ عَلَى الَّذِينَ مِن قَبْلِكُمْ لَعَلَّكُمْ تَتَّقُونَ ﴿٢١٨﴾

O ju që besuat! Ju obligohen agjërimet ashtu siç u ishin obliguar atyre që ishin para jush, që të bëheni të druajtur (ndaj Zotit).¹

Ai gjithashtu thotë:

شَهْرُ رَمَضَانَ الَّذِي أُنْزِلَ فِيهِ الْقُرْآنُ

Muaji ramazan është ai në të cilin u zbrit Kurani si udhërrëfyes për njerëzit dhe me shenjat e qarta që përbëhen nga shpjegimet e udhëzimit dhe çështjet dalluese (të së vërtetës nga e rema).²

Është bekim dhe mirësi e Zotit të Madhërishëm që Ai na mundëson ne muslimanëve çdo vit mundësi të shumta për ngritjen tonë morale dhe shpirtërore. Njëra prej këtyre mundësive më të mëdha na ofrohet në formën e muajit të bekuar të Ramazanit.

Ky është muaji për të cilin i Dërguari i Allahut ^{s.a.v.s.} tha:

قَالَ أَبُو سَلَمَةَ حَدَّثَنِي عَبْدُ الرَّحْمَنِ بْنُ عَوْفٍ، عَنْ رَسُولِ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ أَنَّهُ ذَكَرَ شَهْرَ رَمَضَانَ فَفَضَّلَهُ عَلَى الشُّهُورِ وَقَالَ

”مَنْ قَامَ رَمَضَانَ إِيمَانًا وَاحْتِسَابًا خَرَجَ مِنْ ذُنُوبِهِ كَيَوْمٍ وَلَدَتْهُ أُمُّهُ“

“Ai që adhuron gjatë muajit të Ramazanit në gjendje besimi dhe me përkushtimin e duhur, del kaq i pastër nga mëkatet e tij, siç ai ishte i pastër nga ato ditën kur e kishte lindur nëna e tij”.³

Duke treguar rëndësinë e muajit të Ramazanit, Hazret Imam Mehdiu, Mesihu i Premtuar, shërbëtori i vërtetë i Profetit Muhammed ^{a.s.} thotë:

“Me fjalët ‘muaji Ramazan është ai në të cilin u zbrit Kurani’, kuptojmë rëndësinë e Ramazanit. Sufistët thanë se ky muaj është shumë i dobishëm për ndriçimin e zemrës. Gjatë tij njeriu shpesh përjeton vizione (keshf). Namazi ia pasturon shpirtin dhe agjërimi ia ndriçon zemrën.

Pastrim i shpirtit do të thotë që njeriu të fitojë largësinë nga epshet e *nefsit amarah* (që nxit për të keqen) dhe ndriçim i zemrës do të thotë që atij t’i hapet dera e vizionit (keshfit), në mënyrë që ta shohë Zotin. Pra, fjalët “në të cilin u zbrit Kurani” këtë gjë e tregojnë. Nuk ka aspak dyshim që shpërblimi i agjërimit është shumë i madh”.⁴

SHËNIME

1. Kurani Famëlartë 2:184.

2. Kurani Famëlartë 2:186.

3. “Sunen en-Nesa’i”, Kitabus-saum, hadith numër 2208.

4. Hazret Mirza Ghulam Ahmed ^{a.s.}, “Malfuzat”, vëll. 2, botimi 2003, Rabvah, f. 561-562.

PSE NJË KOMB MBETET I VARFËR?

Prof. dr. Abdus Salam

Një analizë për lidhjen mes mungesës së arsimit dhe varfërisë, nga fituesi i çmimit Nobel, prof. dr. Abdus Salam, drejtues i Qendrës Ndërkombëtare për Fizikën Teorike, Trieste, Itali. Artikulli i mëposhtëm është publikuar në revistën mujore në gjuhën urdu `Tahzebul Akhlaq', Universiteti "Aligarh Muslim", Indi, Janar 1986. Dr. Abdus Salam është shkencëtari i parë musliman në botë që mori çmimin Nobel. Ai ishte një prej anëtarëve të devotshëm të Xhematit Musliman Ahmedia.



Photo by Pixabay from Pexels

Mësuesi i mirë i mbetet në kujtesë nxënësit për gjithë jetën

Në moshën 12-vjeçare u pranova në Kolegjin Jhang, Pakistan, në vitin 1938. Kalova 4 vjet aty. Në ato kohëra, edhe shkolla e mesme (klasa 9, 10, viti i parë dhe i dytë) zhvillohej në të njëjtin kolegji. Pjesa më e madhe e studentëve në kolegji ishin indianë. Kisha fatin e mirë që të merrja mësim nga disa prej mësuesve më të ditur dhe më të dashur.


Shaikh Ijaz Ahmed ishte mësuesi i anglishtes, Sufi Zia-ul Hak ishte mësuesi i gjuhës arabe, Khawaja Mirajud Din më mësoi gjuhën persiane, ndërsa mësuesit e matematikës dhe lëndëve shkencore ishin të feve hindu dhe sikh.

Më të dalluarit në matematikë dhe lëndët shkencore në atë kohë konsideroheshin studentët të feve hindu dhe sikh. Lala Badri Nath dhe Lala Ram Lal ishin të dalluar në matematikë, Lala Hans Raj në fizikë, ndërsa për lëndën e kimisë më i dalluari ishte Lala Naubat Rai.

Mësuesi mund të zhvillojë ose të dëmtojë nxënësin

Në atë kolegji u vendosën edhe themelet e karrierës sime akademike. Të gjitha arritjet e mia të mëvonshme ia atribuoj këtij institucioni arsimor dhe mësuesve shumë të përkushtuar. Besoj fort se përshtypja dhe vëmendja që kushton

*Abdus
Salami pas
provimit
të maturës*



një mësues, mund të zhvillojnë ose të dëmtojnë një nxënë. Ju jap një shembull. Në vitin e parë të kolegjit, u fiksova në përdorimin e disa fjalëve anglisht që më dukeshin interesante.

Fillova t'i përdorja këto fjalë çdo ditë, edhe nëse ishin jashtë kontekstit. Mësuesi i anglishtes, Shaikh Ijaz Ahmed, një njeri shumë i respektuar, më kërkoi që të mos i përdorja këto fjalë kaq të vështira, por këshilla ra në vesh të shurdhër.

Kur përfundoi semestri (gjysmëvjetori), mësuesi i anglishtes më penalizoi duke më hequr 5 pikë për çdo fjalë të vështirë apo të papërshtatshme që kisha përdorur. Dihet se si ishin rezultatet e provimit të anglishtes. Por, nuk mjaftoi me kaq, pasi mësuesi vendosi të nxjerrë fletën time të provimit para gjithë klasës, ku i tregoi se kisha përdorur në provim fjalë të papërshtatshme të anglishtes.

Në atë kohë nuk e vlerësoja këtë qëndrim


të mësuesit ndaj meje, por kur e mendoj tani, mendoj se ishte ndëshkimi më i mirë. Si rezultat i këtij ndëshkimi, ndalova së përdoruri fjalë të vështira.

Prindërit që brumosin fëmijët e tyre duke iu bërë shembull

Edukimi që mora, në pjesën më të madhe, ishte falë mësuesve të mi, por mbi të gjitha, falë përkushtimit të pamasë të babait tim të nderuar dhe lutjeve të tij të devotshme për mua.

Në atë kohë, provimi i maturës në provincën e Penxhabit (Punjab) ishte më shumë si një ndeshje mundjeje. Mundës nga shkolla të ndryshme do të shfaqnin aftësitë e tyre në këtë provim, sidomos nxënësit nga shkollat Hindu, Sanatam Dharam dhe Arja, të cilët konsideroheshin si mundës të frikshëm. E kujtoj edhe tani ditën kur do të dilnin rezultatet e provimit, kur isha ulur në zyrën e babait në godinën e Gjykatës Jhang. Rezultatet e provimit ishin publikuar në gazetat e qytetit Lahore, dhe po atë ditë gazeta vajti nga koha e drekës në stacionin e trenit Jhang. Babai kishte porositur një nga nëpunësit e tij që t'ia sillte gazetën direkt, dhe menjëherë kishin filluar të vinin mesazhet telegrafike me përgëzime nga Lahor.

Siç e përmenda pak më parë, dalja e rezultateve të provimit të maturës



ishte një ngjarje kombëtare në atë kohë. Kjo sepse hindutë kishin filluar në atë periudhë ta përkrahnin arsimimin në masë të gjerë. Kujtoj të jem rikthyer në shtëpi aty nga ora 2 e pasdites, pasi kisha udhëtuar me biçikletë nga Maghiana në qytetin Jhang. Lajmi se kisha dalë i pari në provim kishte mbërritur tashmë në qytetin Jhang. Duhet të kaloja në oborrin e Komisarariatit të Policisë për të shkuar në shtëpinë time në *Buland Darwaza*. E kujtoj shumë mirë atë ditë kur tregtarët hindu, që normalisht duhet t'i kishin mbyllur dyqanet për shkak të vapës së drekës, ishin duke qëndruar jashtë derës së dyqanit për të më përgëzuar. Respekti që treguan ndaj meje dhe përkrahja e tyre për arsimimin kanë lënë një përshtypje të shkëlqyer në mendjen time.

Metodologjia e studentëve që i përkushtohen dijes

Nga qyteti Jhang shkova në Kolegjin

Shtetëror (Publik) të Lahorit dhe pastaj në Universitetin e Kembrixhit, Angli. Në Universitetin e Kembrixhit mësova një sërë metodash të reja studimore nga studentët anglezë. Në këtë universitet, studentët uleshin nëpër klasa në një mënyrë shumë të rregullt, siç ulen muslimanët kur falen në xhami. Para se të vinte lektori në klasë kishte një heshtje totale. Gjatë leksioneve, do të shikoje që studentët përdornin stilograf me 4 lloje të ndryshme ngjyrash dhe vizore për të vizatuar vija të drejta. Fletoret e tyre të shkrimit ishin të shkruara në një mënyrë aq profesionale sa dukej sikur janë shkruar nga një kaligraf. Shokët e mi të klasës kishin ardhur në Universitetin e Kembrixhit direkt pas përfundimit të shkollës së mesme. Ata ishin më të rinj se unë në moshë, por vetëbesimi dhe vendosmëria e tyre ishin në një nivel aq të lartë sa mua m'u deshën dy vite që të arrija të njëjtat standarde. Ata kishin studiuar në shkolla të tilla ku mësuesit i inkurajonin nxënësit që të ndiqnin arsimin e lartë dhe u kujtonin që ishin bij të një kombi të madh ku kishte lindur një njeri si Isak Njutoni. Këta mësues kishin ngulitur në mendjen e fëmijëve se ata kishin trashëguar dije të thella mbi shkencën dhe matematikën, dhe mund të bëheshin si Njutoni.

Në Universitetin e Kembrixhit, metoda e disiplinës ishte krejtësisht e re dhe e çuditshme për mua. Mund të jepje një provim në Shkollën e Lartë vetëm

njëherë. Nëse ngelje në provim, atëherë nuk mund ta përsërisje. Në konviktet e studentëve ishte si rregull që çdo student duhej të kthehej në dhomën e tij para orës 10 të mbrëmjes. Nëse ktheheshe para mesnatës, dënimi do të ishte 1 qindarkë, ndërsa nëse një student kthehej pas mesnate, ai do të ndëshkohej me izolim për 7 ditë. Nëse kjo përsëritej tri herë, studenti përjashtohej nga universiteti. Çdo student trajtohej si një i rritur, saqë mbante përgjegjësi për të gjitha veprimet e tij. Studenti nuk përfshihej në biseda të kota, pasi do të ndëshkoheshin të gjithë njësoj, ndëshkime të cilat, disa studentë i pranonin me burrëri.

Një student në Universitetin e Kembrixhit duhej të bënte edhe punë krahu. Kujtoj ditën e parë në Kolegjin St. John në Londër. Kur arrita, mora një taksì nga stacioni i trenit pasi kisha një valixhe të rëndë, që peshonte 40 kilogramë. Në hyrje të kolegjit, i kërkova portierit të më ndihmonte. Ai më drejtoi për të marrë një karrocë dore dhe më tha që ta mbaja vetë. Këto incidente që po jua rrëfej nuk janë për të kaluar kohën e lirë, por kryefjala është që këto histori të shkurtra, me domethënie, të mësojnë shumë gjëra për jetën.

Rënia ekonomike e vendit është e lidhur fort me arsimin e çorientuar


Duhet të mendoni rreth faktit që

ekziston një lidhje e fortë mes rënies sonë ekonomike dhe arsimit. Arsimi i çorientuar dhe jo i përshtatshëm është në fakt një krizë kombëtare. Unë mendoj se kombi ynë po kalon nëpër një krizë të rëndë, për të cilën arsyeja është se nuk është zhvilluar një sistem i duhur arsimor.

Qëllimi kryesor i një sistemi arsimor, sipas mendimit tim, është të zhvillojë karakterin e një personi. Një karakter që zhvillohet gjatë viteve të shkollës, rrallë se ndryshon për pjesën tjetër të jetës. Megjithatë, këtu nuk do të ndalem në karakterin personal. Këtu po u referohem aspekteve kombëtare të sistemit tonë arsimor. Më në fund, Zoti i Plotfuqishëm na dhuroi lirinë pas 200 vitesh skllavëri. Kjo ngjarje e rëndësishme ndodhi rreth 40 vite më parë, por deri më tani nuk kemi kultivuar asnjë ndjenjë të përkatësisë, vëllazërisë, unitetit dhe të qenit një komb i bashkuar.

Kombi konsolidohet përmes zhvillimit arsimor

E vërteta është që, sapo të kishim fituar lirinë, objektivi kryesor i sistemit tonë arsimor duhet të kishte qenë forcimi i ndjenjës së përkatësisë dhe kombësisë. Ideja e kombësisë ka ndryshuar gradualisht në rajone të ndryshme të botës, edhe pse sot mund të përmenden shumë shtete, konsolidimi si komb i të cilave është mbështetur vetëm te lloji i



sistemit arsimor që ato zhvilluan.

Marrim si shembull Shtetet e Bashkuara të Amerikës, ku gjermanët, anglezët, italianët, suedezët dhe francezët jetojnë si një komb i madh. Arsyeja përse përmenda Amerikën është sepse njerëzit nga këto shtete europiane dhanë jetën gjatë Luftës së Fundit Botërore për një identitet tjetër. Këta njerëz në ShBA flisnin gjuhë të ndryshme para se të arrinin në Amerikë. Në shkollë, fëmijët amerikanë janë të familjarizuar me kushtetutën amerikane, heronjtë e Amerikës i dinë përmendësh, ditë e natë këta fëmijë dëgjojnë himnin kombëtar amerikan.

Poetët amerikanë, shkrimtarët dhe novelistët i shkruajnë veprat e tyre në atë mënyrë që çdo qoshe dhe cep i Amerikës është i dashur për këdo dhe për të gjithë. Çdo amerikan mësohet të dojë qytetin e tij, prandaj një shtetas amerikan e konsideron veten një qytetar të mijëra qyteteve.

Vende të largëta të Europës, nga ku

paraardhësit e tij kanë shkuar në ShBA, nuk sjellin ndonjë emocion ose ndjenjë të përkatësisë. Një europian i emigruar në Amerikë e mendon jetën të lidhur me tokën amerikane dhe se i përket vetëm Amerikës. Ai përpiqet ditë e natë për të promovuar shtetin ose qytetin e tij ku ai jeton, dhe kështu ndodh nëpër të gjitha shkollat, kolegjet, gazetatat, revistat dhe televizionet. Duhet sa më parë që sistemi ynë arsimor të promovojë këtë ndjenjë të rëndësishme të përkatësisë.

Kombit i sjellin lirinë arsimit dhe zhvillimi në shkencë

Kërkesa ime e dytë për ju është në lidhje me edukimin dhe me promovimin e shkencës dhe teknologjisë. India dhe Pakistani janë vende të prapambetura ekonomikisht, ku mesatarja e të ardhurave për një person është 70 dollarë në vit. Në krahasim me amerikanët, që fitojnë 50 herë më shumë, ndërsa një anglez fiton 20 herë më shumë, në Japoni 15 herë, Iran 8 herë, Turqi 8 herë, si dhe në Irak, Algjeri, Siri dhe Egjipt 6 herë më shumë. Pyetja ime për ju është: “Pse jemi të varfër si shtet?” Jam shumë dakord që pasuritë e shtetit tonë janë grabitur nga britanikët gjatë qeverisjes 100 vjeçare në Dehli, Penxhab dhe Sindh. Gjithashtu pranoj që amerikanët janë me fat, sepse kanë zbuluar një kontinent plot me pasuri natyrore, por pyetja lind:

“Si u bëmë skllëvër të britanikëve?”.

Nëse britanikët e njihnin artin e lundrimit në det dhe ne jo, atëherë kush ua mësoi atyre fillimisht këtë art? Nëse pushkët dhe armët e Robert Clive kishin një zejtarë më të mirë sesa ato të mbretit musliman Siraxhud-Deula, atëherë a mund të pyes se kush ua mësoi britanikëve këtë art të prodhimit të armëve të rënda? A nuk e kanë shpikur vetë këtë art, dhe pasi e shpikën, a nuk janë bërë mjeshtër të tij nëpërmjet arsimimit në vendin e tyre?!


Në betejën e famshme të Panipatit, sunduesi i madh musliman, sulltani Babar fitoi falë përdorimit të armëve të rënda të romakëve. Bizantinët (turqit romakë) i kanë sofistikuar më shumë këto armë pas shpikjes së tyre në vitin 1526, ndërsa pasardhësit e Babarit nuk iu interesoi që të krijonin një institucion ku mund të zhvillohej edhe më tej ky art në Indi. Nëse ju ka ndodhur të vizitoni Kostantinopojën (Stambolli i sotëm), do të shikoni që ideja e turqve për xhaminë ishte që, në njërën anë të ndërtesës të ishte spitali dhe në anën tjetër shkolla (medreseja). Kjo shkollë nuk do të shërbente vetëm për edukim fetar, por edhe për të mësuar artin e prodhimit të armëve. Për fat të keq, turqit që erdhën në Indi nuk ishin të interesuar të promovonin edukimin dhe

të mësuarit. Ata lanë pas si trashëgimi plot muze të shkëlqyera dhe varreza të shtrira si përkujtimore, por fatkeqësisht, jo shkolla apo vende mësimi për popullin e Indisë.

Çfarë ishte ajo që kombet që sot quhen të zhvilluara kanë pasur dhe që kombet e tjera nuk e kishin?

Më lejoni t'ju bëj një pyetje: Nëse Zoti i Plotfuqishëm i ka dhuruar popullit amerikan ushqim të bollshëm dhe një kontinent të madh, a nuk ishte vendosmëria e tyre që i solli ata në një tokë të panjohur përtej oqeanit? Nëse industria japoneze ka fituar famë ndërkombëtare, atëherë sa prej kësaj fame është falë organizimit të mirë të sistemit arsimor? Engjëjt e Zotit nuk zbritën tek japonezët për t'u mësuar atyre risitë teknologjike. Ka qenë një periudhë kur të mirat materiale dhe produktet japoneze konsideroheshin me cilësi shumë të dobët, por në ditët e sotme ato konsiderohen me cilësi shumë të lartë nga ana teknike.

E dini që, kompania British Leyland filloi e para të prodhonte makinat e vogla Morris, dhe më pas ishin japonezët që prodhuan makina në të njëjtën madhësi, por jo 1000 kubikësh, por 600 kubikësh dhe me të njëjtën fuqi motorike. Si është e mundur kjo?



20 vjet më parë, një amerikan, i njohur si profesor Townes, shpiku transistorin, një pajisje që përdoret kryesisht për përforcimin e rrymës elektrike. Ai ka fituar çmimin Nobel për këtë shpikje revolucionare. Për të zbuluar sekretin e transistorit dhe mënyrën e funksionimit, japonezët filluan menjëherë hulumtimet në Universitetin e Tokios. Përpjekjet e japonezëve sollën frytet e para për një hapësirë kohore shumë të shkurtër, dhe që atëherë ata janë konsideruar si mjeshtër në fushën e elektronikës. Jo vetëm që e rizbuluan transistorin, por ata e publikuan sekretin e transistorit në një revistë, që çdo pakistanez, indian, arab apo iranian mund ta vinte në përdorim, duke zhvilluar edhe më tej teknologjinë e transistorit. Pra, kush janë këta kampionë të dijes? A do e besonit që japonezët nuk e kanë ditur artin e të bërit të patkonjve? Thuhet që kur amerikanin Admiral Perry erdhi në Japoni me flotën e tij detare, japonezët tentuan t'i bllokonin hyrjen në port, por nga bombardimet u detyruan të lejonin hyrjen në port të flotës. Një natë u vodh një kalë nga anija e Admiralit dhe u rikthye ditën tjetër. Misteri pas kësaj

vjedhje të çuditshme ishte se japonezët donin që të shikonin patkonjtë e kalit, pasi shkenca e tyre e metalurgjisë nuk ishte zhvilluar deri në atë pikë sa të mund të bënin patkonj në Japoni.

Në Japoni, koha e provimeve konsiderohet si një periudhë vetëvrasjesh për studentët japonezë, pasi pranimi në universitet varet nga rezultatet e provimit të maturës. Standardi i këtij provimi është aq i lartë, sa asnjë shkollë për fëmijë në mbarë botën nuk e ndjek një praktikë të tillë aq të vështirë të provimeve në fizikë dhe kimi.

Gjatë kohës së provimit, askush nuk ka dijeni për përmbajtjen e pyetjeve, askush nuk proteston, askush nuk thyen xhamat e dritareve të ndërtesës ku mbahen provimet. I gjithë kombi, si nxënësit ashtu edhe prindërit, janë të kapluar nga emocionet e provimit, dhe të gjithë i pranojnë rezultatet e provimeve me stilin e zakonshëm japonez.

Gjatë muajit shtator (1985), kisha fatin që të vizitoja Republikën Popullore të Kinës. Një nxënës kinez hyn në klasë të tetë (ose në shkollë të mesme) kur është 12 vjeç, ndërsa rreth moshës 17-vjeçare ai përfundon të gjithë kurrikulën shkollore. Këto 8 klasë shkollë janë të barasvlershme me shkollën e mesme në Indo-Pakistan. Edukimi në këto 5 vite është i detyrueshëm dhe çdo nxënës kinez duhet të mësojë 12 lëndët

e mëposhtme, ku asnjëra nuk është zgjedhore: Nacionalizmi, Matematikë, Fizikë, Kimi, Biologji, Agrikulturë, Histori, Gjeografi, Artet Dramatike, Muzikë dhe Punëdore.

Çdo nxënës duhet të studiojë deri në fund të 12 lëndët. Mësuesit kinezë janë të vendosur që çdo nxënës duhet të studiojë shkencën njësoj sa artet.

Dikush mund të hamendësojë se meqë lëndët shkencore janë të detyrueshme, niveli i nxënësve 16 dhe 17 vjeç duhet të jetë më i ulët krahasuar me shkollën e mesme të ne. Për të zbuluar të vërtetën, unë mora vetë pjesë në një orë mësimi të matematikës dhe fizikës në një shkollë në Kinë. Mbeta pa fjalë kur pashë një nxënës vetëm 14-vjeçar duke mësuar rregullat e infinitit. Në pjesën tjetër të botës, rregullat e infinitit mësohen në shkollë të lartë.

Kinezët janë të vendosur tashmë që të fusin çdo teknikë të re industriale në vendin e tyre. Kina është shpallur Republikë Popullore 2 vite pas nesh, por falë vendosmërisë dhe përpjekjeve të tyre, kanë arritur që gjatë këtyre 40 viteve të jenë mjeshtër të shkencave elektronike. Fillimisht ata përpunonin 40.000 tonë metal në vit, ndërsa tani përpunojnë deri në 200.000 tonë në vit. Ata mund të prodhojnë tani pjesë të sofistikuara makinash. Çdo nxënës kinez kalon një ditë në punëtorinë e shkollës apo të

universitetit, që të praktikojë një zanat. Shkolla që përmenda më sipër, të cilën e vizitova, kishte nxënës 14 deri në 16 vjeç që prodhonin pjesë përbërëse për transistorin. Një grup tjetër dërgonin mineralin e kaliumit të karbonizuar në makinën e përpunimit dhe paketimit, për ta tregtuar më pas. Një grup prej 4 nxënësish vetëm 12-vjeçare ishin duke riparuar këpucët për të gjithë shokët e klasës. Një nga vajzat në grup na kërkoi që t'i hidhnim sytë kah dritaret e dhomës ku po punonin, të cilat ishin mbuluar me perde. Vajza na tregoi se kur kishin filluar të riparonin këpucët, kishin pasur pak turp dhe njëfarë pakënaqësie që do të riparonin këpucë me erë të keqe, dhe për ta zgjidhur këtë problem, ato kishin vendosur të mbulonin dritaret me perde. Me kalimin e kohës ato u mësuan dhe tani nuk kanë aspak turp për punën që bëjnë.

Besoj që është e domosdoshme që shkollat e fëmijëve tanë të jenë më produktive përgjatë viteve të shkollimit. Të gjithë nxënësit dhe mësuesit e shkollave, kolegjeve dhe universiteteve në Kinë i kalonin pushimet verore në fabrika dhe në fermat e fshatit.

Ndoshta ju mund të mendoni se unë jam duke e ekzagjeruar pak situatën, por më besoni, nëse dikush do të më tregonte që një vend aq i madh sa Kina është duke ecur përpara si një oqean i qetë, as nuk do ta besoja. Por, si të mohoj

atë çfarë kam parë me sytë e mi? Jo një herë, por tri herë kam udhëtuar për në Kinë. Akoma nuk është e lehtë për mua ta besoj që, afro 700 milionë njerëz mund të sakrifikojnë interesin e tyre personal për hir të kombit, dhe përveç kësaj, ata e kanë lidhur identitetin e tyre me kombin. Çdo person në atë vend të madh punon pa u lodhur ditë dhe natë. Qytetet e tyre dikur kanë qenë plot me plehra dhe mushkonja. Në Pekin, çdo 9 metra përgjatë kanalit të Dragoit, fiks mbrapa Pallatit Mbretëror, kishe plot insekte dhe plehra, që mund të mos ishin pastruar ndoshta asnjëherë gjatë 300 viteve të fundit. Por tani Pekini është një nga qytetet më të pastra, dhe gjithë meritat nuk shkojnë për pastruesit, por për ata që ndihmuan, si: juristët, mësuesit, nxënësit, politikanët dhe pronarët e dyqaneve. Kjo punë është falë një grupimi të studentëve, të cilët ishin në krye të kësaj lëvizjeje.

Teksa e vërtetë që sistemi kinez po punon në një mënyrë tepër produktive, sepse është i ndërtuar mbi demokracinë sociale. Një ministër i qeverisë kineze shkon në zyrë me biçikletë dhe e përdor makinën zyrtare vetëm kur duhet të shoqërojë një diplomat të huaj. Kjo sjellje shembullore tregon se kombi kinez është i gatshëm të sakrifikojë. Megjithatë, fakti që kombi kinez është i vendosur të mësojë teknologjinë, nuk ndikon në funksionimin e vetë sistemit.

Ndërsa po flisja për Kinën, kam devijuar paksa nga tema kryesore. Isha duke ju treguar që britanikët shpikën dhe futën teknika të reja industriale, dhe i përhapën nëpërmjet një sistemi të duhur arsimor. Nëse Japonia mund t'u mësojë zanate të ndryshme punonjësve të saj pa pasur pasuri natyrore apo burime të tjera, nëse Kina i konsideron qytetarët e saj si skllevër të dijes dhe pret nga çdo fëmijë që të mësojë lëndët shkencore ose të ketë një zanaat, dhe t'i trashëgojë këto dije edhe tek të tjerët, dhe nëse të gjitha këto kombe janë përpjekur të zhdukin varfërinë nëpërmjet këtyre metodave, atëherë a nuk është ky një mësim për ne?!

A mendoni se varfëria është ajo që pengon zhvillimin arsimor? Ja, një shembull!

Dikush mund të thotë që varfëria në vetvete është një kërcënim, sepse nëse një njeri është i uritur, nuk ka kohë ose prirje për të mësuar. Në këtë kontekst nuk mund t'ju ndihmoj, por mund ta lidh me një ngjarje të ndodhur në Gjermani diku para 40 vitesh. Në vitin 1947, kur vazhdoja studimet në Universitetin të Kembrixhit, Gjermania kishte humbur luftën dhe i gjithë populli gjerman po vuante pasojat e dhimbshme të kësaj humbjeje.

Komisioni Amerikan i Kontrollit ftoi studentët nga Universiteti i Kembrixhit

dhe nga universitete tjera europiane që të vizitonin Gjermaninë dhe të shihnin gjendjen e vështirë me të cilën po përballej populli gjerman. Rreth 500 studentë nga e gjithë Europa shkuan në Mynih. As edhe një ndërtesë në qytet nuk kishte ngelur pa u dëmtuar, dukej sikur banorët e Mynihut po jetonin në fole pëllumbash.

Ne qëndruam në disa tenda të mëdha në një park të qytetit. Unë mora vesh nga dikush që një studiues gjerman po më kërkonte. Një ditë e takova këtë studiues, të cilit i kishte ngelur vetëm skeleti i trupit. Ai ishte i punësuar në një kamp luftime në Gjermani, ku kishte pasur edhe disa të burgosur nga Penxhabi (i Indisë). Nga këta ushtarë kishte mësuar që unë ndodhesha në qytet. Me ndihmën e ushtarëve kishte filluar të mësonte gjuhën penxhabe, dhe po hartonte një fjalor Gjermanisht-Penxhabisht në vitin 1947. Kishte gjetur dy libra në gjuhën penxhabe: *Meer Warith Shah* dhe një kopje të vjetër të librit *Dulla Bhatti* të botuar në Lahor. Ngaqë po haste vështirësi në kuptimin e disa vargjeve në libra, vendosi të më takonte mua, që atij t'i shpjegoja disa pasazhe të ndryshme. Për fat të keq ato pasazhe ishin të vështira edhe për mua, prandaj nuk munda që ta ndihmoja shumë. Tani mendoni për një moment për këtë histori. Nuk e di nëse ai fjalor është botuar ndonjëherë, dhe nëse po, atëherë sa njerëz e kanë

përdorur. Por, kjo ngjarje tregon se sa të marrosur janë këta njerëz pas dijes. Këta përbëjnë një komb ku Prodhimi Kombëtar Bruto është dija për shkencën, teknologjinë dhe gjuhët. Njerëzit e këtij vendi të madh e dinë që hartimi i një fjalori Gjermanisht-Penxhabisht do të sjellë fryte, si dhe e dinë që kurrë nuk duhet humbur koha duke luajtur me letra, duke hyrë në grevë apo duke parë filma pa kuptim.

Zoti i ndihmon ata që përpiqen

Në këtë kontekst unë dua ta lidh me një histori të treguar nga lideri i madh kinez, Mao Ce Duni (Mao Zedong), të cilën padyshim që mund ta dëgjoni nga thuajse çdo person në Kinë.

Kohë më parë, një burrë i vjetër jetonte në veri të Kinës dhe quhej Z. Analfabeti. Shtëpia e plakut ishte me pamje nga jugu dhe aty ishin dy male të larta, Bang dhe Wang, fiks përballë shtëpisë së tij. Një ditë ai iu kërkoi fëmijëve të gërmonin në male për t'i larguar tutje. Komshiu i tij, i quajtur Z. Inteligjent, i tha që e kishte kuptuar kohë më parë se ishte budalla, por jo aq sa të mendonte se mund t'i largonte malet vetëm duke gërmuar me duar. Plaku i vjetër u përgjigj: “Shoku im i dashur, ti ke të drejtë, por mos harro që nëse unë vdes, atëherë për këtë punë do të kujdesen fëmijët e mi, dhe kur ata të vdesin, do ta bëjnë fëmijët e tyre, dhe kur ata të vdesin, do të punojnë



Dr. Abdus Salam duke pranuar çmimin Nobel për fizikë nga mbreti Carl Gustav XVI i Suedisë, 10 dhjetor 1979.

fëmijët e tyre, dhe kështu ky gërmim do të vazhdojë përgjithmonë. Këto male nuk rriten më. Çdo ditë që ne gërmojmë, po i zvogëlojmë, dhe shpresojmë që një ditë ta zhdukim këtë pengesë përpara shtëpisë”. Duke dëgjuar këto fjalë të plakut, Zoti i Plotfuqishëm dërgoi dy engjëj, që i lëvizën malet sa hap e mbyll sytë!

Shoqëria jonë përballet me pengesa të tilla si këto dy male. Përpiquni t'i mbani larg jush me durim. Zoti do të tregojë mëshirë për ju një ditë. Mos u mërzitni nëse përpjekjet tuaja nuk sjellin fryte, vazhdoni dhe bëni punën, dhe Zoti do t'ju bekojë me të vërtetë për përpjekjet tuaja!

Mbështetja te Zoti i Lartësuar

fragment nga libri "Jeta e Muhammedit" S.a.V.S.

Në ç'masë Profeti Muhammed S.a.V.S. mbështetjet te Zoti i Lartësuar, këtë mund ta përfytyroni nga ngjarja kur një njeri e gjeti të vetëm, ngrehu shpatën para tij duke kërcënuar: "Kush mund të të shpëtojë prej meje?", dhe Profeti S.a.V.S., edhe pse ishte pa armë, madje i shtrirë, pa mundur të bëjë asnjë manovrim, mjaft i qetë dhe i bindur i qe përgjigjur: "Allahu". Kjo fjalë kishte dalë nga goja e tij me një bindje dhe qëndrueshmëri të tillë, sa që sulmuesi nuk mbeti pa u ndikuar nga ajo, aq sa i ra befas shpata nga dora. Vetëm në pak çaste, ai që kishte ardhur për ta vrarë Profetin S.a.V.S., po qëndronte para tij si një fajtor.¹

Me gjithë këtë mbështetje të pakufishme te Zoti, para Zotit, ai gjendej tejet i përlur. Një herë, disa njerëz i kishin thënë: "O i Dërguari i Allahut! Ju me

siguri do ta arrini bekimin² e Allahut nëpërmjet veprave tuaja madhore". Profeti S.a.V.S. u ishte përgjigjur:

"Jo aspak. Edhe unë do të falem vetëm nëpërmjet mirësisë së Zotit".

Ebu Hurejre r.a. rrëfen: "Unë e kam dëgjuar të Dërguarin e Allahut një ditë, duke thënë se askush nuk do të hyjë në xhenet për shkak të veprave të tij. E pyeta: "O i Dërguari i Allahut! As ju nuk mund të hyjni në xhenet prej veprave tuaja?" Më tha: "As unë nuk mund të hyj në xhenet përmes veprave të mia. Po, nëse do të më mbulojnë bekimi dhe mëshira e Zotit, atëherë mund të hyj".³

Një herë Profeti Muhammed S.a.V.S. tha: "Bëni vepra të mira, kërkoni rrugët e afrimit me Zotin e Lartësuar dhe askush nga ju të mos dëshirojë vdekjen e vet, sepse, nëse ai është njeri i mirë, atëherë jeta vetëm do t'i



shtojë mirësi të tjera, e nëse është i lig, do të gjejë në jetë mundësinë për t'u penduar nga mëkatet e tij".⁴

I Dërguari i Allahut ^{s.a.v.s.} e donte kaq shumë Allahun e Lartësuar sa që kur binte shi pas një kohe të gjatë, ai priste pikat e shiut me gjuhë dhe thoshte: "Ja, bekimi i freskët i Zotit tim!"⁵

Kur rrinte në mbledhje, vazhdimisht i kërkonte falje Zotit, praktikë të cilën, në fakt, e bënte në përgjithësi në çdo kohë, në mënyrë që *umeti* i tij dhe njerëzit që kishin lidhje me të, të mund të shpëtonin nga zemërimi i Allahut të Lartësuar dhe të gëzonin mëshirën e Tij.⁶

Gjithmonë e mbante parasysh daljen e tij përpara Zotit të Lartësuar. Kështu, kur flinte, lutej: "O Zot! Vdes me emrin Tënd dhe ringjallem me emrin Tënd". Ndërsa, kur zgjohej nga gjumi, lutej: "Të gjitha lavdërimet i takojnë vetëm Allahut, i Cili na ringjalli pas vdekjes sonë dhe ne, tek Ai do të kthehemi".⁷

Aq shumë e donte afrimin me Zotin e Lartësuar, sa që shpesh lutej: "O Zoti im! Bëj në zemrën time dritë⁸, në shikimin tim dritë, në dëgjimin tim dritë, në të djathtën time dritë, në të majtën time dritë, mbi mua dritë, poshtë meje dritë, para meje dritë, pas meje dritë dhe o Zoti im, tërë qenien time bëje dritë!"⁹

Ibni Abasi ^{r.a.} tregon që afër vdekjes së të

Dërguarit të Allahut ^{s.a.v.s.}, një ditë, erdhi Musejleme Kedhabi (gënjeshтари) dhe kërkoj që nëse Profeti Muhammed ^{s.a.v.s.}, do ta caktonte atë si udhëheqës pas tij, ai do ta pranonte Profetin. Atëherë ai kishte një mori njerëzish me vete dhe fisi, që i përkiste ai, ishte më i madhi në numër në të gjithë Arabinë. Kur i Dërguari i Allahut ^{s.a.v.s.} mori lajmin e ardhjes së tij në Medinë, shkoi për ta takuar, ndërkohë, atë e shoqëronte Thabit ibni Kajs ibni Shumasi ^{r.a.}. Profeti ^{s.a.v.s.} kishte një degë hurme në dorë. Ai u afrua te grupi i tij dhe qëndroi përballë Musejlemes. Ndërkohë, erdhën edhe sahabë të tjerë dhe qëndruan rreth Profetit ^{s.a.v.s.}.

I Dërguari i Allahut ^{s.a.v.s.} iu drejtua duke thënë: "Ti thua që nëse unë, i Dërguari i Zotit do të të caktoj ty si kalif pas meje, atëherë do të jesh gati të më ndjekësh mua. Por, unë nuk jam gati të të jap as këtë degë hurme kundër urdhrit të Zotit. Ju do të pësoni atë që ju ka përcaktuar Zoti. Nëse ktheheni shpinazi, Zoti do t'jua presë këmbët, madje unë shoh që gjithçka që më ka treguar Zoti, ajo ka për të ndodhur me ju". Pastaj i Dërguari i Allahut ^{s.a.v.s.} tha: "Unë po largohem, gjërat e tjera që ke për të biseduar, bisedoji me përfaqësuesin tim Thabit ibni Kajs ibni Shumasin". Më pas i Dërguari i Allahut ^{s.a.v.s.} mori rrugën për t'u kthyer. Atë e shoqëroi edhe Ebu Hurejre ^{r.a.}.

Rrugës, dikush e pyeti: "O i Dërguari i

Allahut! Çfarë kuptimi ka kjo që keni thënë: “shoh që gjithçka që më ka treguar Zoti, ajo ka për të ndodhur me ju?”.” Ai u përgjigj: “Kisha parë në ëndërr që kam dy byzlykë në duar, të cilët nuk i pëlqeva. Po në ëndërr mora shpalljen që t’i fryja. Kur i fryva, ata u zhdukën. Këtë e interpretova se pas meje do të dalin dy gënjeshtarë që do të pretendojnë të jenë profetë”.¹⁰

Kjo ishte periudha e fundit e jetës së Profetit Muhammed ^{s.a.v.s.}. Fisi më i madh dhe i fundit ishte gati t’i nënshtrohej atij, por vetëm me kushtin që Profeti ^{s.a.v.s.}, prijësin e tij ta caktonte kalif pas tij. I Dërguari i Allahut ^{s.a.v.s.}, po të kishte qoftë një dëshirë të vogël në zemër për të fituar ndonjë epërsi personale, atëherë, për sa kohë ai nuk kishte ndonjë pasardhës mashkull, kjo ishte një mundësi optimale për të. Prijësit më të madh të fisit më të madh të Arabisë, edhe mund t’i ngjallte shpresa, duke hapur në këtë mënyrë rrugën e bashkimit të të gjithë Arabisë. Por i Dërguari i Allahut ^{s.a.v.s.} si mund ta quante të tijën gjithë udhëheqjen islame, kur edhe gjënë më të vogël nuk e konsideronte si të tillë! Tek ai, udhëheqja e Islamit ishte një amanet i Zotit, të cilin, ashtu siç ishte, duhej t’ia dorëzonte Zotit, që më vonë, Ai t’ia jepte kujt të donte. Prandaj, propozimin e ardhur nga Musejleme, i Dërguari i Allahut ^{s.a.v.s.}

e refuzoi me poshtërim duke i kthyer: “Lëre udhëheqjen e Islamit, unë nuk mund të të jap ty as këtë degë hurme pa lejen e Zotit”.

Sa herë që ai përmendte Allahun e Lartësuar, emocionohet, mbushej me zell dhe dukej sikur dashuria ndaj Allahut e kishte pushtuar në mish e në shpirt. Aq shumë e pëlqente thjeshtësinë në adhurimin e Allahut të Lartësuar, sa që falej në xhaminë që nuk kishte as dysHEME e as ndonjë qilim dhe, edhe të tjerët i porosiste të faleshin në të. Shpeshherë ndodhte që çatia pikonte nga shiu dhe trupi e rrobat e të Dërguarit të Allahut ^{s.a.v.s.} bëheshin me ujë e me baltë, por ai vazhdonte të falej me përkushtim dhe në asnjë moment nuk i donte zemra që ta spostonte faljen e asaj kohe, apo ta falte në ndonjë vend tjetër.¹¹

I Dërguari i Allahut ^{s.a.v.s.} kujdesej edhe për faljet e sahabëve të tij. Një herë, rreth Abdullah ibni Omerit ^{r.a.}, i cili ishte një njeri shumë i dëlirë dhe i pastër, ai kishte thënë:

“Sa bukur do të ishte, nëse Abdullah ibni Omeri do të falte edhe namazin e tehexhudit”.¹²

Abdullah ibni Omeri ^{r.a.}, që nga dita kur i mori vesh fjalët e të Dërguarit të Allahut ^{s.a.v.s.}, filloi ta falte rregullisht namazin e

tehexhudit. Po ashtu, përmendet që një herë në mbrëmje, Profeti ^{s.a.v.s.} kishte shkuar për vizitë te shtëpia e Fatimes dhe Aliut, së bijës dhe dhëndrit të tij dhe i pyeti: “A falni tehexhudin?” (domethënë, namazi që falet pas mesnatës, pasi zgjohemi nga gjumi). Aliu ^{r.a.} tha: “O i Dërguari i Allahut! Përpiqemi ta falim, por nganjëherë për ndonjë arsye, kur Zoti i Lartësuar nuk na zgjon, edhe nuk e falim”. Profeti ^{s.a.v.s.} i porositi: “Falni rregullisht tehexhudin”, e pastaj u çua për t’u kthyer në shtëpi dhe ndërkohë, vazhdimisht përsëriste¹³ :

وَكَانَ الْإِنْسَانُ أَكْثَرَ شَيْءٍ جَدَلًا

[Njeriu kundërshton më shumë se çdo krijesë tjetër.]¹⁴

Ky është një ajet i Kuranit Famëlartë, në të cilin thuhet: Njeriu shpesh heziton të pranojë fajin e vet dhe duke u treguar hileqar përpiqet ta mbulojë gabimin e tij. Pra, Aliu ^{r.a.} dhe Fatimja ^{r.a.}, në vend të thoshin se ata gabonin ndonjëherë, ia linin fajin Zotit duke thënë se është Zoti Ai që kur do, i zgjon dhe nuk kur nuk do, nuk i zgjon.

I Dërguari i Allahut ^{s.a.v.s.} kishte dashuri aq të madhe ndaj Zotit të Lartësuar, megjithatë, urrente adhurimin që bëhej për reklamë. Parimi i tij ishte që adhurimi i vërtetë rrjedh pikërisht nga përdorimi i

duhur i aftësive që njeriu ka marrë prej Zotit të Lartësuar. Nëse ka sy, atëherë mospërdorimi i tyre është jorespekt ndaj Zotit, ndërsa keqpërdorimi është mëkat. Po ashtu, vetëshurdhimi është mungesë respektimi ndaj Zotit, ndërsa dëgjimi i përgojimeve është mëkat. Heqja dorë nga ushqimi, jo vetëm që është vetëvrasje, por edhe fyerje ndaj Zotit, por ushqimi i tepërt dhe konsumimi i gjërave të palejuara e të papëlqyera bëhen mëkat.

Kjo ishte ajo që i paraqiti botës Profeti Muhammed ^{s.a.v.s.}, gjë që nuk ishte treguar më parë nga ndonjë profet tjetër. Virtytet e larta, në të vërtetë, përbëhen nga përdorimi i saktë i instinkteve. Ndrydhja deri në fund e instinktive është budallallëk, shfrenimi i tyre është ligësi, kurse përdorimi i tyre i duhur është mirësi e vërtetë. Kjo është përmbledhja e mësimet të Profetit Muhammed ^{s.a.v.s.}, njëherësh, edhe përmbledhja e jetës dhe veprave të tij. Aishja ^{r.a.}, rreth tij thotë:

“Asnjëherë nuk ndodhi në jetën e të Dërguarit të Allahut ^{s.a.v.s.}, që kur gjendej në ndonjë udhëkryq, ai të mos ketë zgjedhur rrugën më të lehtë, por me kusht që të ishte plotësisht i bindur që ndjekja e asaj rruge të lehtë të mos e çonte në ndonjë mëkat.

...E nëse kishte qoftë një grimë dyshimi

vijon në f. 70

Pikëpamja e Islamit mbi jetën pas vdekjes

Malik Jamil R. Rafiq

Vdekja zakonisht konsiderohet si një koncept disi i frikshëm; por një numër të konsiderueshëm njerëzish që e përqafojnë vdekjen aq trimërisht dhe fisnikërisht saqë të lënë me gojë hapur. Ky shkrim synon të analizojë jetën pas vdekjes nga këndvështrimi i Islamit. Shkrimi nisat me përshkrimin e llojeve të vdekjes sipas tanatologjisë (studimi që meret me aspektet mjekësore, psikologjike dhe sociologjike të vdekjes si dhe mënyrat se si njerëzit përballen me të) dhe më pas studion vdekjen në lëmin e feve të ndryshme për të nxjerrë një përfundim me metodat krahasuese. Në vijimësi, shkrimi zbërthen këndvështrimin e Islamit mbi gjendjen e pasvdekjes, mbi gjendjen e shpirtit, parajsën dhe ferrin si dhe mbi mundësinë e komunikimit me të vdekurit sipas asaj që na tregon Islami. Ky artikull gjithashtu jep një paraqitje të shkurtër mbi disa nga ritualet dhe praktikatat islame që kanë të bëjnë me trupat e pajetë, ceremoninë e funeralit dhe varrimin.

Llojet e vdekjes sipas tanatologjisë

Sipas tanatologjisë, vdekja mund të ndahet në disa kategori, të cilat janë:

Vdekja klinike ose somatike: Zhdukje e personalitetit në tërësi, si pasojë e humbjes së pakthyeshme të funksionimit

dhe pavarësisë së tri sistemeve jetësore; siç janë sistemi i frymëmarrjes, SNQ (Sistemi Nervor Qendror) dhe SKV (Sistemi Kardiovaskular). Ajo i përfshin organet në tërësi. Të gjitha gjurmët e jetës ndërpriten në trup, por vijon të mbetet në komponentët e tjerë siç janë indet dhe qelizat.¹

Vdekja molekulare: Shpërbërja progresive e indeve të trupit, gjë e cila nënkupton vdekjen e komponentëve të trupit/ organeve. Kjo ndodh afërsisht brenda tri ose katër orëve pas vdekjes somatike. Kjo kohë përpjesëtohet me aftësinë e trupit për t'i rezistuar hipoksisë (mungesës së oksigjenit), p.sh.:

Indet nervore – vetëm pak sekonda

Indet muskulare – 3 orë

Kornea – 6 orë

Lëkura – 12 orë²

Vdekja e trurit: Ndërprerja e të gjitha funksioneve të trurit. Në disa përjasje, referenca të veçanta i kushtohen vdekjes së aktivitetit të trurit apo të sistemit nervor. Kjo ndodh kur personi nuk ka më asnjë lloj aktiviteti në trurin e tij si dhe ka humbur përgjithmonë aftësinë për të qenë i vetëdijshëm dhe mundësinë për të marrë frymë, por mund të ketë disa funksione në shtyllën kurrizore.³

Encyclopædia Britannica (Enciklopedia Britanike) nën zërin “vdekja” e ka

përkufizuar vdekjen si ‘ndërprerjen e përhershme të funksioneve jetësore në trupat e bimëve dhe kafshëve’.⁴

Sipas ‘Encyclopaedia of Religion and Ethics’ (Enciklopedia e Fesë dhe Etikës), vdekja biologjike është “Ndërprerja e një organizmi’. Nuk ka asnjë lloj ngatërrese në përdorimin e të njëjtës fjalë për të përshkruar fundin e një individi si dhe të një procesi të pakthyer që të çon drejt fundit”.⁵

Një vështrim mbi vdekjen si koncept sipas feve të ndryshme

Judaizmi

Le të shohim se si perceptohet vdekja në fe të ndryshme. Për sa i përket jetës pas vdekjes, Dhjata e Vjetër nuk është shumë e pasur me detaje. Ajo thotë:

“Shumë prej atyre që flenë nën pluhurin e Tokës do të zgjohen, disa në jetën e pambarim, dhe disa të tjerë në turp dhe përbuzje që zgjat përgjithmonë.”⁶

Ndërsa në librin e Ezekielit 37:4-6 kemi:

“O ju kocka të thara, duroni fjalën e Zotit. Këto ishin fjalët e Zotit për ato kocka; Kujdes, Unë do të bëj që fryma të hyjë në ty dhe ti do të jetosh: dhe unë do të shtroj nerva mbi ty, dhe do të të mbuloj me mish dhe me lekure, dhe kur fryma ime të hyjë në ty, ti do të jetosh,

dhe do ta dish që unë jam Zoti yt”.⁷

Rreth ferrit, “The Jewish Encyclopaedia” (Enciklopedia Hebraike) duke iu referuar librit Erobian të Talmudit thotë: “Zjarri i Gehenës (ferrit) nuk i prek mëkatarët hebre sepse ata do t’i rrëfejnë mëkatet e tyre përpara portës së ferrit dhe do të rikthehen tek Zoti i tyre”.

Duke iu referuar librit Berakhot të Talmudit thuhet: “Heretikët dhe shtypësit romakë do të përfundojnë në Gehenë, dhe i njëjti fat i pret edhe Persianët, shtypësit e hebrenjve të Babilonisë”.⁸

Ndërsa për hebrenjtë bashkëkohorë, Sale shpreh:

“Është një opinion gjerësisht i pranuar nga hebrenjtë e sotëm që asnjë person (nga hebrenjtë), qoftë nga të pabesët apo nga cilido sekt tjetër, nuk do të qëndrojë në ferr më shumë se njëmbëdhjetë muaj apo maksimum një vit, përveç Datanit, Abiamit dhe ateistëve (nga hebrenjtë), të cilët do të torturohen aty përgjithmonë”.⁹

“Abiami dhe Datani u ngritën kundër Moisiut dhe u shkatërruan nga Zoti”.¹⁰

Në ‘Derech Eretz Zut-a’, njëri ndër pesëmbëdhjetë traktatet e Talmudit, edhe pse e përpiluar më vonë se të tjerat por që përfshihet në botim, gjenden

figura biblike si Enok, Elijah dhe Hiram, të cilët së bashku i shpëtuan vdekjes dhe u dërguan direkt në Parajsë.¹¹

Krishterimi

Sipas konceptit të krishterimit “Mëkati hyri në botë nëpërmjet një njeriu, dhe vdekja nëpërmjet mëkatis, dhe kështu vdekja kaloi mbi çdo njeri, prandaj të gjithë janë mëkatarë”.¹²

Në librin urdu, ‘*Kamusul Kitab*’ ne lexojmë :

“Duhet ta pranojmë se vdekja erdhi si pasojë e mëkatis të Adamit, dhe ndëshkimi për të rezultoi në vdekje në dy forma, në atë fizike dhe në atë shpirtërore”. Gjithashtu shkruhet: “Vdekja fizike është shenja më e denjë e vdekjes shpirtërore e cila është pasoja e domosdoshme e mëkatis”.¹³

Budizmi

Lidhur me vdekjen Buda ka thënë: “O murg! Jeta e njeriut është e shkurtër”. “Jeta me të vërtetë përfundon në vdekje”. Vdekja është thjesht fillimi i një ekzistence të re për ndëshkimin e mëkateve: vdekja dhe ndëshkimi janë sinonime.¹⁴

Lidhur me konceptin e rimishërimit (reinkarnim) lexojmë:

“Në teori budizmi nuk mëson ekzistencën

e shpirtit dhe as rimishërimin e tij, por insiston në revolucionin apo në “rrymën” e ekzistencës. Megjithatë, për nga influenca e saj konkrete në mendësinë popullore, kjo doktrinë arriti të ketë të njëjtën peshë si çdo doktrinë tjetër e rimishërimit. (...) Në këtë oqean të gjerë rilindjesh, ekzistojnë një numër i pallogaritshëm rrymash të ekzistencës, të kushtëzuara nga veprat dhe pasojat e tyre përkatëse, që rrjedhin lirisht jo vetëm në vazhdimësinë e qenies individuale, por edhe në solidaritetin e ekzistencës kolektive”.¹⁵

Hinduizmi

Në hinduizëm, një trup i vdekur konsiderohet simbol i papastërtisë, e për këtë arsye kontakti fizik me të është minimal. Trupi lahet me ujë të pastër dhe më pas vishet me rroba të reja. Po kështu, disa pika uji nga Ganga e shenjtë mund të derdhen në buzë të të vdekurit, me qëllim që shpirti të fitojë lirinë. Gjithashtu disa gjethe borziloku, që konsiderohet i shenjtë, i vendosen në të djathtë trupit të vdekur. Pas kësaj, të afërmit e të vdekurit e mbajnë shtratin me trupin e pajetë sipër, dhe e shpilenë në vendin e caktuar për ta djegur.

Në hinduizëm, nuk gjendet koncepti i një parajse apo i një ferri të përhershëm. Shpirti hyn në një cikël rilindjesh, nga ku mund të rilindet si kafshë, njeri ose hyjni. Ky rimishërim vazhdon derisa

arrihet çlirimi përfundimtar.¹⁶

Zoroastrianizmi

Në fenë zoroastriane, kur një njeri gjendet në shtratin e vdekjes, dy priftërinj e bëjnë atë të rrëfejë mëkatet e tij. Trupi i vdekur më pas lahet dhe vishet me rroba të pastra pambuku, të bardha por të grisura, të cilat më vonë duhet të shkatërrohen e të mos përdoren më kurrë, pasi i kanë shërbyer qëllimit të tyre.

Ritin e funeralit drejt ‘tempullit të heshtjes’ apo vendi ku lihet trupi për t’u dekompozuar, e udhëheq një njeri me kupë që mban zjarr. Atë e ndjekin të afërmit dhe miqtë e të ndjerit, trupi i pajetë, priftërinjtë si dhe anëtarë të tjerë të farefisit.

Në portat e tempullit arkivoli ulet poshtë dhe fytyra i zbulohet në mënyrë që të pranishmit t’i japin lamtumirën e fundit. Më pas trupi çohet në tempull dhe vendoset në një shtrat prej guri me krye drejt Jugut. Trupit i hiqen rrobat, duke e lënë plotësisht lakuriq. Më pas të pranishmit largohen duke ua lënë trupin hutave të uritura, që janë në pritje për ta gllabëruar atë. Brenda më pak se dy orëve trupi shndërrohet në një skelet të thjeshtë.¹⁷

Koncepti i vdekjes në Islam

Sipas Islamit, të gjitha krijesat janë

destinuar për të vdekur. Vdekje do të thotë ndarje e përhershme e shpirtit nga trupi. Kurani Famëlartë thotë:

“Allahu ua merr shpirtat në kohën e vdekjes së tyre, dhe ato që nuk vdesin, (i merr) në gjumin e tyre. Më pas i mban ato për të cilat vendos vdekjen, dhe të tjerat i dërgon (sërisht). Pa dyshim, në këtë ka shenja për njerëzit që meditojnë”.¹⁸

Kjo tregon se shpirti ka ekzistencën e vet. Një person i gjallë ka trupin edhe shpirtin. Në kohën e vdekjes, shpirti largohet nga trupi për të mos u kthyer më kurrë. Pas vdekjes trupi nuk mund të përdoret më, prandaj varroset.

Më vonë do të diskutojmë se ç’ndodh me shpirtin pas vdekjes, por në fillim le të kuptojmë se prej nga ai hyn në trup. Duhet të qartësohet se çdo gjë, përfshirë dhe shpirtin, është krijuar prej Zotit. ‘Është një esencë e distiluar nga trupi përgjatë periudhës së ngjizjes’.¹⁹

Zoti në Kuranin Famëlartë thotë:

“A menduat se Ne ju krijuam pa qëllim dhe ju nuk do të ktheheshit te Ne?! Shumë i Lartë është Allahu, Sunduesi i Vërtetë. Nuk ka të adhurueshëm tjetër përveç Atij; Zoti i Fronit të Nderuar”.²⁰

Kjo nuk lë hapësirë për asnjëlloj dyshimi, se njeriu është krijuar për një qëllim. Ai nuk zhduket thjesht pasi ka jetuar për disa vjet në këtë tokë. Prandaj, dalim në

përfundim se shpirti duhet të ekzistojë edhe pas vdekjes, me qëllim që të arrihet qëllimi më i lartë.

Shpirti pas vdekjes – *Berzah* – Gjendja e ndërmjetme

Çfarë ndodh me shpirtin pas vdekjes? Kurani Famëlartë na përgjigjet kështu:

“Mjerë për njeriun! Sa mosmirënjohës që është ai! Prej çfarë gjëje e ka krijuar Ai (Allahu)? Prej pikës së farës e ka krijuar dhe i ka dhënë përmasa të rregullta. Më pas ia lehtësoi rrugën; më pas dhe i shkaktoi vdekjen dhe e varrosi, dhe, kur të dojë, Ai e ringjall”.²¹

Kjo tregon se Allahu secilitdo që ndahet nga jeta, i cakton një varr. Këtu nuk bëhet fjalë për varrin e gërmuar nga njërrëzit, pasi jo çdo kufomë groposet; disa prej tyre digjen, disa të tjerë gllabërohen nga hutat e disa mbyten. Në Kuranin Famëlartë vendi ku qëndron shpirti pas vdekjes quhet ‘*Berzah*’ (ndarëse, kohë e ndërmjetme):

“Vetëm kur dikujt prej tyre i vjen vdekja, thotë: “O Zoti im! Më kthe, ndoshta mund të bëj të mira në atë (botë) që e lashë.” Kurrresi! Kjo që thotë ai është vetëm fjalë goje. Dhe mbrapa tyre ka pengesë deri në ditën kur do të ringjallen ata”.²²

Menjëherë pas largimit nga kjo botë fizike, shpirti pajiset më një trup të ri.

Ky trup është një pasqyrim i veprave të njeriut, të mira apo të këqija, gjatë jetës së tij tokësore. Kurani Famëlartë thotë: “Ditën kur disa fytyra do të zbardhen e disa do të nxihen”.²³ Natyrisht që keqbërësit do të kenë trupa të nxirë, ndërsa mirëbërësit trupa të ndritshëm.

Themeluesi i Xhematit Musliman Ahmedia, Hazret Mirza Ghulam Ahmedi ^{a.s.}, në këtë kontekst ka thënë:

“Unë personalisht kam përvojë në këtë drejtim. Kam takuar shpesh herë njerëz të vdekur në keshf, duke qenë krejtësisht zgjuar. Trupin e disa njerëzve të devijuar e të ligj e kam parë kaq të nxirë, sikur të ishte prej tymi. Kështu që, kam përvojë personale në këtë fushë dhe e them me të madhe që mu ashtu siç thotë Zoti i Madhërishëm, pas vdekjes çdokujt i jepet një trup, qoftë prej drite, qoftë prej errësire.”.²⁴

Gjendja ‘*Berzah*’ ose gjendja e ‘varrit’ është një gjendje e ndërmjetme, që pasqyron ose mirësitë e pashtershme të xhenetit ose dënimet e xhehenemit, në varësi të asaj që pret shpirti. Kurani Famëlartë na mëson:

“Ditën kur disa fytyra do të zbardhen e disa fytyra do të nxihen, atyre që do t’u nxihen fytyrat (do t’u thuhet): “A mohuat, pasi e patët pranuar besimin? Shijojeni ndëshkimin për atë që mohoni!” Kurse atyre që do t’u zbardhen fytyrat, ata do

të jenë në mëshirën e Allahut. Në të do të qëndrojnë përgjithmonë”.²⁵

Pra, bëhet e qartë se çdo person fillon të përjetojë shpërblimin apo ndëshkimin e tij menjëherë pas vdekjes:

“(Këta janë ata,) të cilëve engjëjt ua marrin shpirtin kur ata janë duke i bërë keq vetvetes, dhe përpiqen t’u thonë fjalën e kompromisit: “Ne nuk bënim ndonjë të keqe!” Si jo?! Allahu është i Gjithëdijsëm për atë që bënitet. Hyni në portat e xhehenemit, në të cilin do të mbeteni gjatë. Është shumë e keqe streha e kryeneçëve!”²⁶

“(Këta janë ata,) të cilëve engjëjt ua marrin shpirtin kur ata janë të pastër (dhe engjëjt u) thonë: Paqe qoftë mbi ju! Hyni në xhenet për shkak të asaj që bënitet!”²⁷

Profeti i Shenjtë ^{s.a.v.s.} gjithashtu ka porositur:

“Me të vërtetë varri është një nga kopshtet e xhenetit ose një nga gropat e zjarrit”.²⁸

Pas fazës së varrit ose gjendjes së *berzahut*, radhën e ka faza e ringjalljes së trupit. Kjo mund të përngjasojë me lindjen e një fëmije, ndërkohë që faza e parë e *berzahut* i ngjan asaj të ngjizjes. Tanimë shpirti i pajisur me një trup të ri, është në gjendje të përthithë njohjen e plotë rreth Krijuesit të tij, dhe tashmë

ndien plotësisht shpërblimet e tij, ndërkohë që në gjendjen e *berzahut*, ai i kishte përjetuar ato thjesht pjesërisht.

Në të dyja fazat; *berzah* dhe ringjallje, njeriut i shfaqen të gjitha gjendjet shpirtërore të kësaj jete, në formë fizike. Në Kuranin Famëlartë thuhet:

“Ai, që në këtë botë ka qenë i verbër, do të mbetet i verbër edhe në botën tjetër dhe më i humbur nga rruga e drejtë”.²⁹

Kjo tregon se ata të cilët janë të verbër shpirtërisht në këtë botë, do të jenë të verbër fizikisht në botën tjetër. Duke vepruar si i verbër, duke mos i parë fare të vërtetat hyjnore, njeriu i tillë do të jetë i verbër fizikisht dhe në botën tjetër. Arsyeja për këtë është se në botën tjetër trupi do të evoluojë si pasqyrim i veprimeve të tij në këtë botë. Derisa shpirti në jetën tokësore përjeton vuajtjet apo rehatinë e trupit, në jetën e përtëjme ndëshkimet apo shpërblimet që pëson njeriu do të përjetohej si fizikisht ashtu edhe shpirtërisht.

Nga kjo bëhet e qartë se ndëshkimi nuk është gjë tjetër veçse pasojë e drejtpërdrejtë e veprave të këqija të njeriut. Kurani Famëlartë shprehet qartë në lidhje me të:

“Vetja jote është e mjaftueshme sot që të të kërkojë llogari”.³⁰

Qëllimi i xhehenemit

Në fakt, xhehenemi fare mirë mund të krahasohet me një 'spital' në të cilin njerëzit e sëmurë hyjnë për t'u kuruar. Prandaj, çfarëdo dhimbje apo vuajtje ndihet gjatë procesit të shërimit është e natyrshme. Nga ana tjetër, një person i shëndetshëm - banor i xhenetit - i cili hyn në spital (xhehenem) për të vizituar një mik, do të vazhdojë të qëndrojë i shëndetshëm. Kurani Famëllartë shpjegon në lidhje me këtë:

"Një folës prej tyre do të thotë: Unë kisha një shok. (Më) thoshte: 'Edhe ti je nga ata që vërtetojnë? Kur do të vdesim dhe do të bëhemi pluhur dhe eshtra, a do të na kërkohet të japim llogari?' Ai do të thotë: 'A mund t'i hidhni sy për t'u njoftuar (për të)?' Atëherë ai e pa atë dhe e gjeti në mes të xhehenemit".³¹

Kështu, ky zjarr me të cilin po shërohet personi i sëmurë, nuk do t'i sjellë asnjë dëm vizitorit, i cili hyn në xhehenem për të takuar mikun e tij.

Duhet ngulitur në mendje se të gjitha "ndëshkimet" e përmendura në shkrimet e shenja janë thjesht mënyra të ndryshme të shërimit. Për shembull, banuesve të xhehenemit do t'u jepet kaktus për të ngrënë.³² Ne e dimë se kaktusi është një ilaç efektiv që përdoret për të shëruar sëmundje të ndryshme, përfshirë këtu sifilizin.³³

Gjithashtu kemi shembuj të tjerë si: "Aty nuk do të shijojnë as freski, as pije,

përpos ujit të valuar dhe qelbësirave erëkeqe, si dënim i merituar (të veprave të tyre)".³⁴

Fjala Arabisht që përdoret për qelbësirat është غَسَّاق *Ghassak* (Lisanul Arab). Është një fakt i ditur se disa vaksina prodhohen nga qelbet. Meqë këta persona nuk i përfillnin aspak të dërguarit e Zotit duke treguar një sjellje të ftohtë, prandaj si "shpërblim" për qëndrimin e tyre, si dhe si shërim, atyre do t'u jepet ujë i akullt. Po kështu, për shkak të gjaknxehtësisë së tyre, ata nuk i dëgjonin fjalët e Zotit, prandaj do të mjekohen me ujë të përvëluar. Meqenëse ata ndiznin kundërshtime ndaj profetëve, edhe shërimi i tyre do të jetë me anë të 'zjarrit' në xhehenem. Ne gjithashtu dimë se metoda e të djegurit përdoret për t'i shëruar plagët.

Tashmë është e qartë arsyeja pse qëndrimi në xhehenem është i nevojshëm për të sëmurët që kanë nevojë për t'u nënshtruar terapisë atje, në mënyrë që të shërohen dhe më pas të jetojnë një jetë normale, të shëndetshme dhe të hareshme në xhenet. Sipas konceptit të Islamit mbi xhenetit dhe xhehenemit, pasi të kurohen atje, ata do të 'lirohen' nga ky spital. I Dërguari i Allahut ^{s.a.v.s.} ka thënë: "Vërtet që do të vijë një kohë kur në xhehenem nuk do të ketë asnjë banor, por kjo pasi ata të kenë jetuar atje me shekuj".³⁵ Kurani Famëllartë na mëson gjithashtu se xhehenemi nuk do

të zgjasë përgjithmonë; “Me të vërtetë, Xhehenemi është në pritë, ai vendkthim i caktuar për keqbërësit, në të dotë mbetsin gjatë”.³⁶

Sa më të rënda të jenë sëmundjet e tyre, aq më shumë do të zgjatet periudha e shërimit të tyre. Deri në momentin që kjo do të ndodhë, ata do të vazhdojnë të jenë të padenjë për të jetuar në parajsë, njësoj si një i sëmurë të cilit i nevojitet regjim shtrati derisa t’i kalojë sëmundja.

Kurani Famëllartë, qëllimin e krijimit të njeriut përshkruan me këto fjalë: “Nuk i krijuar xhindët dhe njerëzit por vetëm që të Më adhurojnë”.³⁷ Fjala e përdorur për adhurim është يَبْجُدُونَ ‘Ja’budun’, e cila nënkupton kryerjen e ‘ibadetit’. Në arabisht العِبَادَةُ ‘Ibadeh’ do të thotë t’i nënshtrohesh një disipline rigoroze, që të jesh i denjë për t’i pasqyruar atributet hyjnore në një farë shkalle brenda qenies sate. Kështu, qëllimi i krijimit të njeriut është shumë fisnik, madhështor dhe shpirtëror.

Prandaj, xhehenemi nuk mund të zgjasë përgjithmonë. Një ditë do të duhet të pushojë së ekzistuari. Banorëve të tij, pas shërimit të plotë, do t’u lejohet të jetojnë një jetë normale e të shëndetshme në xhenet. Atje, ata do të fitojnë gjithnjë e më shumë shkallët e afërsisë me Zotin e tyre dhe do të pasqyrojnë atributet e Tij gjithmonë e më shumë. Duke qenë se atributet e Zotit janë të pafund, bie që

edhe parajsa të jetë e përjetshme.

Në diskursin fetar lidhur me parajsën, ekziston një keqkuptim te disa njerëz, të cilët kujtojnë se banorët e parajsës nuk do të bëjnë asnjë punë, veçse do të rrinë, do të hanë e do të pijnë, dhe do të bëjnë qejf. Ndërsa në këndvështrimin islam, jeta pa veprim e pa objektiv është thjesht e pakuptimtë. Lumturia e vërtetë gjendet në veprim dhe zhvillim. Kurani Famëllartë tregon:

“Drita e tyre do të ecë fuqishëm para tyre dhe në të djathtë të tyre. Ata do të thonë: “O Zoti ynë, përsosë dritën tonë dhe falna ne! Vërtet Ti je i Fuqishëm për të bërë çdo gjë që dëshiron”.³⁸

Kjo do të thotë se banorët e parajsës do të jenë vazhdimisht të angazhuar për të ndjekur dritën që u paraprin atyre, dhe në këtë mënyrë do të vazhdojnë të zhvillohen nga ana shpirtërore. Kështu, krahasuar me jetën në Tokë, përpjekjet tona në botën e pëtejme do të jenë më të mëdha. Në çdo çast që pasurojmë njohuritë tona hyjnore, do të zhvillohemi më shumë. Megjithatë, kjo përpjekje e përhershme nuk do të na shkaktojë asnjë lodhje:

“... ata do të thonë: Lavdia është e Allahut që na largoi brengën. Pa dyshim, Zoti ynë është shumë Falës, Mirënjohës. I cili na pruri me bekimin e Tij në shtëpinë e përjetësisë; këtu nuk na prek mundimi dhe këtu nuk na prek as lodhja”.³⁹

Sipas Kuranit Famëlartë, mirësia më e madhe në parajsë do të jetë pëlqimi i Zotit:

“Allahu u ka premtuar besimtarëve dhe besimtareve kopshte, rrëzë të cilave rrjedhin lumenj dhe ku do të banojnë përgjithmonë, si dhe shtëpi të mrekullueshme në Xhenete të përherëshme. Por kënaqësia prej Allahut është (shpërblimi) më i madh. Kjo është fitorja madhështore”.⁴⁰

Realiteti i robërshave të dëlira në xhenet

Tani le të marrim në konsideratë *‘hyrijet’* (virgjëreshat e dëlira) në xhenet. Kurani Famëlartë thotë, “Po, kështu do të jetë, dhe Ne do t’i shoqërojmë ata me hyri sybukura”.⁴¹ Si dhe: “Atje do të ketë virgjëresha sy ulur, të cilat para tyre nuk i kanë prekur as njerëz, as xhindë”.⁴²

Këto do të jenë gra të dëlira dhe të devotshme, të cilat do të jenë bashkëshortet e tyre. Bukuria e tyre shpirtërore do të shfaqet edhe në hirësinë fizike. Nëse dikush shkon në xhehenem, dhe bashkëshorti apo bashkëshortja e tij/saj shkon në Parajsë, atëhere ai apo ajo do të bashkohet me një banor të parajsës, i cili/e cila i përngjan më shumë shpirtërisht duke u kurorëzuar kështu në lidhjen e martesës. Është e qartë se një person i cili ka shkuar në xhehenem nuk do të jetë më i përshtatshëm me atë që ka shkuar në

xhenet. Por, vetëm Zoti e di se kush do të bashkohet më kë në botën e përtejme.

Ne duhet të pranojmë se nuk e kemi aftësinë e nevojshme për të perceptuar aq sa duhet natyrën dhe vetitë e jetës pas vdekjes, ndërkohë që jetojmë në këtë botë materiale e cila ka kufizimet e veta. Prandaj, ky përshkrim shërben vetëm për të dhënë një ide të përgjithshme për jetën pas vdekjes, duke e përqasur me jetën tonë tokësore. Kurani Famëlartë është mjaft i qartë lidhur me këtë çështje. Ai thotë:

“Askush nuk di se çfarë gëzimesh janë fshehur për të (në jetën tjetër), si shpërblim për punët e mira që kanë bërë”.⁴³

I Dërguari i Allahut ^{s.a.v.s.} ka thënë në lidhje me mirësitë e xhenetit: “Asnjë sy nuk i ka parë, asnjë vesh nuk i ka dëgjuar, dhe asnjë mendje nuk mund t’i përfytyrojë ato”.⁴⁴ Ky sqarim shërben njësoj edhe për ndëshkimet në xhehenem.

A është i mundur komunikimi me të vdekurit?

Këtu duket e nevojshme t’i përgjigjemi edhe kësaj pyetjeje të rëndësishme: A është e mundur për ne të komunikojmë me ata të cilët kanë vdekur? Përgjigjia është po, por kjo varet plotësisht vetëm nga vullneti i Zotit. Ndonjëherë ai i lejon robërit të Tij të komunikojnë me

njerëz nga bota e përtejme dhe kjo bëhet nëpërmjet *Keshfit* (vizioneve). Kjo është edhe arsyeja pse, të tjerët që mund të jenë të pranishëm në atë moment, nuk mund t'i dëgjojnë biseda të tilla.

Njëherë, themeluesi i Xhematit Musliman Ahmedia, ndaloi diku gjashtë milje larg Hoshiarpurit gjatë një udhëtimi për në Kadian. Ai zbriti nga karroca dhe tha: “Ky është një vend i këndshëm që ka edhe hije. Le të ndalojmë këtu për pak”. Në atë vend ndodhej varri i një njeriu të shenjtë musliman. Ai shkoi tek ai varr. Dëshmitari i kësaj ngjarjeje, Hazret Abdullah Sanori ^{r.a.} thotë:

“Unë e ndoqa atë nga mbrapa, ndërsa Shejh Hamid Aliu dhe Fateh Khani qëndruan në karrocë. Huzuri shkoi afër varrit dhe i ngriti duart për lutje. Ai u lut për pak kohë, dhe më pas u kthye nga unë dhe më tha: “Kur unë i ngrita duart për t’u lutur, banori i këtij varri doli prej tij dhe u ul përpara meje në shenjë respekti. Nëse nuk do të ishit me mua, mund edhe të kisha folur me të. Ai kishte ngjyrë të errët dhe sy të mëdhenj”. Më pas ai tha, “Shiko rrotull se mos gjejmë ndonjë rojë të varrit që të mund ta pyesim në lidhje me të”. Kështu Huzuri e pyeti rojen i cili tha, “Unë personalisht nuk e kam parë pasi ai ka vdekur rreth njëqind vjet më parë, por kam dëgjuar nga babai dhe gjyshi im se ai ka qenë një shenjtori i madh i kësaj zone”. Kur u pyet për tiparet e tij ai tha: “Ai kishte ngjyrë

të errët dhe sy të mëdhenj”.⁴⁵

Sërisht, një një hadith të Muslimit, në librin ‘*Kitabul Xheneti ves-sifati Nua’maiha ve ebliha*’ Hazret Enes ibn Maliku ^{r.a.} ka thënë se pas betejës së Bedrit, i Dërguari i Allahut ^{s.a.v.s.} shkoi te kufomat e të vdekurve mosbesimtarë dhe u tha, “O filan bir i filanit! O filan bir i filanit! A e gjetët të vërtetë atë që ju kishte premtuar Allahu dhe i Dërguari i Tij? Omeri ^{r.a.} e pyeti: “O i Dërguar i Allahut! Si mund të flisni me këta trupa të pajetë?” Ai tha: “Atë që u them, ata e dëgjojnë më mirë se ju, vetëm se nuk mund të kthejnë përgjigje”.⁴⁶

Kjo tregon se Zoti bëri të mundur që shpirtërat e tyre t’i dëgjonin ato fjalë në *Berzab*.

Le ta qartësojmë që pretendimet e të ashtuquajturve spiritualistë që shpirtat e të vdekurve mund të komunikojnë me njerëzit e gjallë nëpërmjet një ndërmjetësi, janë vetëm mashtrime. Shembulli i mëposhtëm do të mjaftojë për të kuptuar të vërtetën.

Në vitin 1924, kur Hazret Mirza Bashiruddin Mahmud Ahmedi ^{r.a.}, Kalifi i dytë, kishte bërë një turne nëpër Europë, ai vizitoi një shoqëri apo klub spiritualist. Spiritualisti e pyeti atë se shpirtin e kujt donte të thërriste. “Do të doja të thërrisja shpirtin e Profetit Muhammed ^{s.a.v.s.}” u përgjigj ai. Pas pak kohe spiritualisti i tha atij se shpirti që kishte

kërkuar, tashmë gjendej në dhomë. Kalifi tha: “O i Dërguar i Allahut! Ju lutem, recitoni suren el-Fatiha”. Përgjigjja, nëpërmjet ndërmjetësit (spiritualist) siç parashikohej ishte, “Nuk e di”.⁴⁷

A është e mundur që Profeti Muhammed s.a.v.s. të mos dijë suren el-Fatiha?! Suren të cilën ua mësoi të tjerëve përgjatë gjithë jetës së tij e të cilën e di përmendësh çdo fëmijë musliman?!

Të gjallët mund të komunikojnë me shpirtat nëpërmjet vizioneve (*keshf*). Kjo është një dhunti që ta dhuron Zoti dhe nuk mund të fitohet me përpjekjet njerëzore.

Tani të flasim pak për lidhjen e shpirtit me trupin e tij në varr sipas këndvështrimit të Islamit. I Dërguari i Allahut s.a.v.s. ka thënë: “Nuk ka asnjë Profet i cili nuk qëndron në varr dyzetë ditë pas vdekjes”.⁴⁸

Në lidhje me këtë, themeluesi i Xhematit Musliman Ahmedia ka thënë:

“Kjo tregon se sado i shenjtë të jetë njeriu, (shpirti i tij) fillimisht për disa ditë ruan një lidhje me varrin e tij dhe me këtë botë materiale. Dikush (e ruan këtë lidhje) për shkak të dëshirës për t’i shërbyer fesë, ndërsa dikush për ndonjë arsye tjetër. Pastaj kjo lidhje bëhet aq e zbehtë, sikur banor i varrit del prej tij, për ndryshe pas vdekjes shpirti menjëherë vendoset në vendin e tij shpirtëror”.⁴⁹

Duke qenë se shpirti kishte qëndruar në atë trup për shumë vite, andaj ai edhe pas vdekjes e kujton atë dhe ruan një lidhje me të për ca kohë. Por kjo nuk do të thotë se shpirti qëndron në trupin e të vdekurit gjatë kësaj kohe. Kurrësi, sepse pas vdekjes ai menjëherë shkon në destinacionin e tij, në botën shpirtërore. Me kalimin e kohës, kjo lidhje dobësohet dhe përfundimisht pushon së ekzistuari. Është njësoj me lidhjen e një njeriu me vendlindjen e tij i cili emigron në një vend të ri përgjithmonë. Ai e kujton vendin e tij për pak kohë dhe me kalimin e kohës kjo lidhje zbehet derisa vjen një moment që nuk i bie ndërmend.

Një person shpirtërisht i pastër, mund të kontaktojë të vdekurit vetëm në *keshf*. *Keshfi* është një lloj ëndrrë por që është në një shkallë më të lartë e më të zhvilluar se ëndrra. Ëndërra shihet në gjumë ndërkohë që *keshfi* në zgjim. Ashtu sikur shikon dikë në ëndërr, nuk do të thotë se ai person ka ardhur fizikisht te ti, po kështu në *keshf* ti e takon të vdekurin ndërkohë që shpirti i tij gjendet në botën e përtejme.

Ritualet dhe praktikat islame gjatë kohës së vdekjes

Kur një njeri është në prag të vdekjes, pranë tij recitohet surja Jasin (kapitulli i 36-të i Kuranit), sepse në këtë sure vdekja dhe jeta pas vdekjes janë trajtuar në mënyrë që i japin qetësi personit.

Tekbir dhe *shehadeti* gjithashtu recitohen me zë të ulët. Kur personi vdes, njerëzit e pranishëm si dhe ata të cilët e mësojnë më vonë lajmin, thonë: **إِنَّا لِلّٰهِ وَإِنَّا إِلَيْهِ رَاجِعُونَ** “Të Allahut jemi dhe tek Ai do të kthehem”.⁵⁰

Kjo dëshmi shpreh një bindje të patundur për botën e përtejme. Më pas të vdekurit i mbyllen sytë. Goja gjithashtu i mbyllet duke i lidhur një copë rreth kokës. Nuk duhet të ketë vajtime apo ulërime, përkundrazi duhet ruajtur vetëpërmbytje dhe qetësi.

Gjatë larjes së trupit, në fillim lahen ato pjesë të trupit që lahen edhe gjatë marrjes së abdesit. Më pas lahet ana e djathtë e trupit duke vijuar me anën e majtë. Pjesët intime duhet të qëndrojnë të mbuluara me një rrobë. Burrat e vdekur duhet të lahen nga burrat si dhe femrat nga femrat. Sigurisht që edhe bashkëshorti mund të lajë bashkëshorten si dhe anasjelltas. Transmetohet se Aliu ^{r.a.} lau trupin e bashkëshortes së tij Fatime ^{r.a.},⁵¹ ndërsa Ebu Bekri ^{r.a.} ishte larë nga bashkëshortja e tij Asma ^{r.a.} dhe djali i tij Abdurrahman duke përmbushur kështu amanetin e tij.⁵²

Sa i përket qefinit, parapëlqehet një copë e bardhë. Qefini për burrat përbëhet nga tri pjesë:

1. Këmisha: Siç tregon emri, kjo pjesë i ngjan këmishës, që zgjatet prej qafës deri te gjunjët. Kjo është pjesa e parë e qefinit, që i vihet trupit pas larjes.

2. Izari: Më pas, trupi mbështillet nga Izari që është një çarçaf i gjatë nga koka deri te thembrat e këmbëve.

3. Lifafi: Ky çarçaf është më i gjatë se Izari dhe është pjesa e fundit e qefinit. Lifafi mbëshjtell gjithë trupin dhe në fund, lidhen të dyja anët e trupit, pra mbi kokë dhe nën këmbë.

Për femrat, përveç këtyre tri pjesëve, shtohen edhe dy të tjera, një pëlhurë për kraharorin dhe një lidhëse për flokët.

Pas këtyre përgatitjeve trupi vendoset në një arkivol dhe përcillet në vendin ku do të zhvillohet namazi i xhenazes. Trupi vendoset në atë mënyrë që pjesa e djathtë e trupit të të vdekurit të jetë i drejtuar nga Kibla. Të pranishmit vendosen në rreshta. Nuk është e thënë që numri i rreshtave të jetë patjetër numri tek, pasi edhe Profeti ^{s.a.v.s.} gjatë një xhenazeje i pati organizuar të pranishmit në dy rreshta.⁵³ Imami qëndron përpara besimtarëve, i pozicionuar në mes të rreshtave, ndërsa trupi i të ndjerit qëndron përpara tij.

Namazi i xhenazes përbëhet nga tri pjesë. Imami fillon namazin duke thënë me zë të lartë: ‘*Allahu Ekber*’ (Allahu është më i madhi) ndërkohë që ngre duart e tij te

veshët apo te shpatullat duke i vendosur më pas në kraharor (dorën e djathtë mbi të majtën). Më pas reciton *Thena* në zemër duke vijuar më pas me suren *El-Fatiha*. Besimtarët bëjnë të njëjtën gjë pas Imamit. Më pas Imami sërish thotë: ‘*Allahu Ekber*’ për pjesën e dytë të namazit në të cilën i dërgon salavate të Dërguarit të Allahut ^{s.a.v.s.}. Më pas thotë: ‘*Alahu Ekber*’ me zë të lartë për pjesën e tretë të namazit. Në këtë pjesë recitohet lutja e mëposhtme:

*“O Allah! Fale të gjallin dhe të vdekurin tonë, të pranishmin dhe të papranishmin tonë, të voglin dhe të madhin tonë, mashkullin dhe femrën tonë. O Allah! Këdo që të lësh gjallë nga ne, mbaje gjallë në Islam dhe kujtdo që t’ia marrësh shpirtin nga ne, merrja shpirtin në iman. O Allah! Mos na moho nga shpërblimi i këtij të vdekuri dhe mos na sprovo pas tij”.*⁵⁴

Më pas Imami thotë: ‘*Allahu Ekber*’ dhe e kthen fytyrën e tij në të djathtë e pastaj në të majtë duke thënë ‘*Es-selamu alejkum ua Rahmetullah*’ secilën herë. Në rast se i vdekuri është fëmijë, shtohet dhe lutja e mëposhtme:

“O Allah! Bëje këtë fëmijë për ne pararendës, prijës, thesar, shpërblim, ndërmjetësues dhe të pranuar si ndërmjetësues”.⁵⁵

Pas namazit të xhenazes, arkivoli përcillet drejt varrezës. Parapëlqehet që besimtarët ta mbajnë atë mbi shpatullat e tyre megjithatë, mund të përdoret edhe ndonjë mjet transporti. Kur varri është gati, trupi ulet në varr dhe recitohet:

“Me emrin e Allahut, me ndihmën e Allahut dhe për popullin e të Dërguarit të Allahut!”⁵⁶

Pas varrimit, bëhet edhe lutja me xhemat dhe më pas të pranishmit largohen. Kur vizitojmë varrezën duhet bërë kjo lutje:

“Paqja qoftë mbi ju, o banorët e shtëpisë (së ahiretit) prej besimtarëve e prej muslimanëve. Ne, në dashtë Allahu, do t’ju bashkohemi juve. Ju kemi prijës e ne jemi ndjekësit tuaj. I kërkoj Allahut mbarësi për ne dhe për ju”.⁵⁷

Fjalët e lutjes së xhenazes përfshijnë të gjithë umetin musliman – të gjallët dhe të vdekurit, të pranishmit dhe ata të munguarit, të rinjtë dhe të vjetrit, femrat dhe meshkujt. Kjo përkthyeran një vëllazëri muslimane universale.

Ndonjëherë disa dobi shpirtërore apo materiale janë të lidhura drejtpërdrejt me të vdekurin, prandaj disa nga besimtarët luten që komuniteti apo individët të mos privohen nga këto dobi. Ka raste kur vdekja e një njeriu shndërrohet në një vështirësi a pengesë për disa individë,

prandaj në lutjen e xhenazes gjithashtu kërkohet që ajo vdekje të mos bëhet sprovë apo shkak i përçarjes për të tjerët.

Le të jetë e qartë se kur një musliman qëndron pranë një varri dhe lutet për të vdekurin, nuk do të thotë se i vdekuri i dëgjon lutjet, pasi lutjet i drejtohen Zotit. Sigurisht, me lejen e Zotit edhe i vdekuri mund t'i dëgjojë ato. Kurani Famëllartë është mjaft i qartë në lidhje me këtë temë. Aty thuhet:

“Po ashtu, nuk janë kurrë të barabartë të gjallët dhe të vdekurit. Allahu bën të dëgjojë kë të dojë Vetë, kurse ti nuk mund të bësh të dëgjojnë ata që janë në varre”.⁵⁸

Me një fjalë, shpirti pas ndarjes nga trupi është si një “bërthamë” e mirë apo e keqe, në varësi të veprave të tij të mira apo të këqija në këtë jetë e cila më pas zhvillohet në gjendjen *berzah* në një trup me një shpirt të përgatitur. Më pas nga kjo gjendje, njeriu evoluohet në një personalitet të plotë, për të shfaqur në Ringjallje, e cila është një “jetë e re”. Sigurisht që ky trup i ri do të jetë i shëndetshëm ose i sëmurë, në varësi të veprave të tij në këtë jetë. Kjo na shtyn që ne të bëjmë sa më shumë vepra të mira dhe të shmangim ato të këqijat për të qenë sa më të shëndetshëm në jetën pas vdekjes në mënyrë që të fitojmë xhenetin, duke iu shmangur kështu kurimit në “spitalin” e ferrit. Jeta në parajsë është e

përjetshme, dhe atje vdekja do të gjejë fundin e vet. Sigurisht me vullnetin e Zotit, pas një periudhe jashtëzakonisht të gjatë që mund të konsiderohet ‘e përjetshme’, edhe kjo formë jetese mund të pushojë së ekzistuari. ﷻ

Ky shkrim është botuar për herë të parë në gjuhën angleze në revistën “*Review of Religions*”.

SHËNIME

1. Dr. Shahbaz Ahmad, “*Forensic Medicine and Toxicology*” (Mjekësia ligjore dhe Toksikologjia), f. 71.
2. Po aty.
3. Edward Morgan, “*Clinical Anaesthesiology (Anesteziologjia Klinike)*”, f. 809.
4. James Hastings, “*Encyclopaedia Britannica (Enciklopedia Britanike)*”, vëllimi VIII, botim i vitit 1951.
5. James Hastings, “*Encyclopaedia of Religion and Ethics (Enciklopedia e Fesë dhe Etikës)*”, zëri: “Life after death (Jeta pas vdekjes)”.
6. *Bibla, Testamenti i Vjetër, libri i Danielit*, kapitulli 12, vargu 2.
7. *Bibla, Testamenti i Vjetër, libri i Ezekielit*, kapitulli 37, vargjet 4-6.
8. “*The Jewish Encyclopaedia (Enciklopedia Hebraike)*”, zëri: “Gehenna”, f. 583, sipas Talmudit, libri Eruvin 19a, dhe libri Berakhot 8b.
9. George Sale, “*The Koran*”, printed by: “C. Ackers”, London 1734, p. 11, shënim nën fusnotën e ajetit 81 të sures El-Bekare.
10. *Bibla, Testamenti i Vjetër, libri i Numrave*,

kapitulli 16.

11. James Hastings, *“Encyclopaedia of Religion and Ethics (Enciklopedia e Fesë dhe Etikës)”*.

12. *Bibla, Testamenti i Ri, Letra drejtuar Romanëve*, kapitulli 5, vargu 12

13. Frank Sefijullah Khajrullah, *“Kamusul Kitab (Enciklopedia e Biblës)”*, botues: “Masihi Isha‘at Khana”, zëri: (مسيح – meut (vdekja)), Lahore 1997, f. 970.

14. James Hastings, *“Encyclopaedia of Religion and Ethics (Enciklopedia e Fesë dhe Etikës)”*, zëri: “Death and Disposal of the Dead (Vdekja dhe asgjësimi i të vdekurit)”.

15. Si më lartë, zëri: “Transmigration – Buddhist (Transmigrimi Budist)”.

16. Knut A. Jacobsen, *“Three Functions of Hell in the Hindu Traditions (Tre funksionet e Ferrit në traditat Hindu)”*, revista “Numen”, vëllimi LVI, nr. 2/3, botues: “Brill Publications”, Leiden 2009, f. 385-400.

17. James Hastings, *“Encyclopaedia of Religion and Ethics (Enciklopedia e Fesë dhe Etikës)”*.

18. *Kurani Famëlartë* 39:43.

19. Hazret Mirza Bashiruddin Mahmud Ahmed, *“Ahmadiyyat or The True Islam (Ahmediati ose Islami i vërtetë)”*, Tilford, Surrey 2007, f. 309.

20. *Kurani Famëlartë* 23:116-117.

21. *Kurani Famëlartë* 80:18-23.

22. *Kurani Famëlartë* 23:100-101.

23. *Kurani Famëlartë* 3:107.

24. Hazret Mirza Ghulam Ahmed, *“Filozofia e mësimëve të Islamit”*, Tiranë 2019, f. 160.

25. *Kurani Famëlartë* 3:107-108.

26. *Kurani Famëlartë* 16:29-30.

27. *Kurani Famëlartë* 16:33.

28. *Xhami‘u et-Tirmidhi*, kitab: *“Sifatil-Kijamah ver-rikaik vel-vera‘u”*, hadith nr. 2648.

29. *Kurani Famëlartë* 17:73.

30. *Kurani Famëlartë* 17:15.

31. *Kurani Famëlartë* 37:52-56.

32. *Kurani Famëlartë* 56:53.

33. Hakim Muzaffer Husjnn el-‘Awan, *“Kitabul-Mufredat”*, botues: “Sheikh Gulam Ali & Sons Ltd.”, zëri: “Thohar”, Lahore, Hajderabad, Karaçi 1960.

34. *Kurani Famëlartë* 78:25-27.

35. Ebu Muhammed el-Husejn el-Bagavi, *“Ma‘alimut-Tenzil (Tefsir el-Bagavi)”*, komentim i sures Hud, ajeti 109.

36. *Kurani Famëlartë* 78:22-24.

37. *Kurani Famëlartë* 51:57.

38. *Kurani Famëlartë* 66:9.

39. *Kurani Famëlartë* 35:35-36.

40. *Kurani Famëlartë* 9:72.

41. *Kurani Famëlartë* 44:55.

42. *Kurani Famëlartë* 55:57.

43. *Kurani Famëlartë* 32:18.

44. *Sabih el-Bukhari*, kitab: *“Bedeul-khalk”*, bab: *“Ma xhae fi sifetil-xhenneti ve enneha makhlukah”*, hadithi nr. 3244.


45. Maulana Dost Muhamed Shahid, *“Tarikh-e-Ahmadiyyat”*, vëllimi 1, Amritsar, 2007, f. 276.

46. *Sabih Muslim*, hadithi nr. 7222.

47. Fjalim i mbajtur nga Hazret Mirza Tahir Ahmedi r.a. më 6 Mars 1994.

48. ‘Alauddin el-Mutteki el-Hindi, *“Kenzul ‘Ummal”*, *“Kitabul Fadail”*, el-babuth-Thani.

..... vijon në f. 71



Pozita e lartë e Ehli Bejtit dhe e Hazret Imam Husejnit ^{r.a.}

Hazret Mirza Ghulam Ahmed ^{a.s.}

Mesih i Premtuar dhe Imam Mehdi

Ehli Bejti dhe vlera e tyre

“Për të përfituar nga bekimet e dritës Hyjnore, edhe dashuria për Ehli Bejtin ka rëndësi të madhe. Dhe kushdo që hyn në grupin e njerëzve të afërt të Zotit, në fakt, trashëgon bekimet e pikërisht këtyre të dëlirëve dhe të pastërve.”

جان و دلم فدايے جال محمد است
حاکم نثار کوچه آل محمد است

Zemra dhe shpirti im u flijofshin për bukurinë e Muhammedit! Pluhuri im u sakrifikoftë nëpër qoshet e familjes së Muhammedit!

Pozita e Hazret Imam Husejnit dhe ajo e Jezidit

“Unë përmes këtij publikimi, njoftoj xhematin tim se ne besojmë se Jezidi ishte një njeri i lig, krimb i botës dhe mizor. Vlerat që duhet të ketë një besimtar, ai nuk i kishte. Nuk është e thjeshtë për njeriun të bëhet besimtar. Për njerëzit e tillë, Allahu i Madhërishëm thotë:

قَالَتِ الْأَعْرَابُ آمَنَّا ۖ قُلْ لَمْ تُؤْمِنُوا وَلَكِنْ قُولُوا أَسْلَمْنَا

“Beduinët thanë: “Ne besuam!” Thuaju: Nuk keni besuar, por thoni “Ne pranuar Islamin”.^[1]

Besimtarët janë ata, të cilëve në zemrat u gdhendet besimi dhe të cilët i japin përparësi Zotit të tyre dhe pëlqimit të Tij mbi çdo gjë, të cilët për hir të Zotit, ndjekin rrugët e imëta dhe të ngushta

të takvasë (të druajtjes ndaj Tij), të cilët kridhen në dashurinë ndaj Tij, dhe të cilët e largojnë veten nga çdo “idhull” që i pengon t’i afrohen Zotit, qoftë vesi, qofshin veprat e këqija, qoftë pakujdesia, qoftë dembelia. Por Jezidi fatlig ku mund t’i kishte këto vlera?! Dashuria për botën e kishte verbuar.

Kurse Husejni radijallahu ‘anhu ishte i pastër dhe, pa dyshim, ishte ndër ata të dëlirë, të cilët Zoti i Madhërishëm i pastron me dorën e Vet dhe i mbush me dashurinë e Vet. Ai pa dyshim është njëri prej prijësve të xhenetit. Mund të humbasësh besimin, nëse ke qoftë një grimë mërie ndaj tij. Imam Husejni është model për ne në takvanë e tij, në dashurinë e tij për Zotin, në durimin, në qëndrueshmërinë, në dëlirësinë dhe në adhurimin e tij. Ne e ndjekim udhëzimin e atij njeriu të pastër (të Profetit Muhammed ^{s.a.v.s.}), që gëzonte edhe Imam Husejni. U shkatërrua ajo zemër që ushqen armiqësi ndaj tij dhe fitoi ajo zemër që ka treguar praktikisht dashurinë ndaj tij”.^[2]

Ashura dhe zija (matemi) gjatë ashurës, a lejohet?

“Gjithmonë duhet patur parasysh se profetët e Zotit, pagja qoftë mbi të gjithë ata, si dhe të tjerët që janë robër të sinqertë dhe të vërtetë të Zotit të Madhërishëm, vijnë për të vendosur një shembull në këtë botë. Tani, kushdo që

nuk përpiket t'i përshtatet shembullit të tyre, por fillon t'u bëjë sexhde dhe lutje duke besuar se ata ia përmbushin nevojat, kurrsesi nuk mund të ketë vlerë te Zoti i Madhërishtëm, përkundrazi, pas vdekjes së tij ai do të shohë se Imami i tij do të tregohet i distancuar me të. Po kështu, ata që hiperbolizojnë pozitën e Hazret Aliut ose të Imam Husejnit, me fjalë të tjera janë duke i adhuruar. Të tillët nuk janë ndjekës të Imam Husejnit dhe as Imam Husejni nuk mund të gëzohet prej tyre. Profetët 'alejhimus-selam (paqja qoftë mbi ta) gjithmonë vijnë si shembull për t'u ndjekur. E vërteta është që, pa i ndjekur ata, asgjë nuk mund të fitosh.”^[3]

SHËNIME

1. *Kurani Famëlartë* 49:15.
2. “*Mexhmu'a ishtiharat*”, vëll. 3, nr. i njoftimit 263, botues “Esh-Shariketul-Islamijeh” Rabvah, f. 548-550.
3. “*Melfuzat*”, vëll. 3, Rabvah, 2003, f. 535.

vijon nga f. 51

për të hasur ndonjë mëkat, atëherë ai i ikte asaj rruge më larg se çdokush tjetër nga njerëzit”.¹⁵

Sa i bukur dhe sa i përsosur është ky qëndrim! Shumëkush në botë vetëm

përpiket të mashtrojë të tjerët, duke e vënë veten kot në lloj-lloj vështirësish. Mundimi i njerëzve të tillë nuk bëhet për hir të Zotit, pasi çdo punë e padobishme kushtuar Zotit, është vetëm një mashttrim. Ngaqë mirësia e vërtetë e tyre mbetet shumë e pakët, ata përpiqen të mashtrojnë njerëzit e tjerë duke bërë vepra të gënjeshtërtë dhe duke mbuluar gabimet e tyre. Por, synimi i Profetit Muhammed ^{s.a.v.s.} ishte vetëm pëlqimi i Zotit të Lartësuar dhe arritja e mirësisë së vërtetë, andaj, atij nuk i duheshin fare adhurimet artificiale. Për të ishte njësoj që bota ta njihnte si njeri të mirë apo si jo të mirë. Ai kishte parasysh vetëm faktin se si do të shihej para Zotit të tij dhe para vetes. Pas dëshmisë së Zotit dhe vetvetes, nëse ai gëzonte edhe dëshminë e vërtetë të njerëzve, u tregohej mirënjohës, e nëse njerëzit e shikonin me shtrembësi, ai vetëm shprehte keqardhjen për paaftësinë e tyre, pa i dhënë asnjë vlerë mendimit të tyre.

SHËNIME

1. *Sahib Muslim*, kitab: “*El-Fadail*”, bab: “*Tevekkulibi ‘alall-llahi ve ‘ismetil-lahi te‘ala lehu minen-nas*”, hadithi nr. 5950.
2. Xhenetin. [Përkthyesi]
3. *Sahib el-Bukhari*, kitab: “*Er-Rikak*”, bab: “*El-Kasdi vel-mudavemeti ‘alel-‘amel*”, hadithi nr. 6463.
4. *Sahib el-Bukhari*, kitab: “*Et-Temenna*”,

bab: “Ma jukrebu minet-temenni”, hadithi nr. 7235.

5. *Sunen Ebu Davud*, kitab: “*Ebvabun-neum*”, bab “*Fil-metari*”.

6. *Sahih el-Bukhari*, kitab: “*Ed-Da’vat*”, bab: “*Istigfarin-Nebijji* ^{s.a.v.s.}”, hadithi nr. 6307.

7. *Sahih el-Bukhari*, kitab: “*Ed-Da’vat*”, bab: “*Vad’il-jedil-jumna tahtel-khaddil-ejmen*”, hadithi nr. 6314.

8. Në arabisht fjala është “nur” dhe bëhet fjalë për dritën e Zotit.

9. *Sahih el-Bukhari*, kitab: “*Ed-Da’vat*”, bab: “*Idha entebehe bil-lejli*”, hadithi nr. 6316.

10. *Sahih el-Bukhari*, kitab: “*El-Megazi*”, bab: “*Kissatul-esvedil-ansijji*”, hadithet nr. 4378-4379.

11. *Sahih el-Bukhari*, kitab: “*El-Edhan*”, bab: “*Hel jusal-lil-imamu bimen hadare ve hel jakhtubu jevmel-xhumuati fil-metari*”, hadithet nr. 668-669.

12. *Sahih el-Bukhari*, kitab: “*El-Menakib*”, bab: “*Menakibu Abdullah ibn ‘Umer ibnul-Khattab radijAll-llahu ‘anhuma*”, hadithet nr. 3738-3739.

13. *Sahih el-Bukhari*, kitab: “*Et-tehexh-xhud*”, bab: “*Tubridin-Nebijji s.a.v.s. ‘ala salatil-lejli ven-nevafili min gajri ixhab*”, hadithi nr. 1127.

14. *Kurani Famëlartë* 18:55.

15. *Sahih Muslim*, kitab: “*El-Fadail*”, bab: “*Muba’detihi s.a.v.s. lil-athami ve ikhtijarihi minel-mubahi es-helehu ve intikamih li-l-lahi te’ala ‘inde intihaki hurumatih*”, hadithi nr. 6045.

vijon nga f. 67

49. Hazret Mirza Ghulam Ahmedi, “*Izala Aubam*”, “*Ruhani Khazain*”, vëll. III, Tilford, Surrey 2009, f. 227 (fusnotë).

50. *Kurani Famëlartë* 2:157.

51. Ibn ‘Abdul-Berr, “*El-Isti’ab fi ma’rifetul-As’hab*”, kitab: “*En-Nisa ve kunahunne*”, bab: “*El-fa*”, zëri: Fatime bint Resulullah s.a.v.s. (nr. 3411), botues: “*Darul-A’lam*”, Amman 2002, fq. 928.

52. Muhammed Rida, “*Ebu Bekr es-Siddik evvelul-khulefair-rashidin*”, botues: “*Ihja el-kutub el-‘arabijje*”, Kajro 1950, fq. 155.

53. *Sahih Muslim*, kitab: “*El-Xhenaiz*”, bab: “*Fit-tekbiri ‘alel-xhenazeti*”, hadithi nr. 2209.

54. *Sunen Ebu Davud*, kitab “*El-Xhenaiz*”, bab: “*Ed-Du’au lil-mejjiti*”, hadithi nr. 3201.

55. *Sahih El-Bukhari*, kitab: “*El-Xhenaiz*”, bab: “*Kiraetu fatihatul-kitabi ‘alel-xhenazeti*”, hadithi nr. 1335. El-Khatib Et-Tibrizi, “*Mishkat el-Mesabih*”, kitab: “*El-Xhenaiz*”, hadithi nr. 1690.

56. *Xhami’u Et-Tirmidhi*, kitab: “*El-Xhenaiz*”, bab: “*Ma jekulu idha udkhilel-mejjitu el-kabre*”, hadithi nr. 1046.

57. *Sunen en-Nesai*, kitab: “*El-Xhenaiz*”, bab: “*El-Emru bil-istigfari lil-muslimine*”, hadithi nr. 2040.

58 *Kurani Famëlartë* 35:23.



EMRAT E ALLAHUT



6. EL-KUDDŪS (I SHENJTI)

Fjala el-Kuddūs القُدُّوس është një prej attributeve të Zotit të Madhërisëm, që i referohet asaj genieje, që është e pastër nga çdolloj mangësie a dobësie. Fjala el-Kuddūs rrjedh nga rrënja Ka-du-se قَدَس që do të thotë “u pastrua”, “u bekua”. Kur përdoret shprehja اللّٰهُ قَدُّسَهُ për dikë, ajo nënkupton që Allahu e ka dëlirësuar dhe e ka bekuar Atë.¹ Në një hadith të *Xhami’atut-Tirmidhi*, përmendet:

عَنْ الزُّبَيْرِ بْنِ الْعَوَّامِ، قَالَ قَالَ رَسُولُ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ “مَا مِنْ صَبَاحٍ يُصْبِحُ الْعِبَادُ فِيهِ إِلَّا وَمُنَادٍ يُنَادِي سُبْحُوا الْمَلِكَ الْقُدُّوسَ“

Hazret Zubejr ibn Avami ^{r.a.} transmeton se i Dërguari i Allahut ﷺ tha: “Çdo mëngjes që zë robin e Allahut, vjen me një thirrës që thërret: “Lavdëro Sunduesin e Shenjtë (*Sebbihul Melikel-Kuddūs*)”.²

El-Kuddūs - të cilin e lavdëron çdogjë në qiej e në tokë

Hazret Mesihu i Premtuar ^{a.s.} shkruan:

“*(Kurani Famëlartë)* provon me anë të ligjit të natyrës se Zoti është i pastër nga çdo mangësi dhe dobësi, dhe thotë:

“Atë e përlëvdojnë shtatë qiej dhe toka dhe bashkë me çdo gjë që gjendet në to”.³

Nuk ka asgjë që nuk e madhëron Atë, mirëpo ju nuk mund të kuptoni lavdërimin e tyre. Kjo do të thotë se të pasqyruarit në krijimin e qiejve e të tokës dëshmon se Zoti është i Përsosur dhe i Shenjtë. Ai është i Pastër nga nevoja për të pasur bij e bashkëpunëtorë. Por, këtë e zbulojnë vetëm ata që dinë të arsyetojnë”.⁴

Ai gjithashtu ka thënë:

الْمَلِكُ الْقُدُّوسُ“

Dihet që mbretërit tokësorë nuk janë pa dobësi. Për shembull, nëse i gjithë populli mërgon dhe shkon në një shtet tjetër, mbi kë do të mbretërojë mbreti? Nëse vendin e pushton thatësira, mbretëria nga do t’i ketë të ardhurat? Nëse populli rebelohet dhe i kërkon të provojë epërsinë mbi ta, çfarë aftësie të veçantë do t’u tregojë mbreti?⁵

SHËNIME

1. Sa’id El-Khuri Esh-Shertuni, *Akrebul Mevarid fi Fusahil Arabijjeti vesh-Shevarid*, vëllimi i dytë, zëri: Kāf-Dāl-Sin (قدس).

2. *Xhami’u et-Tirmidhi*, Kitab: Ed-Da’vat, hadith inr. 3569.

3. *Kurani Famëlartë* 17:45.

4. *Brabin-e-Abmadia*, vëll. IV, Ruhani Khezain, vëll. 1, f. 519, 520.

5. Hazret Mirza Ghulam Ahmed a.s., *Filozofia e mësimëve të Islamit*, f. 115, Tiranë, 2019.



7. ES-SELĀM (PAQJA)

هُوَ اللَّهُ الَّذِي لَا إِلَهَ إِلَّا هُوَ الْمَلِكُ الْقُدُّوسُ السَّلَامُ الْمُؤْمِنُ الْمُهَيْمِنُ الْعَزِيزُ
الْجَبَّارُ الْمُتَكَبِّرُ سُبْحَانَ اللَّهِ عَمَّا يُشْرِكُونَ

Ai është Allahu, përveç të cilit nuk ka të adhurueshëm tjetër. Ai është Sunduesi, i Shenjti (i pastër nga çdo e metë), Paqëdhënësi, Dhënësi i sigurisë, Mbikëqyrësi mbi gjithçka, i Plotfuqishmi, Imponuesi, Madhështori. Qoftë i lartësuar Allahu mbi gjithçka që ia shoqërojnë Atij (në adhurim)!¹

Atributi i Allahut *es-Selām* rrjedh nga rrënja *se-le-me* سلم e arabishtes. Ky atribut tregon se Zoti i Plotfuqishëm është i pastër nga çdo e metë, mangësi a dobësi.² Përveç kësaj, i Dërguari i Allahut ^{s.a.v.s.} gjithashtu ka shtjelluar këtë atribut në një hadith, që e gjejmë në Xhami' et-Tirmidhi:

حَدَّثَنِي قُوتَابٌ، مَوْلَى رَسُولِ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ قَالَ كَانَ رَسُولُ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ إِذَا أَرَادَ أَنْ يَتَصَرَّفَ مِنْ صَلَاتِهِ اسْتَعْفَرَ اللَّهَ ثَلَاثَ مَرَّاتٍ ثُمَّ قَالَ "اللَّهُمَّ أَنْتَ السَّلَامُ وَمَنْكَ السَّلَامُ تَبَارَكْتَ يَا ذَا الْجَلَالِ وَالْإِكْرَامِ".

Transmetohet nga Thobani, skllav i

liruar nga i Dërguari i Allahut ^{s.a.v.s.} i cili ka thënë se kur i Dërguari i Allahut kryente namazin, ai bënte tri herë istikfarin (lutjen për të kërkuar faljen e mëkateve) e pastaj thoshte: "O Allah! Ti je paqja dhe prej Teje vjen paqja! Je bekimplotë, o zotërues i madhështisë dhe i nderit".³

"Princi i Paqes"

Një ndër emrat, me të cilët Allahu i Madhërishëm iu drejtua Mesihut të Premtuar ^{a.s.} që "Princi i paqes".⁴

Duke shpjeguar kuptimin që përmban emri "Es-Selām", Hazret Mesihu i Premtuar ^{a.s.} shkruan:

"السَّلَامُ Ai është es-Selām. Pra, Zoti jo vetëm që është i pastër nga çdo e metë dhe i lirë nga çdo vështirësi e vuajtje, por është edhe Siguridhënësi. Zoti duhet ta ketë edhe këtë veti, sepse nëse Ai Vetë hyn në vështirësi, vritet nga duart e njerëzve dhe dështon në planet e Tij, si mund të qetësohen zemrat e njerëzve duke parë shembullin e Tij të keq dhe si mund të besojnë me siguri se një Zot i tillë patjetër do t'i shpëtojë nga vështirësitë?!"⁵

SHËNIME

1. Muhammed ibn Mendhur, *Lisanul-Arab*, vëllimi XII, zëri Sîn-Lām-Mîm (سلم), Botues: Neshru Edeb el-Hauzeh, Kum, Iran, 1985.
2. Kurani Famëlartë 59:24.
3. *Xhami' et-Tirmidhi*, Kitab: *es-Salat*, Bab: *Ma jekulu idba sel-leme mines-salati*, haditi nr. 300.
4. Hazret Mirza Ghulam Ahmed ^{a.s.}, "Teddikireh",

f. 1061.

5. Hazret Mirza Ghulam Ahmed ^{a.s.}, *Filozofia e mësimave të Islamit*, f. 116, Tiranë, 2019.



8. EL-MU'MIN (PAQEDHËNËSI)

هُوَ اللَّهُ الَّذِي لَا إِلَهَ إِلَّا هُوَ الْمَلِكُ الْقُدُّوسُ السَّلَامُ الْمُؤْمِنُ الْمُهَيَّمُونَ الْعَزِيزُ
الْحَبِيزُ الْمُتَكَبِّرُ سُبْحَانَ اللَّهِ عَمَّا يُشْرِكُونَ

Ai është Allahu, përveç të cilit nuk ka të adhurueshëm tjetër. Ai është Sunduesi, i Shenjti (i pastër nga çdo e metë), Paqëdhënësi, Dhënësi i sigurisë, Mbikëqyrësi mbi gjithçka, i Plotfuqishmi, Imponuesi, Madhështori. Qoftë i lartësuar Allahu mbi gjithçka që ia shoqërojnë Atij (në adhurim)!¹

Atributi i Zotit الْمُؤْمِنُ El-Mu'min rrjedh nga rrënja اَمْنٌ (el-emnu) që përshkruan gjendjen e paqes, dhe të sigurisë që është e kundërta e frikës. Sipas fjalorit “Lisanul-‘Arab” kuptimi tjetër i fjalës el-Mu'min është *el-Musad-dik* الْمُصَدِّقُ d.m.th. Ai që përmbush premtimet që i ka bërë krijesës së Tij.²

Në lidhje me këtë atribut, gjejmë një thënie profetike.

حَدَّثَنَا مُعَاوِيَةُ بْنُ عَمْرٍو، حَدَّثَنَا رَشِيدٌ، قَالَ: حَدَّثَنِي مُعَاوِيَةُ بْنُ سَعِيدٍ
الثَّجِيبِيُّ، عَنْ حَدَّثَهُ عَنْ فَصَالَةَ بْنِ عُيَيْدٍ، عَنْ النَّبِيِّ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ أَنَّهُ
“ قَالَ: ” الْعَبْدُ آمِنٌ مِنْ عَذَابِ اللَّهِ عَزَّ وَجَلَّ، مَا اسْتَعْفَرَ اللَّهَ عَزَّ وَجَلَّ

Hazret Fadala ibn Ubejdi ^{r.a.} transmeton nga i Dërguari i Allahut ^{s.a.v.s.} se ai ka thënë: “Derisa rob i vijon t’i kërkojë falje Allahut të Plotfuqishëm, Ai i jep atij mbrojtje nga ndëshkimi i Tij”.³

El-Mu'min - Kështjella e pamposhtur e paqes

“Nuk je e sigurt, oj Europë, as ti, oj Azi. O banorët e ishujve, asnjë perëndi e krijuar nga ju nuk do të jetë e aftë t’ju ndihmojë. Unë shikoj qytete që shemben dhe banime në rrënoja. Ai Zot i Vetëm heshti për një periudhë të gjatë. Vepra të këqija u bënë përpara syve të Tij dhe Ai u tregua i duruar. Por tani Ai do të shfaqet në një formë të tmerrshme. Ai që ka veshë le të dëgjojë se koha nuk është e largët. Unë jam përpjekur t’i mbledh të gjithë nën sigurinë e Zotit, por edhe dekretet hyjnore duhet të plotësoheshin. Singerisht ju them të vërtetën, që po i afrohet radha edhe këtij kombi. Ju do të jeni dëshmitarë të kohës së Nuhit (Noas) dhe sytë tuaj do të shikojnë atë që ndodhi në tokën e Lutit (Lotit). Por Zoti është i ngadalte në zemërimin e Tij. Pendohuni që t’u tregohet mëshirë. Ai që braktis Zotin

është një insekt dhe jo njeri, dhe ai që nuk i frikësohet Atij është i vdekur dhe jo i gjallë”.⁴

SHËNIME

1. *Kurani Famëlartë* 59:24.
2. Muhammed ibn Mendhur, *Lisanul-‘Arab*, vëllimi XIII, zëri Elif-Mīm-Nūn (أمن), Botues: Neshru Edeb el-Hauzeh, Kum, Iran, 1985, f. 21.
3. Ahmad ibn Hanbel, *Musned*, vëllimi XXXIX, Botues: *Muesseretur-Risale*, Bejrut, 1421 h./2001, f. 376, hadithi nr. 23953.
4. Hazret Mirza Ghulam Ahmed ^{a.s.}, *Hakikatul Vahi*, *Ruhani Khazain*, vëll. 22, f. 267-269.



9. EL-MUHEJMIN (STREHUESI)

هُوَ اللَّهُ الَّذِي لَا إِلَهَ إِلَّا هُوَ الْمَلِكُ الْقُدُّوسُ السَّلَامُ الْمُؤْمِنُ الْمُهَيَّمِينَ الْعَزِيزُ
الْجَبَّارُ الْمُتَكَبِّرُ سُبْحَانَ اللَّهِ عَمَّا يُشْرِكُونَ

Ai është Allahu, përveç të cilit nuk ka të adhurueshëm tjetër. Ai është Sunduesi, i Shenjti (i pastër nga çdo e metë), Paqëdhënësi, Dhënësi i sigurisë, Mbikëqyrësi mbi gjithçka, i Plotfuqishmi, Imponuesi, Madhështori. Qoftë i lartësuar Allahu mbi gjithçka që

ia shoqërojnë Atij (në adhurim)!¹

Atributi *el-Muhejmin* الْمُهَيَّمِينَ është një prej emrave të Allahut të Madhërishëm që do të thotë qenie që sjell paqe e siguri dhe që është mbikëqyrës. Zoti i mbikëqyr veprimet e njerëzve si dhe i furnizon dhe mbështet ata.

سَمِعْتُ رَسُولَ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ وَهُوَ عَلَى الْمِنْبَرِ، يَقُولُ: يَأْخُذُ
الْجَبَّارُ، “أَيُّ: اللَّهُ عَزَّ وَجَلَّ، وَالْجَبَّارُ اسْمٌ مِنْ أَسْمَاءِهِ سُبْحَانَهُ وَتَعَالَى،
”سَمَوَاتِهِ وَأَرْضُهُ بِيَدِهِ- وَقَبْضُ بِيَدِهِ، فَعَجَلَ يَقْبِضُهَا، وَيَسْطُطُهَا-“، أَيْ: وَجَعَلَ
الَّتِي صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ يَقْبِضُ يَدَهُ وَيَسْطُطُهَا، وَهَذَا يُوَافِقُ قَوْلَ اللَّهِ عَزَّ
وَجَلَّ: {وَمَا قَدَرُوا اللَّهَ حَقَّ قَدْرِهِ وَالْأَرْضُ جَمِيعًا قَبْضَتُهُ يَوْمَ الْقِيَامَةِ
وَالسَّمَوَاتُ مَطْوِيَّاتٌ بِيَمِينِهِ سُبْحَانَهُ وَتَعَالَى عَمَّا يُشْرِكُونَ} [الزمر: 67]؛
فَالسَّمَوَاتُ وَالْأَرْضُ فِي يَدِ اللَّهِ سُبْحَانَهُ وَفِي قَبْضَتِهِ، لَا يَقُوتهُ مِنْ شَيْءٍ، وَلَا
يَخْفَى عَنْ عِلْمِهِ مِنْ شَيْءٍ، وَلَا يَعْزُبُ عَنْ قُدْرَتِهِ مِنْهَا قَلِيلٌ وَلَا كَثِيرٌ

Hazret Abdullah ibn Omeri^{r.a.} transmeton se e ka dëgjuar të Dërguarin e Allahut ^{s.a.v.s.} kur ai ishte në minber dhe po na përcillte fjalët e Allahut. Ai tha:

“Në Ditën e Gjykimit, Allahu i Madhërishëm do të shtrëngoje qiejt dhe token e Tij”. Pastaj i Dërguari i Allahut ^{s.a.v.s.} (e përshkroi këtë duke) shtrënguar dhe liuar grushtin e tij. Kjo i përgjigjet fjalës së Allahut: “Ata nuk e kanë vlerësuar Allahun siç duhej. Në Ditën e Kiametit, e tërë Toka do të jetë nën sundimin e Tij, ndërsa qiejt do të mbështillen nën dorën e Tij të djathtë. I Shenjtë është Ai dhe është shumë i lartë nga ajo që ata shoqërojnë me Të në adhurim!”²

Qiejt dhe Toka janë në duart e Zotit, pra ato i nënshtrohen Atij. Allahut nuk i mungon asgjë nga sundimi i tyre dhe nuk i fshihet asgjë nga dija. Asgjë sado e vogël apo e madhe nuk bën përjashtim nga fuqia e Tij. Pastaj, Allahu i Plotfuqishëm thotë: “Unë jam i Gjithëmëshirshmi, Sunduesi, i Shenjti, Paqja, Paqedhënësi, Strehuesi, Triumfuesi, Ndreqësi, Krenari, Mbrojtësi, jam Unë që krijova botën, kur ajo nuk ishte asgjë dhe jam Unë që do ta kthejë atë (në gjendjen e saj origjinale). Ku janë ata që krenohen?! Ku janë ata që mbretërojnë në tokë?!”³

El-Muhejmin - Sundimi i Zotit

وَالَّذِينَ هُمْ لِأَمَانَاتِهِمْ وَعَهْدِهِمْ رَاعُونَ

(Besimtarët) janë ata që u përmbahen amaneteve dhe zotimeve të tyre.⁴

“Domethënë ata nuk bëjnë aspak lëshim në drujtje e vëmendje për sa i përket plotësimit të amaneteve dhe përmbushjes së zotimeve. Kjo tregon që njeriu dhe të gjitha fuqitë e tij p.sh. shqisa e të parit, të dëgjuarit, të folurit dhe fuqia e gjymtyrëve si duart dhe këmbët janë amanete prej Zotit të Madhërishëm. Ai na ka dhuruar këto amanete, dhe kur të dëshirojë, mund të na i marrë ato. Të qenë i kujdesshëm ndaj këtyre amaneteve, do të thotë, t’i përkushtohesh Zotit, duke ia nënshtuar shpirtin me të gjitha aftësitë e tua dhe trupin me të gjitha fuqitë dhe gjymtyrët

e tua. Robi duhet t’u përgjigjet kushteve sado të vogla të drujtjes, sikur fuqitë e tij nuk i përkasin atij, por Zotit, si dhe lëvizja dhe pushimi i çdo fuqie dhe çdo gjymtyrë nuk varet nga dëshira e tij por nga vullneti i Zotit. Në këtë gradë të besimit duhet të pushojë së ekzistuari dëshira e tij individuale, dhe le të veprojë vetëm vullneti i Zotit përmes fuqive dhe gjymtyrëve të tij. Qenia e tij në dorën e Zotit, duhet të jetë sikur një trup i pajetë në duart e të gjallit. Ai duhet të dorëhiqet nga vullneti i tij dhe qenia e tij t’i dorëzohet tërësisht sundimit të plotë të Zotit të Madhërishëm, aq shumë, sa që të shikojë përmes Tij, të dëgjojë përmes Tij, të flasë përmes Tij dhe të lëvizë apo të ndalet përmes Tij. Ai duhet t’i heqë ndyrësitë më të imëta të vetvetes që nuk vërehen as me mikroskop, dhe atij të mbetet vetëm shpirti i pastruar”.⁵

SHËNIME

1. *Kurani Famëlartë* 59:24.
2. *Kurani Famëlartë* 39:68.
3. Ibn Tejmiye, *Mexhmua Fetava*, Vëllimi 6, f. 560, 561, Botues: Ministria e Çështjeve Islame, Thirrjes dhe Udhëzimit e Arabisë Saudite, Medinë, 2004.
4. *Kurani Famëlartë* 23:9; 70:33.
5. Hazrat Mirza Ghulam Ahmed ^{a.s.}, *Berabine Ahmedia*, Vëll. 5, *Ruhani Khazain*, Vëll. 21, f. 239-241.



10. EL-AZĪZ (TRIUMFUESI)

هُوَ اللَّهُ الَّذِي لَا إِلَهَ إِلَّا هُوَ الْمَلِكُ الْقُدُّوسُ السَّلَامُ الْمُؤْمِنُ الْمُهَيَّمِنُ الْغَزِيرُ
الْجَبَّارُ الْمُتَكَبِّرُ سُبْحَانَ اللَّهِ عَمَّا يُشْرِكُونَ

Ai është Allahu, përveç të cilit nuk ka të adhurueshëm tjetër. Ai është Sunduesi, i Shenjti (i pastër nga çdo e metë), Paqëdhënësi, Dhënësi i sigurisë, Mbikëqyrësi mbi gjithçka, i Plotfuqishmi, Imponuesi, Madhështori. Qoftë i lartësuar Allahu mbi gjithçka që ia shoqërojnë Atij (në adhurim)!¹

El-Azīz الغَزِيرُ është një prej attributeve të Allahut. Sipas gramatikanit arab ez-Zexhaxh (Ebū Is'hāk Ibrāhīm ibn Muhammad ibn al-Sarī al-Zajjāj) fjala el-Azīz i referohet qenies që nuk mund të nënshtrohet apo të mbizotërohet prej dikujt. El-Azīz shënjon gjithashtu qenien që është unike dhe e pakrahasueshme. Në lidhje me këtë emër të Allahut, ne gjejmë një lutje të të Dërguarit të Allahut ^{s.a.v.s.}:

عَنْ بُرَيْدَةَ الْأَسْلَمِيِّ قَالَ : قَالَ لِي رَسُولُ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَآلِهِ وَسَلَّمَ :
" قُلِ اللَّهُمَّ إِنِّي ضَعِيفٌ فَقَوِّ فِي رِضَاكَ ضَعْفِي ، وَخُذْ لِي الْخَيْرَ بِتَأْصِيتِي
، وَاجْعَلْ الْإِسْلَامَ مُتَّبَعِي رِضَائِي ، اللَّهُمَّ إِنِّي ضَعِيفٌ فَقَوِّني ، وَإِنِّي ذَلِيلٌ
فَأَعِزَّنِي ، وَإِنِّي فَقِيرٌ فَارْزُقْنِي "

Hazret Burejda el-Eslemiu transmeton se i Dërguari i Allahut ^{s.a.v.s.} i ka thënë: "Thuaj: O Allah! Unë jam i pafuqishëm, prandaj më dhuro fuqi në pëlqimin Tënd dhe më çoj drejt mirësisë duke më kapur për ballukesh. Më bëjë Islamin kulmin e kënaqësisë. O Allah! Jam i dobët, më jep fuqi. Jam njeri i pavlerë, më jep nder. Jam i varfër, më furnizo".²

El-Azīz: Dhuruesi i nderit

Allahu është i Plotfuqishëm dhe i Urtë.

Kjo thënie, d.m.th. fjala e Allahut: عَزِيزًا حكِيمًا aludon për faktin se Allahu e lartëson kë të dojë dhe u mbron nderin robërve të Tij të zgjedhur, me anë të urtësisë së Tij të plotë, të thellë dhe gjithëpërfshirëse. Asnjëra nga planet e keqdashësve nuk mund të dëmtojë robërit e zgjedhur të Zotit, siç dështoi plani i hebrenjve kundër Jezusit ^{a.s.}, madje Allahu i dha nder Jezusit dhe e lartësoi në pozitë dhe shkatërroi kurthin e komplotuesve".³

SHËNIME

1. Kurani Famëlartë 59:24.
2. Hakim al-Nishapuri, *El-Mustedrek ales-Sabihajn*, Kitab: *Ed-Du'a vet-Tekbir vet-Tehlil vet-Tesbih vedh-Dhikr*, numri i hadithit 1974.
3. Hazret Mirza Ghulam Ahmed ^{a.s.}, *Hamamatul Bushra, Rubani Khaza'in*, Vëll.7, f. 257-258, fusnotë.

Lutje për të pasur mirësi materiale në botë dhe shpirtërore në ahiret

اللَّهُمَّ أَصْلِحْ لِي دِينِي الَّذِي هُوَ عِصْمَةُ أَمْرِي وَأَصْلِحْ لِي
دُنْيَايَ الَّتِي فِيهَا مَعَاشِي وَأَصْلِحْ لِي آخِرَتِي الَّتِي فِيهَا مَقَارِي
وَأَجْعَلِ الْحَيَاةَ زِينَةً لِي فِي كُلِّ غَيْرٍ وَأَجْعَلِ الْمَوْتَ رَاحَةً
لِي مِنْ كُلِّ شَرٍّ

*All-llāhumme aslih li dīnī el-ledhī huve 'ismetu emrī, ve aslih li dunjā el-letī fihā me'āshī,
ve aslih li ākhiretī el-letī fihā me'ādī, vexh'al el-hajāte zijādeten li fī kul-li khajrīn,
vexh'alil-meute rābaten li min kul-li sherrin.*

O Allah! Më përmirëso besimin, që është forca ime në punët e mia.

Më përmirëso botën, që është mjet mbijetese për mua.


Më përmirëso ahiretin, që është vendkthimi im.

Ma bëj jetën riprodhuese për çdo të mirë.

Më bëj vdekjen qetësi nga çdo e keqe.

*Sahih Muslim, kitāb: "Edh-Dhikr ved-du'a' vet-teubeh vel-istigfār", bāb: "Et-T'e'awvudhu min sherrī mā 'amile ve
min sherrī mā lem ja'mel", hadithi nr. 2720.*

Një vit me Covid-19




PËRMBLEDHJE AKTIVITETETSH GJATË KOHËS
SË PANDEMISË NGA XHEMATI MUSLIMAN AHMEDIA
DHE ORGANIZATA HUMANITARE “*HUMANITY FIRST*”
NË SHQIPËRI, KOSOVË DHE GJERMANI

Projektet humanitare gjatë pandemisë në Shqipëri



Me bekimin e Allahut, më 6 maj 2020, organizata bamirëse e Xhematit Musliman Ahmedia “Humanity First”, shpërndau pako me ushqime dhe produkte të higjienës mes 80 familjeve në nevojë të Mallakastrës. Veprimtaria humanitare u zhvillua duke bashkëpunuar me Bashkinë e Mallakastrës.



Kryetari i Bashkisë z. Qerim Ismailaj priti në zyrën e tij delegacionin e Humanity First dhe e falënderoi atë për ndihmën. Ai gjithashtu siguroi që kjo ndihmë u shkon familjeve më në nevojë të Bashkisë së Mallakastrës.

Në javën e parë të prillit 2020, Humanity First, organizata humanitare e Xhematit Musliman Ahmedia, dhuroi pako ushqimore për 110 familje në nevojë të qytetit të Tiranës gjatë pandemisë.

Projekti u bë në bashkëpunim me Bashkinë e Tiranës dhe me Qendrën Komunitare “Gonxhe Bojaxhiu”. 2 tonë ushqime u shpërndanë mes 110 familjeve në nevojë të Njërive 4, 6, Vaqarr dhe Ndroq, të cilat i morën pakot në shtëpitë e tyre gjatë vetë-izolimit për shkak të Pandemisë. Kryetari i Bashkisë z. Erion Veliaj falënderoi Xhematin dhe Organizatën “Humanity First Deutschland” për ndihmën dhe mbështetjen gjatë këtyre ditëve.

Në letërën e tij, Kryetari i Bashkisë z. Erion Veliaj falënderoi Xhematin Musliman Ahmedia të Shqipërisë dhe Organizatën “Humanity First Deutschland” për ndihmën dhe mbështetjen gjatë këtyre ditëve. Z. Veliaj tha:

Bashkia Mallakaster
6. Maj 2020

Faleminderit fondacionit “Humanity First” të cilet kontribuan me 80 pako ushqimore. Keto paketa ushqimore u shpërndanë tek familjet në veshitësi ekonomike.
Do jemi prane çilitdo që është në veshitësi reale ekonomike.
#BashkeDoJaDalim



“Në emër të Bashkisë Tiranë dëshiroj t’ju falënderoj për mbështetjen që Fondacioni “Xhemati Myslyman Ahmadija i Shqipërisë” ka dhënë për realizimin e projekteve dhe nismave të ndryshme të ndërmarra për qytetin tonë.

Në këtë kuadër Fondacioni “Xhemati Myslyman Ahmadija i Shqipërisë” nëpërmjet bashkëpunimit me organizatën e vet humanitare të degës së Gjermanisë “Humanity First Deutschland” ka qenë mbështetës për të përballuar situatën e krijuar së fundmi nga pandemia e virusit Covid-19, duke ndihmuar me dhurimin e 110 pakove me ndihma ushqimore (produkte bazë të shportës) për familjet në nevojë, në territorin e Bashkisë Tiranë.”

Më 23 prill 2020, organizata bamirëse “Humanity First”, në bashkëpunim me Bashkinë e Shkodrës, shpërndau pako me ushqime dhe produkte të higjienës mes 100 familjeve në nevojë të Shkodrës.

Kryetarja e Bashkisë Znj. Voltana Ademi priti në zyrën e saj delegacionin e Humanity First dhe e falënderoi atë për ndihmën. Ajo gjithashtu siguroi që kjo ndihmë u shkon familjeve më në nevojë të Bashkisë së saj.

Humanity First përpiqet t’u vijë në ndihmë në sektore të ndryshme të jetës gjatë situatës së pandemisë, në Shqipëri, Kosovë, Maqedoninë e Veriut dhe në vende të tjera të Ballkanit.



Projektet e organizatës “Humanity First” gjatë pandemisë në Kosovë



Organizata Humanitare “Humanity First” projektin e parë gjatë pandemisë e filloi me shpërndarjen e disa ilaçeve bazë për parandalimin e pandemisë në fund të muajit mars 2020. Këto ilaçe përfshinë: termometër digjital, vitaminë C sirup dhe tabletë, multivitaminë, dy lloje të paracitamolit si dhe udhëzimin se si duhet të përdoren. Këto ilaçe u shpërndanë te rreth 200 persona në qytetet të ndryshme të Kosovës si: Prishtinë, Pejë, Mitrovicë, Gjiilan, Shtime dhe disa fshatra përreth këtyre qyteteve.



Kryetari i komunës Kamenicë Z. Qëndron Kastrati gjatë aksionit të Humanity First.

Projekti tjetër i radhës ishte shpërndarja e pakove higjienike për 2557 persona në nevojë. Përfitues ishin ato familje që e kanë gjendjen e rëndë ekonomike që janë të regjistruar në Qendrën Sociale në komunën e Kamenicës. Shpërndarja u bë gjatë datës 29 mars 2020 përmes kamionit shtëpi më shtëpi, dhe ndër pajisjet higjienike përfshihej: dezinfektues për duar, sapun, detergjent për rroba, detergjent për enë, shampo për flokë dhe letër tualeti. Në këtë projekt mori pjesë edhe kryetari i Kamenicës Z. Qëndron Kastrati.

Më 14 prill 2020, Humanity First në bashkëpunim me Komunën e Istogut bëri shpërndarjen e pakove higjienike dhe përfitues ishin mbi 500

persona që janë të regjistruar në Qendrën për Punë Sociale në këtë komunë. Qëllimi i kësaj ndihme ishte që me e mbajtë pastërtinë në nivelin shtëpiak gjatë kohës së karantinës. Shpërndarja u bë përmes transportit shtëpi me shtëpi dhe një pako higjienike përfshinte 25 gjëra themelore për mbajtjen e pastërtisë shtëpiake: gota të plastikës, sapun, brushë për dhëmbë, pastë për dhëmbë, ajrosës për tualet, dezinfektues për duar, shampo për flokë, shpuzë për pastrim, detergjent për dysHEME, detergjent për tesha dhe enë etj.. Gjatë monitorimit dhe përgatitjes së pakove higjienike ishin: Drejtori i Drejtorisë për Shërbimeve Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim Z. Enver Rugova, Drejtori i Arsimit Z. Hajrush Shoshi dhe Drejtor i Drejtorisë për Planifikim Urban dhe Mjedis Z. Besart Dreshaj.



Pakot higjienike gjatë përgatitjes për shpërndarje.



Donacioni për Spitalin Rajonal dhe Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare në Gjilan.

Në dhjetëditëshin e fundit të muajit prill 2020, Humanity First ka shpërndarë produkte mbrojtëse kundër Covid-19 në 3 institucione. Kjo organizatë përmes Komunës së Prishtinës dhe Drejtorisë për Mirëqenie Sociale ka dhuruar donacion me produkte mbrojtëse për Kuzhinën Popullore në Komunën e Prishtinës. Në këtë donacion përfshihen: dorëza, maska si dhe dezinfektues duarsh. Po atë ditë, përmes Komunës së Prishtinës, pako me produkte mbrojtëse i janë dhuruar edhe Sindikatës së Policisë së Kosovës për Rajonin e Prishtinës. Ky donacion përfshinë: 100 pako dorëza, 300 maska, 40 litra dezinfektues për duar dhe 8 litra dezinfektues për dysheme.

Donacionin e pranoi Z. Imer Zeqiri, i cili është kryetar i kësaj Sindikate. Ndërsa në Komunën e Gjilanit u dhuruan të njëjtat

produkte mbrojtëse, dhe donacionin e pranoi nënkryetari i Gjilanit Z. Arbër R. Ismajli së bashku me dr. Ukshin Ismailin, dhe ky dhurim u dedikua për Spitalin Rajonal dhe Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare në Komunën e Gjilanit.

Në kuadër të edukimit dhe arsimimit, Humanity First vazhdoi ndihmën e saj të pakursyer edhe për nxënësit që vijnë shkollën online gjatë pandemisë përmes platformës e-mësimi. Mirëpo jo të



Kryetari i Komunës së Prishtinës, z. Shpend Ahmedi pranoi dhuratat e organizatës Humanity First për nxënësit e qytetit nga përfaqësuesi i saj z. Xhinahuddin Saif

gjithë fëmijët kishin mundësi të kyçeshin në mësim sepse në mungesë të pajisjeve kompjuterike, mësimi atyre iu pamundësua. Thirrjes për mbështetje dhe ndihmë nga Komuna e Prishtinës i doli Humanity First, duke i dhuruar 45 tablete për familjet me gjendje jostabile ekonomike dhe që kanë më shumë se 3 fëmijë në shkollë. Ky donacion iu dorëzua Komunës së Prishtinës më 24 prill 2020 dhe atë e pranoi kryetari i Prishtinës Z. Shpend Ahmeti.

Për të njëjtën arsye, për vijimin online të mësimin nga fëmijët me kushte të rënda ekonomike, Humanity First i dhuroi edhe 23 tablete përmes Komunës së Kamenicës më datë 5 maj 2020. Donacionin e pranoi kryetari i kësaj komune Z. Qëndron Kastrati së bashku me Drejtoreshën e Drejtorisë për Zhvillim Ekonomik Znj. Majlinda Krasniqi dhe Shefin e Kabinetit të Komunës së Kamenicës Z. Meriton Ramabaja.

Në prag të festës së Fitër Bajramit, më datë 20 maj 2020 Humanity First përmes vullnetarëve të saj shpërndau mbi një ton mish në Komunën e Prishtinës, në dy lagjet e kryeqytetit: Tophane dhe Aktash. Kjo shpërndarje u bë në bashkëpunim me Koordinatorin për Projekte pranë Drejtorisë për Mirëqenie Sociale në Komunën e Prishtinës, Z. Premtim N. Fazliu. Përfitues të këtij dhurimi ishin 1773 persona, përfshirë fëmijët, dhe secila nga 350 familjet i kishte nga 2-3 kilogram mish.

Më 22 maj 2020, në kuadër të donacioneve të dhuruara, përfitoi edhe Policia e Kosovës, Drejtoria Rajonale e Pejës. Në këtë donacion përfshihen materiale mbrojtëse kundër koronavirusit si: 300 shishe dezinfektues për duar, 250 shishe pastrimi me përbërje alkooli, 2000 doreza dhe 300 maska. Pranim-dorëzimi i materialeve u bë në zyrat e Drejtorisë Rajonale ndërsa Z.

Fadil Gashi nga zyra për informim e Policisë Rajonale të Pejës, ka falënderuar për zemërsisht për bashkëpunimin institucional dhe ofrimin e ndihmës në këtë kohë të vështirë.

Produkte të njëjta Organizata Humanity First i dhuroi edhe Spitalit të Përgjithshëm në Pejë



Kryetari i Komunës Kamenicë Z. Qëndron Kastrati gjatë pranimit të donacionit.



Donacioni për Spitalin Rajonal dhe Qendrën kryesore të Mjekësisë Familjare në Gjiçan.

më datë 11 qershor 2020. Këto pajisje mbrojtëse përfshijnë: 2000 palë doreza, 250 maska kirurgjikale, 300 dezinfektues për duar, 250 shishe me alkool, 40 litra dezinfektues për dysheme dhe 20 mantelë kirurgjik. Në emër të Spitalit të Përgjithshëm në Pejë për këtë donacion falënderoi Drejtori Mjekësor dr. Muhamet Haliti.

Njëra nga institucionet mjekësore që përfitoi nga donacionet e Humanity First ishte edhe Qendra e Mjekësisë Familjare numër 5 në Komunën e Prishtinës. Më datë 15 qershor 2020 u përrua tuneli dezinfektues dhe në këtë inaugurim morën pjesë zyrtarë nga Komuna e Prishtinës, drejtori i Drejtorisë së Shëndetësisë, dr. Bujar Gashi, përfaqësuesi i Drejtorisë për Mirëqenie Sociale Z. Premtim N. Fazliu dhe U.D. Zëvendës Drejtor i QKMF dr. Spec. Rezart Halili.




Zyrtarët doganorë gjatë pranimit të materialit mbrojtës.

Njëra nga institucionet që kanë qenë përballë rrezikut me Covid-19 ishte edhe Dogana e Kosovës si dhe zyrtarët doganorë. Përmes një memorandum bashkëpunimi në mes Komunës së Prishtinës, Humanity First dhe Sindikatës së Pavarur të Doganës së Kosovës për qëllim ofrimin e materialeve medicinale-higjenike mbrojtëse për parandalimin e infektimit, kësaj të fundit iu dhuruan këto materiale mbrojtëse: 395 shishe me përbërje alkooli (rreth 40 litra), 350 shishe dezinfektues për duar (87.5 litra) dhe 20 shishe dezinfektues për dysheme (100 litra).

Me shtimin e rasteve në kryeqendrën e Kosovës në Prishtinë, Humanity First në bashkëpunim institucional me Komunën e Prishtinës më 8 korrik 2020 kanë bërë montimin e 30 stacioneve të autobusave për dezinfektim të duarve dhe pajim me maska higjenike. Disa nga to janë statike dhe disa të vendosura në mur. Disa nga këto stacione ishin më të frekuentuara në Prishtinë.

Një javë më pas, më 15 korrik 2020 Humanity First ka ndihmuar Qendrën për Punë Sociale të Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale të Komunës së Prishtinës, sepse disa nga punonjësit e tyre kishin rezultuar pozitiv me virusin SARS-CoV-2. Dhe nisur nga rekomandimet e Institutit Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës dhe me qëllim të ruajtjes së shëndetit të punonjësve dhe të palëve, u bë dezinfektimi i të gjitha njësive të saj.



Njësitë e Qendrës për Punë Sociale duke u dezinfektuar.

Në prag të festës së Kurban Bajramit që u shënuar në të gjithë botën (gjithashtu edhe në Kosovë) më 31 korrik 2020, Humanity First dhuroi mbi një ton mish në disa qytete të Kosovës si: Podujevë, Prizren, Pejë, Istog dhe Prishtinë. Përfitues ishin familjet në nevojë, personat me ndihmë sociale, pjesëtarët e Komunitetit Rom, personat e verbër dhe veteranët e luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës në Pejë dhe Istog. Produktet e mishit përfshijnë: suxhuk, mish, qebapë dhe pleskavica. Gjithsej u shpërndanë 1111 kilogramë mish dhe përfitues ishin



Aksioni i shpërndarjes së mishit u realizua në 5 qytete dhe rreth 8 mijë persona përfituan prej tij. rreth 8 mijë persona.

Në kuadër të bashkëpunimit institucional në mes Humanity First, Komunës së Prishtinës dhe Forcës së Sigurisë së Kosovës, më datë 5 gusht 2020, në hapësirën e kazermës “Adem Jashari” të FSK-së, u bë inaugurimi i tunelit dezinfektues, në të cilin morën pjesë zyrtarë nga tri palët bashkëpunuese dhe nënshkruese të memorandum bashkëpunimit. Në emër të FSK-së drejtori i Qendrës Mjekësore, Dr. Shkëlzen Sylaj falënderoi Humanity First për këtë donacion.



Ushtarë të FSK-së, përfaqësues nga Humanity First dhe Komuna e Prishtinës pranë tunelit dezinfektues.

Disa nga aktivitetet e Xhematit Musliman Ahmedia në Gjermani gjatë kohës së pandemisë



Në muajin mars 2020, qeveria gjermane vendosi sanksione dhe kufizime për të ndaluar përhapjen e virusit Covid-19. Këto rregulla ndryshuan kryekëput jetën shoqërore në të gjitha nivelet dhe fushat. Me gjithë sfidat e vështirësitë, anëtarët e Xhematit iu përshtatën këtij realiteti të ri dhe dhanë mesazhin e shpresës, solidaritetit dhe bindjes. Ja disa pamje nga aktivitetet e xhematit në Gjermani gjatë kohës së pandemisë.



dhe ushqimeve për fqinjët e tyre.

Organizata e grave "Lexhna Imaillah" dhuroi



Anëtarët mbështetën organizatat bamirëse duke kontribuar me ushqime të paketuara si dhe duke ofruar shërbimin vullnetar të blerjes së ilaçeve

mijëra maska në mbarë Gjermani.

Gjatë pandemisë, namazet në xhami u falën me rregulla të distancës dhe higjienës, ndërsa të gjitha takimet e



mbledhjet u zhvilluan Online.

Edhe gjatë pandemisë, nuk u ndalën programe si *“Podiumsdiskussion”* kundër racizmit, duke respektuar rregullat striktë të Covidit.



Më 25 korrik 2020, u zhvillua një turne me biçikleta *“Kilometra kundër urrejtjes – muslimanët për paqe”*. Ata vizituan 10 xhami dhe mbuluan rreth 150 kilometra. Turne të tilla u zhvilluan në mbarë vend.

Për fushatën *“Muslimanët kundër*





racizmit" u shpërndanë qindra mijëra fletushka dhe u vendosën billborda në qytetet kryesore të vendit.

Gjatë kohës së pandemisë organizata humanitare e Xhematit "Humanity First Deutschland" realizoi dhjetëra projekte në vendet e Ballkanit, duke investuar

rreth 10 milionë euro. *Elhamdulillah*

Në qytetin Groß Gerau, u organizuan analiza të shpejta falas për të përcaktuar infektimin me virusin Corona. Njerëzit mund të bënin teste dhe merrnin përgjigje, duke qëndruar në auto-veturë.

Për të përcjellë mesazhin e vërtetë të Islamit, u zhvilluan qindra programe digjitale. Për herë të parë, panairi "Islamausstellung" u zhvillua në platformën digjitale.

Xhemati i Gjermanisë pati nderin të kishte disa takime virtuale me Hazret Kalifatul Masih V (Allahu e ndihmoftë



VIRTUELLER RUNDGANG
durch die Islamausstellung
am 03.10.2020 um 13 Uhr
mit anschließender Live Q&A

Digital Event

LIVE

aus der Mubarak
Moschee in Wiesbaden

LIVE.AHMADIYYA.DE



Arabic text, likely a quote or a statement related to the event.

Arabic text, likely a quote or a statement related to the event.



fuqimisht).

Më 3 janar 2021, 25 anëtarët e organizatës “Lexhna Imaillah” zhvilluan një takim virtual me Hazret Kalifatul Masih V (Allahu e ndihmoftë fuqimisht). Këto anëtare kanë përqafuar Islam-Ahmediatin kohët e fundit, dhe i rrëfyer



Kalifit sfidat e tyre pas këtij vendimi.

NGA VIJNË NDIHMA DHE FURNIZIMI I ZOTIT?

Hazret Ebu Derdaja ^{r.a.} rrëfen se e ka dëgjuar të Dërguarin e Allahut ^{s.a.v.s.} duke thënë:

عَنْ أَبِي الدَّرْدَاءِ، قَالَ سَمِعْتُ النَّبِيَّ صَلَّى
اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ يَقُولُ ” اِبْعُوثَنِي صُغَفَاءَكُمْ
فَإِنَّمَا تُزَرِّقُونَ وَتُنْصَرُونَ بِصُغَفَائِكُمْ “

“Më kërkonin mua në mes të dobëtëve, sepse, ju furnizoheni dhe ndihmoheni përmes të dobëtëve mes jush”. (Pra, nëse do t’i ndihmoni ata, ju vjen ndihma prej Zotit)

Xhami’u et-Tirmidhi, kitab “El-Xhihad”, bab “Ma xhae fil-istiftahi bisa’alikil-muslimine”, hadithi nr. 1702.

Ramazani i heq njeriut largësinë nga Zoti

Njëri prej bekimeve të mëdha të muajit të Ramazanit është që gjatë këtij muaji, hiqet largësia mes nesh dhe Zotit të Madhërishëm. Në lidhje me këtë, Hazret Kalifi i Dytë i Mesihut të Premtuar ^{r.a.} thotë:

“Sado shekuj të kalojnë mes nesh dhe Profetit Muhammed, të Dërguarit të Allahut ^{s.a.v.s.}, sado vite të na largojnë ne në kohë nga ai, sado ditë të na shtohen duke shtuar distancën kohore mes nesh dhe atij, kur vjen muaji i Ramazanit, duket sikur ai i palosi krejt këta shekuj, këto vite dhe muaj, duke na çuar afër Muhammedit, të Dërguarit të Allahut ^{s.a.v.s.}. Madje, jo vetëm afër Profetit Muhammed ^{s.a.v.s.}, ngaqë Kuranin e zbriti Zoti i Madhërishëm, ne e ndiejmë që Ramazani e hoqi gjithë largësinë që ekzistonte mes nesh e Zotit.

Largësia që njeriu ka me Zotin, largësia që kanë krijesat ka me Krijuesin, largësia që një qenie e dobët dhe e paaftë e ka me Krijuesin e qiejve dhe të Tokës, gjatë Ramazanit zhduket në atë mënyrë sikur errësira me ardhjen e rrezeve të diellit.

Është pikërisht kjo gjendje, për të cilën Zoti i Madhërishëm në Kuranin Famëlartë thotë:

“Kur robërit e Mi të pyesin rreth Meje, Unë pa dyshim jam afër”.¹

Që do të thotë: Kur vjen muaji i Ramazanit dhe robërit e Mi do të të pyesin ty rreth Meje që si mund të Më gjejnë ata, thuaju se nuk ka aspak largësi me Mua gjatë Ramazanit. Pra, është pikërisht ky muaj gjatë të cilit Zoti i Madhërishëm e shfaq Vetën për robërit e Tij. Pikërisht gjatë këtij muaji, Ai deshi t’i tërheqë robërit edhe një herë drejt Vetes së Tij.

Përmes këtij libri (Kurani Famëlartë) që është litari i Allahut, njëri cep i të cilit është në dorën e Zotit dhe tjetri në dorën e krijesave, robërit e Tij e kanë obligimin të ngjiten lart dhe të arrijnë te Zoti”.²

1. Kurani Famëlartë 2:187.

2. Tefsir-e-Kebir, vëll. 2, f. 393.



Foto von Ali Arapoğlu von Pexels

A duhet të
agjërojmë
nëse jemi në
udhëtim ose
të sëmurë?



Kurani porositi udhëtarin e të sëmurin të agjërojnë në ditë të tjera dhe jo gjatë Ramazanit. Bekimi vjen me pëlqimin e Zotit dhe jo me forcën e krahut.

Porosia e Kuranit për udhëtarin e të sëmurin

Allahu i Madhërishëm në Kuranin Famëlarhtë thotë:

فَمَنْ كَانَ مِنْكُمْ مَرِيضًا أَوْ عَلَى سَفَرٍ فَعِدَّةٌ مِنْ أَيَّامٍ أُخَرَ

“Pra, kushdo që është i sëmurë prej jush, ose që gjendet në udhëtim, le ta plotësojë numrin në ditë të tjera.”¹

Urdhri kuranor i lartpërmendur thotë qartë se njeriu duhet të shmanget nga agjërimi gjatë një udhëtimi ose gjatë sëmundjes dhe të kompensojë numrin e ditëve të humbura në ditë të tjera.

Hazret ‘Amr ibn Umejje ^{r.a.} rrëfen:

عَمُرُو بْنُ أُمَيَّةَ الصُّفَرِيُّ، قَالَ قَدِمْتُ عَلَى رَسُولِ اللَّهِ ﷺ مِنْ سَفَرٍ فَقَالَ: «تَنْظِرُ الْعِدَاءَ يَا أَبَا أُمَيَّةَ». فَقُلْتُ إِنِّي صَائِمٌ. فَقَالَ: «تَعَالِ إِذْ يُؤْتِي حَتَّى أُخْبِرَكَ عَنِ الْمَسَافِرِ إِنَّ اللَّهَ عَزَّ وَجَلَّ وَصَّعَ عَنْهُ الصِّيَامَ وَنُصِفَ الصَّلَاةَ»

“Erdha te i Dërguari i Allahut ^{s.a.v.s.} nga një udhëtim dhe ai më tha: “Prit pak, në mënyrë që të mund të hamë, o Ebu Umejje!” Unë i thashë: “Jam duke agjëruar”. Ai tha: “Afrohu pranë meje që të tregoj diçka për udhëtarin. Sigurisht, Allahu i Madhërishëm e ka hequr prej tij agjërimin dhe gjysmën e namazit.”²

Vlen të theksohet se ka hadithe të

caktuara të Profetit të Shenjtë ^{s.a.v.s.} të cilat tregojnë se ai nganjëherë agjëronte ndërsa udhëtonte, por kjo ndodhte vetëm kur ai agjëronte vullnetarisht dhe jo kur agjëronte gjatë Ramazanit.

Hazret Xhabir ibn ‘Abdullah ^{r.a.} rrëfen:

عَنْ جَابِرِ بْنِ عَبْدِ اللَّهِ رَضِيَ اللَّهُ عَنْهُ قَالَ: كَانَ رَسُولُ اللَّهِ ﷺ فِي سَفَرٍ، فَرَأَى رَحَامًا، وَرَجُلًا قَدْ ظَلَلَ عَلَيْهِ، فَقَالَ: «مَا هَذَا؟» فَقَالُوا: «صَائِمٌ». فَقَالَ: «لَيْسَ مِنَ الْبِرِّ الصُّوْمُ فِي السَّفَرِ»

“Gjersa i Dërguari i Allahut ^{s.a.v.s.} ishte në një udhëtim, ai pa një turmë njerëzish rreth një personi mbi të cilin bënë hije. Ai pyeti: “Ç’është kjo?” Ata i thanë: “(Ai) është agjërueshëm”. Profeti ^{s.a.v.s.} tha: “Nuk është prej mirësisë të agjërosh gjersa udhëton”.³

Mesihu i Premtuar ^{a.s.} thotë:

“Kush agjëron në Ramazan gjersa është i sëmurë ose në udhëtim, padyshim që nuk i bindet urdhrin të Zotit. Zoti ka thënë qartë se të sëmurët dhe udhëtarët nuk duhet të agjërojnë. Një i sëmurë duhet të agjërojë pasi të shërohet nga sëmundja, kurse udhëtarin pasi të ketë përfunduar udhëtimin. Ky urdhër duhet të merret parasysh. Pendimi pranohet përmes mirësisë së Allahut dhe jo përmes fuqisë së krahut. Zoti nuk ka specifikuar se sa duhet të jetë gjatësia e udhëtitimit dhe as nuk ka vendosur një kriter për shkallën e sëmundjes. Urdhri është i përgjithshëm dhe si rrjedhojë, nëse një person agjëron, ai e shkel

urdhrin e Zotit.”⁴

Hazret Mirza Bashir Ahmed^{ra} thotë se Mian Fazl Muhammed sahibi (shitës në lagjen “*Dar-ul-Fazl*”) i shkruajti duke i thënë:

“Gjatë procesit gjyqësor me Maulvi Muhammed Husejn Batalvi-n, për një seancë gjyqësore, na u desh të shkonim në Dharival⁵. Ishte një ditë e nxehtë vere e muajit Ramazan. Shumë miq ishin mbledhur në Dharival dhe plot prej tyre agjëronin. Një nga udhëheqësit e procesit gjyqësor që ishte me ndikim [e cila ishte zonjë] i bëri ftesë Mesihut të Premtuar^{a.s.}. Ai e pranoi ftesën. Udhëheqësja i solli orizin e ëmbël krahas ushqimeve të tjera. Disa shokë e pyetën Huzurin^{a.s.} në lidhje me agjërimet e tyre. Huzuri^{a.s.} tha: ‘Nuk është e lejueshme të agjërosh gjatë udhëtimit.’

Prandaj, të gjithë shokët e prishën agjërimin.”⁶

Agjërimi i gruas shtatzënë, gjdhënësese dhe lehonës

Gjatë Ramazanit, nëse një gruaje i fillon cikli menstrual, ajo duhet të ndërpresë agjërimin dhe të kompensojë agjërimet e humbura në ditët tjera. Shtatzëna, gjdhënësja ose lehona është e liruar nga agjërimi sepse, hyn në kategorinë e të sëmurëve.

Profeti i Shenjtë ^{s.a.v.s.} ka thënë:

قَالَ رَسُولُ اللَّهِ ﷺ: إِنَّ اللَّهَ تَعَالَى وَضَعَ شَطْرَ الصَّلَاةِ أَوْ يَضِفُ الصَّلَاةَ وَالصَّوْمَ عَنِ الْمَسَافِرِ وَعَنِ الْمَرْضِعِ أَوْ الْحَيْلَى

“Allahu i ka liruar nga agjërimi...

shtatzënat dhe lehonat.”⁷

Sipas thënies së Mesihut të Premtuar^{a.s.}, ata që janë vazhdimisht të sëmurë, udhëtarët ose nënat që e dinë se nuk do të kenë mundësi për të agjëruar, qoftë për shkak të moshës së shtyrë apo gjdhënies, nuk duhet të agjërojnë, por duhet të japin Fidje sepse është pothuajse e pamundur që të agjërojnë.⁸

A duhet të agjërojë dikush që udhëton për punë?

Nëse dikush udhëton shumë larg për punë ose jetesa e tij varet nga udhëtimet, atëherë ai duhet të agjërojë sepse është mësuar me këtë rutinë.

Njëherë Mesihu i Premtuar^{a.s.} u pyet për personin që udhëton për punë, nëse udhëtimi i një personi të tillë hyn në kategorinë e një udhëtimit, Ai ^{a.s.} u përgjigj: “[Personi që udhëton për punë] udhëtimet e tyre nuk duhet të konsiderohen udhëtime sepse ato janë pjesë e punës së tyre.”⁹

SHËNIME

1. *Kurani Famëllartë* 2:185.
2. *Sunen en-Nesai*, kitab: “*Es-Sijam*”, bab: “*Dhikru wad’is-sijami ‘anil-musafiri*”, hadithi nr. 2267.
3. *Sahih el-Bukhari*, kitab: “*Es-Saum*”, bab: “*Kawlun-Nebijji*” ^{s.a.v.s.}: *limen dhul-lile ‘alejhi, wesh-teddel-harru*”, hadithi nr. 1946.
4. *Gazeta “Badr”*, 17 tetor 1907, fq. 7.
5. Qytet në rajonin Gurdaspur, Indi.
6. Mirza Bashir Ahmed, “*Siretul-Mahdi*”, vëllimi 2, fq. 303.
7. *Sunen Ebu Davud*, kitab: “*Es-Sijam*”, bab: “*Ikbtijaril-Fitri*”, hadithi nr. 2408.
8. *Gazeta “Badr”*, 24 tetor 1907, fq. 3.
9. *Gazeta “Al-Fazl”*, 16 gusht 1948.

A priset agjërimi nëse merr vaksinën e Covid-19 gjatë agjëritit?



Foto: nga Thiridman, në Pexels.com

Udhëheqësi botëror i Xhematit Musilman Ahmedia, Hazret Mirza Masrur Ahmedi (a.b.a.) në lidhje me pyetjen nëse lejohet apo jo të marrësh vaksinën Covid-19 gjatë agjëritit, u përgjigj:

“Çdolloj injeksioni, qoftë intramuskular, qoftë intravenous, e prish agjërimin. Nëse ndonjë nga anëtarët e Xhematit ka për të marrë vaksinën gjatë muajit të Ramazanit, ai le të përfitojë nga lejimi që i jep feja Islame, duke mos agjëruar ditën e vaksinimit. Dhe le ta plotësojë ditën e paagjëruar, ndonjë ditë tjetër pas Ramazanit.”

Burim: Letra e Hazret Kalifatul Masih V (a.b.a.) drejtuar kryeredaktorit të gazetës “Al-Fazl International” më 13 prill.

وَهُوَ الَّذِي مَرَجَ الْبَحْرَيْنِ

Është Ai që bashkoi dy dete.

Kurani Famëlartë 25:54

Fakte interesante për kanalin Suez

Kanali i Suezit është një kanal artificial në Egjipt, i cili shtrihet nga Porti Said deri te Porti Tewfik në qytetin Suez dhe ka një gjatësi prej 193 kilometrash. Ky kanal lidh detin Mesdhe me detin e Kuq duke ofruar kështu rrugën më të shkurtër detare mes Azisë dhe Europës. Kanali ka rëndësi të madhe strategjike, pasi është rruga më e rëndësishme e cisternave detare për furnizimin e Europës me naftën e Lindjes së Mesme. Në vitin 2020 përmes kësaj rruge detare kanë lundruar më shumë se 18.500 anije dhe ka lëvizur rreth 13 përqind e tregtisë botërore. Çdo ditë 49 anije kalojnë përmes kanalit, dhe pas zgjerimit të tij në 2023, pritet që ky numër do të dyfishohet.

Punimet për hapjen e kanalit kanë vazhduar për 10 vjet dhe përfundimisht ai është hapur për anijet në vitin 1869. Diplomati francez Ferdinand de Lesseps drejtoi këtë projekt me mbështetje nga qeveria rajonale osmane dhe fitoi të drejtën për operimin e kanalit për 99 vjet. Në vitin 1956, Presidenti i Egjiptit Xhemal Abdel Naser nacionalizoi këtë kanal. Ky hap ndezi një krizë ushtarake, dhe vendet si Franca, Anglia dhe Izraeli u bashkuan kundër Egjiptit. Në vitin 1975 kanali është hapur sërish për kalimin e anijeve dhe tashmë mbikëqyret nga Autoriteti i Kanalit të Suezit (SCA).

Foto: Porti Tewfik në kanalin Suez
nga NASA, Public domain, përmes Wikimedia Commons

INDEX IN ENGLISH

9 **Ayatul Kursi and its Commentary**

Vërtetësia brings you Albanian rendering of *At-Tafsir-ul-Kabir* (The Grand Exegesis) written by Hazrat Mirza Bashiruddin Mahmud Ahmad ^{r.a.}, Second Worldwide Head of the Ahmadiyya Muslim Community. This is one of the most insightful and in-depth commentaries of the Holy Qur'an ever written.

HAZRAT MIRZA BASHIRUDDIN MAHMUD AHMAD ^{R.A.},
SECOND CALIPH OF PROMISED MESSIAH

24 **“The God so described is the fundamental bedrock of my community”**

HAZRAT MIRZA GHULAM AHMAD ^{A.S.}
PROMISED MESSIAH & IMAM MAHDI

26 **The Elusive Peace - Why we must revert back to God?!**

If there is any hope for civilization, for an uplifting, ennobling and worthwhile human community to emerge from the current cacophony of strife, debasement, nihilism and fanaticism, we must all revert back to God and reform ourselves.

DR. NASIM REHMATULLAH

30 **Living with Depression**

Depression is more than just sadness; it has been called the world's number one public mental health problem.

SAMAR HAFEEZ

36 **Poor As A Nation**

Analysis from a Nobel

PROF. DR. ABDUS SALAM

48 **Reliance on the Exalted Lord**

An excerpt from the book “Life of Muhammad s.a.”

HAZRAT MIRZA BASHIRUDDIN MAHMUD AHMAD ^{R.A.},
SECOND CALIPH OF PROMISED MESSIAH

52 **The Islamic Perspective of Life after Death**

This article aims to elaborate the enigma of death and analyze life after death from Islamic perspective

MALIK JAMIL R. RAFIQ

68 **The high position of Ahl al-Bayt and Hazrat Imam Hussain ^{r.a.}**

HAZRAT MIRZA GHULAM AHMAD ^{A.S.}
PROMISED MESSIAH & IMAM MAHDI

72 **Attributes of Allah**

This series delves deeper into each of God's attributes to gain a better understanding of His Being.

80 **A year with Covid-19**

A summary of activities carried out by Ahmadiyya Muslim Jamaat and its humanitarian organisation “Humanity First” in Albania, Kosovo and Germany.

94 **Should we fast while traveling or when we are sick?**

A comprehensive answer based on the Holy Qur'an, hadith and sayings of the Promised Messiah (on whom be peace)

كُتِبَ عَلَيْكَ أَنْفُسِكِ الْإِحْسَانِ

*Ai ka obliguar mbi Vete
mëshirën.*

Kurani Famëllartë 6:13